



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Kontabilitet Financë” me profil: “Kontabilitet Auditim”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Rezarta Shkurti Perri

2. Prof.Asoc. Dr. Ilir Tomorri

Maj 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” me profil “Kontabilitet Auditim”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar i Biznesit
2	Njësia bazë që e ofron:	Dep. Kontabilitet Financë/FE
3	Emërtimi i programit të studimit:	MSh “Kontabilitet Financë” me profil: “Kontabilitet Auditim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër nr. 277, datë 02.07.2012, i MASH
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresa 3715/1; datë 30.07.2019, MASR
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër 158, datë 07.04.2017, i MAS
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër nr. 553 datë 23.11.2016, i MAS; VBA nr. 199, datë 17.10.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë: Master i Shkencave
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite / 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7- PAE/ 5- PAK v.a. 2022-2023 7- PAE/ 7- PAK v.a. 2021-2022 7- PAE/ 9- PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	51- Studentë v.a. 2022-2023 51- Studentë v.a. 2021-2022 30- Studentë v.a. 2020-2021
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Master i Shkencave në Kontabilitet Financë me Profilin: Kontabilitet Auditim.

Kolegji Universitar i Biznesit (KUB në vijim të këtij raporti) është Institucion i Arsimit të Lartë jopublik i cili ofron shërbime publike në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.

Ky Institucion është themeluar dhe ka filluar aktivitetin e tij akademik dhe kërkimor në fillim të vitit mësimor 2011 – 2012 bazuar në VKM nr. 651, datë 14.09.2011 ‘Për licencimin si Institucion i Arsimit të Lartë’ dhe me Urdhër nr. 3, datë 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.


Në fillim të aktivitetit të tij, Institucioni është licencuar me emërtimin “Akademia Profesionale e Biznesit” me dy fakultete, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë, në të dy ciklet e studimeve Bachelor dhe Master. Riorganizimi duke shtuar një njësi tjetër kryesore, Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale dhe riemërtimi “Kolegji Universitar i Biznesit” është bërë me urdhrin nr.39 dt 30.01.2018.

KUB ka realizuar akreditimin e parë institucional në vitin 2012 (Urdhri nr 557), 2017 (Vendimi nr. 100) dhe 2022 (Vendimi nr.03). Vendimi i fundit i akreditimit është dhënë për katër vite deri në 06/01/2026 duke përbushur këtë kërkesë ligjore për akreditim.

Programi Master i Shkencave në Kontabilitet Financë me profil Kontabilitet Auditim ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë i KUB, Departamenti i Financë Kontabilitetit.

Programi i studimit zgjat dy vite akademike dhe ka 120 kredite gjithsej sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve. Ai ofrohet në gjuhën shqipe.

Programi Master i Shkencave në Kontabilitet Financë është akredituar për herë të parë me urdhrin nr. 562 datë 30.11.2016 dhe është riorganizuar me vendimin e Senatit Akademik të KUB nr. 24 datë 13.03.2019, konfirmuar nga MASR me shkresën nr. 3715/1, datë 30.07.2019, me dy profile: Kontabilitet Financë dhe Kontabilitet Auditim.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Master i Shlencave në Kontabilitet Financë me profil: Kontabilitet Auditim është përgatitur nga ekspertët; Prof. Dr. Rezarta Shkurti dhe Prof. Asoc. Dr. Ilir Tomorri të kontraktuar nga kordinatori ASCAL Znj. Rajna Lila.

Për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) grupi i ekspertëve u mbështet në një sërë dokumentash që u aksesuan nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, të cilat ishin të përfshira në Dosjen e Vetëvlerësimit për këtë program studimi, të ofruar nga Kolegji Universitar i Biznesit.


Gjithashtu, informacionet dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e këtij raporti u plotësuan edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të ekspertëve gjatë vizitës dy ditore në institucion, nëpërmjet intervistave të zhvilluara me personelin akademik dhe administrativ si dhe studentët e institucionit dhe dokumentave shtesë të kërkuara gjatë vizitës.

Për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit grupi i ekspertëve është mbështetur në kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, ekspertët kanë ndjekur një metodologji bazuar tek analizimi i dokumentave dhe përputhja e tyre me kriteret e kërkesat ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit Master i Shkencave në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e Planit Mësimor sipas aktiviteteve dhe planit mësimor të detajuar, shpërndarjes së krediteve dhe orëve krahasuar me kërkesat e VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik në lidhje me këtë program studimi, infrastrukturës në mbështetje të programit, sigurimit të brendshëm të cilësisë, mbështetjes së studentëve, etj.

Vizitat në institucion u krye në datat 06.04.2023 dhe 07.04.2023, sipas axhendës së përcaktuar duke përfshirë; takimet me Rektorin e institucionit dhe Përgjegjësin e Departamentit, GVB, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), sekretarisë mësimore, Zyrës Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), Zyrës Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (ZKShP), Zyrës Burimeve Njerëzore (ZBNj), si dhe vizitat në mjediset e IAL-KUB (sallat e leksioneve, seminareve, bibliotekë, laboratorë, etj.).

Këto vizita, si dhe i gjithë procesi i vlerësimit të jashtëm nga ekspertët u asistua nga koordinatoresha teknike e ASCAL znj. Rajna Lila.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 199, datë 17.10.2016, për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” janë:

- a. Të përmirësohet raporti i komponentit të mësimdhënies me atë të kërkimit shkencor, në drejtim të ruajtjes dhe përmirësimit të këtij të fundit edhe përmes bashkëpunimit me institucione homologe jashtë vendit.
- b. Të pasurohet fondi i literaturës për këtë program studimi dhe të sigurohet literatura shtesë, sikurse përcaktohet në syllabuset e lëndëve.
- c. Të aplikohen kritere shtesë, për studentët aplikant në këtë cikël studimi.
- d. Të raportohen dhe publikohen rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë edhe në faqen e web-it.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

- Referuar dokumentacioni shoqërues të DVV, A1.6, “Informacion dërguar ASCAL, për përmbushjen e rekomandimeve” IAL-KUB, bazuar në rekomandimet e BA, për akreditimin e programit të studimit, Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë”;


IAL-KUB i është drejtuar ASCAL me shkresën Nr. 391, Datë 06.10.2020, për përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit për këtë program studimi.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” me profil Kontabilitet Auditim, në “Kolegji Universitar i Biznesit”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Kolegji Universitar i Biznesit (në vijim KUB) ofron programin e studimit Master i Shkencave në Kontabilitet Financë (në vijim MSHKF) me profil Kontabilitet Auditim (në vijim KA). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (në vijim GVJ) për të shqyrtuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri analizoi përmbajtjen e dy dokumenteve të rëndësishëm në Dosjen e Vetë Vlerësimit (në vijim DVV), Statutin e Institucionit dhe Strategjinë e Institucionit. Sipas Statutit të KUB, neni 4, pika a, KUB ka për mision të: formojë specialistë të lartë dhe përgatisë shkencëtarë të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. Po kështu, në Strategjinë e KUB është formuluar synimi i institucionit për të kontribuar në fusha me prioritet të vendit sic janë ekonomia, drejtësia dhe teknologjia e informacionit. Vizioni i KUB, sipas Statutit të tij është forcimi i trashëgimisë dhe reputacionit akademik e shkencor për të krijuar një model të arsimit të lartë që kombinon standardet akademike me aplikimet më bashkëkohore. GVJ vlerëson se në tërësi, KUB ka si mision ofrimin e programeve të studimit që synojnë zhvillimin dhe konservimin e vlerave kombëtare dhe zhvillimin e vendit. <i>Referenca:</i> <i>1. Statuti i KUB</i> <i>2. Plani Strategjik i Zhvillimit i KUB</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Sipas Statutit të KUB, neni 4, misioni i këtij Institucioni është i paraqitur në pikat e mëposhtme: a. Të formojë specialistë të lartë dhe përgatisë shkencëtarë të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. b. Të krijojë, zhvillojë dhe mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarive inovative e profesionale në fushat e ekonomisë, drejtësisë, shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare, teknologjisë së informacionit dhe të fushave profesionale teknike dhe administrative.



	<p>c. Ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës.</p> <p>d. Integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor.</p> <p>e. Nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë, dhe</p> <p>f. Krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në përputhje me Standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL) duke reflektuar objektivat e procesit të Bolonjës.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit, Kreu II, neni 3, ky program synon t'u japë studentëve eksperiencën e nevojshme për një karrierë të suksesshme në fushën e shërbimeve të kontabilitetit, auditimit dhe administrimit fiskal. Programi MSHKF në KUB ka si mision pajisjen me njohuri të gjera në formimin teorik dhe kërkimin shkencor në ekonomi, kontabilitet dhe financë (Rregullorja e programit të studimit, Kreu II, neni 3, pika 3).</p> <p>Duke gjykuar nga synimi, objektivat dhe misioni i programit të studimit, GVJ është e mendimit se ato ofrohen në përputhje me synimet e formuluar edhe në Statutin e KUB dhe vijnë në përputhje të plotë me fushat e veprimtarisë së Institucionit, e më specifikisht me fushën ekonomike.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Statuti i KUB</i> 2. <i>Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Kontabilitet Financë"</i>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe informacionet e gjetura në Statutin e Institucionit, në Strategjinë e Zhvillimit të Tij si edhe në Rregulloret e IAL, dhe atë të programit të studimit MSHKF, GVJ ndeshi evidencë se ky program ka si objektiva dhënien e njohurive të thella teorike dhe shkencore për formimin e studentëve si specialistë të lartë në fushën e financës dhe kontabilitet auditimit. Synimet dhe misioni i programit të studimit (Rregullorja e programit) janë, në opinionin e GVJ, në zbatim të Strategjisë së tij për zhvillim (pika 1 e Strategjisë së Zhvillimit), si edhe Statutit dhe Rregullores Institucionale ku ndër të tjera theksohet në veçanti orientimi i KUB për të punuar në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare duke ndikuar në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Kontabilitet Financë"</i> 2. <i>Strategjia e Zhvillimit të KUB 2021 – 2026</i> 3. <i>Statuti i KUB</i>

4. Rregullore e IAL Jopublik KUB									
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ konstaton nga analiza e objektivave formues të programit të studimit, se synimi i tij paraqitet në përputhje me strategjinë vendase të zhvillimit ekonomik. Përgatitja e specialistëve të aftë në fushën e financë, kontabilitetit, auditimit dhe pajisja e tyre me njohuri të avancuara praktike, teorike dhe shkencore, formon punonjës cilësorë në shkencat ekonomike të cilët ofrojnë potencial për përmirësimin e ambientit ekonomik, cilësisë së raportimit financiar dhe shkojnë paralel me objektivin e Shqipërisë për t'u zhvilluar ekonomikisht dhe për t'u anëtarësuar në BE. Po kështu, ofrimi i këtyre njohurive, i formon studentët si kontigjent punësimi jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë tij. Si përfundim, në gjykimin e GVJ, përgatitja e profesionistëve në fushën e financë, kontabilitetit dhe auditimit është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit të vendit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Kontabilitet Financë"</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master Shkencor në Kontabilitet Financë me profil i ofruar nga Kolegji Universitar i Biznesit ka si synim formimin e specialistëve të aftë në fushat e financës, kontabilitetit dhe auditimit duke i pajisur ata me njohuri të avancuara teorike dhe shkencore në këto drejtime, dhe duke u dhënë aftësitë profesionale të nevojshme për t'u angazhuar në këto disiplina për një punësim të suksesshëm. Në gjykimin e GVJ, program i studimit paraqitet në përgjithësi i kompletuar për të garantuar përmbushjen e interesave dhe vlerave kombëtare dhe avancimin e tyre në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së cilësisë së raportimit dhe kontrollit financiar. GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht nga ana e Intitucionit.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo						
			X						


Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ shqyrtoi në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni dhe në mënyrë të vecantë, Rregulloren e programit të studimit MSHKF, Statutin e KUB dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të tij.</p> <p>GVJ konstaton se KUB paraqitet me një historik të konsiderueshëm dhe të pasur të aktiviteteve të tij akademike, mësimdhënëse dhe kërkuese të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>cilat japin një sfond të përshtatshëm për ofrimin e një programi studimi të ciklit të dytë në Financë, Kontabilitet dhe Auditim nëpërmjet njësisë kryesore të tij që është Fakulteti i Ekonomisë dhe njësisë bazë që është Departamenti i Financë Kontabilitetit (në vijim DFK). Nga shqyrtimi i listës së stafit të angazhuar në DFK dhe në programin e studimit MSHKA, GVJ është e opinionit se profesorati i angazhuar, si staf akademik efektiv, ashtu edhe i jashtëm, janë me kualifikimet e duhura profesionale dhe shkencore në përputhje me fushën e programit të studimit. Ata janë figura të njohura në fushat e kontabilitetit dhe auditimit në Shqipëri duke ofruar burimet më të mira të mundshme për ofrimin e këtij programi.</p> <p>12 vite institucion me traditë të fokusuar qysh nga fillimi në shkencat ekonomike dhe në përputhje me standardet e edukimit në arsimin e lartë dhe standardet profesionale në kontabilitet dhe auditim. Eksperiencë e stafit krijues të Institucionit me fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Fusha e profesionit në Shqipëri është në përputhje me kërkesat ndërkombëtare. Pedagogët e Institucionit janë gjithashtu të arsimuar apo të trajnuar në universitete me emër jashtë vendit. KUB paraqitet kështu me kapacitetet, dhe përvojën e duhur për të ofruar këtë program studimi.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Kontabilitet Financë"</i> 2. <i>Strategjia e Zhvillimit të KUB 2021 – 2026</i> 3. <i>Rregullore e IAL Jopublik KUB.</i> 4. <i>Lista e Stafit Akademik ne kete program studimi 2016-2022.pdf</i> 5. <i>Pedagog te arsimuar dhe kualifikuar jashte.pdf</i>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MSHKF ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, një nga njësitë kryesore të Kolegjit Universitar të Biznesit. Fakulteti i Ekonomisë në KUB përbëhet nga 3 njësi bazë (departamente) duke përbushur kriteret ligjore në këtë aspekt.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Menaxhimit 2. Departamenti i Financë-Kontabilitetit 3. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës. <p>Fusha akademike dhe kërkimore e njësisë kryesore paraqitet në përputhje me fushën e programit të studimit pasi Fakulteti i Ekonomisë është i fokusuar në shkencat ekonomike. Programi i studimit MSHKF është i kodifikuar në përputhje me kërkesat ligjore (VKM 310/2022) dhe lëndët e tij janë gjithashtu të kodifikuara në mbështetje të kësaj VKM (Plani Mësimor sipas kategorive A-E).</p> <p>GVJ është e mendimit se ky kriter përbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Statuti i KUB</i> 2. <i>Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave në Kontabilitet Financë"</i>





	<p>3. <i>Rregullore e DFK</i></p> <p>4. <i>Plani Mësimor sipas kategorive A-E</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Sipas organizimit të njësisë kryesore të KUB që është përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga tre departamente. Njësia bazë e cila është përgjegjëse për programin e studimit MSHKF është Departamenti i Financë Kontabilitetit dhe GVJ mund të konfirmojë se programi i ofruar i studimit është në përputhje të plotë me orientimin akademik dhe kërkimor të njësisë bazë, DFK.</p> <p><i>Ky program studimi nuk është ndërdisiplinor.</i></p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet Financë”</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet pasi MSHKF ofrohet plotësisht në përputhje me profilin e institucionit dhe njësive përbërëse të tij.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>GVJ konstaton se në Statutin e institucionit është formuluar si një ndër qëllimet e KUB, ofrimi i mundësive për të përfutur gjatë gjithë jetës nga arsimit i lartë. Në përputhje me këtë objekt, GVJ konstaton se në RVB Institucioni raporton për krijimin e qendrës ISAB – Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes, qendër e cila funksionon në kuadër të kryerjes së studimeve dhe ofrimit të trajnimeve. Sipas RVB për këtë kriter, ISAB është e licensuar nga Ministria e Financave dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe është i angazhuar në ofrimin e trajnimeve për kontabilistë dhe auditues por edhe për ekspertë ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme (së fundmi). Ndërsa GVJ konfirmon funksionimin e këtij Instituti, nuk hasi evidencë për angazhimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit MSHKF në këto trajnime, sidomos në bashkërendim me punëdhënësit. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion drejtues të tij konfirmuan që ISAB ofron trajnime edhe për studentët e diplomuar të cilët natyrshëm afrohen për trajnime tek universiteti ku janë diplomuar.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Statuti i KUB</i></p> <p>2. <i>Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, pasi shqyrtoi fushën e veprimtarisë së KUB, njësisë kryesore Fakulteti i Ekonomisë dhe njësisë bazë, Departamenti i Financë Kontabilitetit që janë përgjegjëse për programin e studimit MSHKF, formon bindjen se ky program studimi është në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së këtyre njësive, sic janë të formuluar në</i></p>

	<i>dokumentet bazë të Institucionit. Për më tepër, KUB ka krijuar një Institut për Studime dhe Aplikime në Biznes që është i licensuar konform kërkesave ligjore në fuqi në Shqipëri dhe që angazhohet në trajnime profesionale në fushën e kontabilitetit, auditimit, taksimit dhe financës për student që janë diplomuar në KUB dhe jo vetëm. GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi L3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, GVJ ndeshi evidencë në dokumente si Statuti i Institucionit (neni 13), Rregullorja e KUB (nenet 4&5) Rregullorja e funksionimit të DFK dhe Rregullorja e programit të studimit MSHKF, për ndarjen e detyrave mes njësisë përgjegjëse kryesore dhe asaj bazë, si edhe përshkrimin e procedurave të ndarjes së përgjegjësive mes personelit të angazhuar në detyra akademike dhe administrative në programin e studimit. Institucioni ka hartuar rregullore të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë, ku detajohet cdo aspekt i nevojshëm si detyra, role, funksione të personelit, analiza e punës së kryer prej tyre etj.</p> <p>Në dosjen e DVV, GVJ hasi evidencë edhe në lidhje me kryerjen dhe raportimin e analizës së punës kërkimore dhe shkencore të njësisë kryesore dhe të institucionit në tërësi në trajtën e Raportit Vjetor të Veprimtarisë. Në gjykimin e GVJ, analiza e kryer në nivel njësie kryesore, njësie bazë dhe programi studimi është e plotë dhe gjithëpërfshirëse dhe lejon formimin e opinionit se ky kriter plotësohet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Statuti i KUB 2. Rregullore e KUB 3. Rregullore e funksionimit të DFK 4. Rregullore e programit të studimit MSHKF 5. Raporti Vjetor i veprimtarisë. 6. Raporti për punë shkencore.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Në RVB për këtë kriter, Institucioni raporton se janë lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me Institucione arsimore, akademike, kërkimore dhe praktike brenda dhe jashtë vendit në ndihmë të përmbushjes së objektivave të programit të studimit MSHKF.

	<p>Në tabelat e RVB, gjenden të listuara marrëveshjet e bashkëpunimit mes KUB dhe Institucioneve të tjera, dhe këto marrëveshje u konfirmuan edhe nga drehtues të Institucionit gjatë vizitës së GVJ.</p> <p>Në DVV, u hasën edhe evidenca më të detajuara të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe kopje për një pjesë të mirë të këtyre marrëveshjeve duke dëshmuar shkallën e lartë të angazhimit institucional në këtë kontekst dhe seriozitetin e trajtimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit nga ana e Institucionit.</p> <p>GVJ shprehet për plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tabelat e RVB. 2. Lista e Marrëveshjes me partneret ne bashkepunim nderkombetar.pdf
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentave në DVV dhe tabelave të RVB u has evidencë për 68 marrëveshje bashkëpunimi me Universitete ndërkombëtare në kuadrin e marrëveshjes së mobiliteteve Erasmus + dhe njësi dhe entitete të tjera brenda vendit për shkëmbime të praktikave profesionale. Institucione të ndryshme me të cilat KUB ka marrëveshje në kuadër të realizimit të praktikave profesionale në funksion të programit të studimit MSHKF, janë renditur gjithashtu në tabelat e RVB dhe janë 21 të tilla. Përbërja e këtyre institucioneve varion që nga Organizata Jo fitimprurëse, zyra kontabiliteti, qendra kërkimore, etj, duke dhënë një panoramë gjithëpërfshirëse dhe që mundëson kryerjen e praktikave profesionale dhe mobiliteteve për realizimin e kërkimeve shkencore të personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tabelat e RVB. 2. Lista e Marrëveshjes me partneret ne bashkepunim nderkombetar.pdf 3. Partneritet ne bashkepunim. Modeli i marreveshjes se bashkepunimit te KUB lista marreveshje konfindustria.pdf
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në Raportin e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit Erasmus + në KUB, i hartuar në muajin shkurt të vitit 2022 konstatohet nga GVJ se është kryer një analizë relativisht e thelluar e përmbajtjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe përfitimit që ka pasur Institucioni prej tyre. Nga ky raport konstatohen edhe efektet financiare të cdo marrëveshjeje dhe ky është informacion që GVJ e vlerëson pozitivisht. Në faqen 5 të Raportit, GVJ konstaton se (deri në nëntor 2022) janë kryer 4 mobilitete të studentëve të Fakultetit Ekonomik në KUB, dhe 6 të tjera janë në proces ose në pritje, por pa referencë direkte nëse këto marrëveshje lidhen ose jo me këtë program specifik studimi. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi se studentë të këtij program studimi ishin angazhuar më herët</p>

	<p>në programe shkëmbimi Erasmus +. Po kështu, një analizë e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit bëhet pjesë edhe e Raportit Vjetor Institucional që gjendet gjithashtu në DVV.</p> <p>Është e qartë se këto raporte janë hartuar në nivel institucional të KUB dhe jo të njësisë apo programit të studimit, megjithatë GVJ gjykon se ka të dhëna të përgjithshme për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të programit të studimit. Evidencë për analizën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera përveç atyre që janë të përfshira në marrëveshjet Erasmus + u kërkuar gjatë vizitës në Institucion dhe u vendosën në dispozicion të GVJ në kuadrin e studimit të tregut të punës dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Rezultatet pozitive të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe potenciali për vazhdimësi i tyre bëjnë që GVJ të konfirmojë plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Raportimi i Përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit Erasmus +.pdf</i> 2. <i>Raporti Vjetor i KUB</i> 3. <i>Studim i tregut të punës për programin e studimit MSC KF.pdf</i> 						
Konkluzione	<p><i>GVJ shqyrtoi të gjitha dokumentat e dorëzuara nga Institucioni në DVV në lidhje me Marrëveshjet e bashkëpunimit, përmbajtjen dhe fushën e mbulimit të tyre, si edhe analizën e kryer për përfitimet e tyre. GVJ konstaton një larmi të marrëveshjeve të bashkëpunimit me përfaqësues të biznesit, institucione akademiko-kërkimore, dhe studio e zyra kontabiliteti. Po kështu, marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projekteve ndërkombëtare të mobilitetit, Erasmus + janë të larmishme në KUB. GVJ shqyrtoi edhe analizën përkatëse duke konstatuar përfitime të përgjithshme nga këto marrëveshje dhe gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) të Programit të Studimit MSHKF në KUB (Tabelat e RVB), GVJ konstaton se ky program studimi është i organizuar në lëndë/module, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe të vlerësuara me kredite mësimore sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka në total 120 ECTS dhe paraqitet i organizuar në harmoni me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015.</p> <p>GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41/2018 të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen secila me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021, Tabela nr 1, për programet e Masterit Shkencor, në kategorinë A ku bëjnë pjesë lëndët bazë dhe disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme duhet të kenë 5 – 10% të krediteve; në kategorinë B, që janë lëndët karakterizuese, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të ketë 50 – 60% të krediteve; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje dhe duhet të ketë 12 – 20% të krediteve; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10% të krediteve. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmblylëse për diplomim dhe duhet të ketë 10 – 15% të krediteve.)</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. Tabelat përmbledhese të RVB-se</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit MSHKF në KUB, me profil Kontabilitet Auditim, (kreu II, neni 3) objektivat formues specifikë të programit janë ndër të tjera, dhënia e njohurive të thella teorike dhe shkencore, dhënia e eksperiencës për një karrierë të suksesshme, dhënia e një sistemi të gjerë njohurish formimi i specialistëve të aftë për të ushtruar profesionin e kontabilistit dhe audituesit, thellimi në lëndë të specializuara, harmonizimi i njohurive teorike dhe praktike etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit (tabela të RVB), GVJ konstaton se ky program studimi përveçse përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, ofron mundësinë që studentët të profilizohen ose në kontabilitet financë ose në kontabilitet auditim duke ofruar module studimi më të fokusuar për profilin Kontabilitet Auditim sic është p.sh., standardet e auditimit dhe dhënia e shprehiveve të sigurisë, auditimi publik, menaxhimi i riskut si edhe praktikatat e tyre profesionale realizohen me shumtë në studio auditimi.</p>


	<p>Ka gjithashtu lëndë që mbulojnë financën, kontabilitetin, auditimin, analizën e avancuar, sisteme të informacionit të kompjuterizuara, që ofrojnë në përgjithësi një formim të larmishëm dhe të pasur, shumëdisiplinor për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Edhe syllabuset e këtij programi studimi tregojnë për një mbulim kryesisht të plotë të një larmie njohurish teknike në fushat e financës, kontabilitetit, auditimit dhe nënprofileve të lidhura me to, si edhe anon drejt përgatitjes së profesionistëve me ndërthurje të parimeve akademike dhe njohurive praktike të disiplinës së kontabilitetit dhe auditimit, por edhe me një fokus të vecantë drejt kërkimit shkencor duke qenë se përmban dy lëndë si Metodatat e Kërkimit Shkencor dhe Ekonometri, të cilat fokusohen në kërkimin shkencor.</p> <p>GVJ mori edhe opinionin e stafit dhe studentëve të këtij programi studimi gjatë vizitës në Institucion dhe konfirmon se përmbajtja e syllabuseve të lëndëve, në perceptimin e stafit akademik dhe studentëve kishte mundësuar një kombinim dhe korrelacion të plotë mes njohurive teorike dhe atyre praktike. Studentët u shprehën të aftë për të përballuar probleme reale në punësimin e ardhshëm të tyre duke bindur GVJ për cilësinë dhe thellësinë e njohurive të marra në programin e studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tabelat përmbledhëse të RVB 2. Rregulloret e Programit të Studimit. 3. Syllabuset sipas lëndëve.
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në tabelat e RVB konstatohet se në Planin mësimor të programit të studimit është specifikuar qartë se realizimi i praktikës / stazhit tre mujor është lëndë e kategorisë D, vlerësohet me 12 kredite (në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879) dhe realizohet në semestrin e katërt të studimeve. Detyrimet përmbyllëse, që për këtë program studimi i referohen përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës, paraqesin detyrim të kategorisë E, vlerësohen me 18 kredite (gjithashtu në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879) dhe kryhet në semestrin e katërt të studimeve. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri edhe nëpërmjet konfirmimeve gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tabelat përmbledhëse të RVB
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</p>

<p>lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ konstaton se ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe se KUB nuk gëzon status të vecantë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Statuti i KUB</i> 2. <i>Rregullorja e programit të studimit</i>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Në KUB ofrohet programi i studimit Master Shkencor në Kontabilitet Financë me dy profile, Kontabilitet – Financë dhe Kontabilitet – Auditim. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor, GVJ konstaton se këto dy profile janë më shumë se 70 për qind të ngjashme.</p> <p>Në dijeninë e GVJ dhe sa njihen prej saj programe të tjera të ngjashme, përmbajtja e Planit Mësimor të MSHKF në KUB, strukturimi i tij, shpërndarja e krediteve dhe e ngarkesës janë të ngjashme së paku 70 përqind me programet me të njëjtin emër ose me emërtime të ngjashme të ofruar në IAL të tjera në vendin tonë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e programit të studimit</i> 2. <i>Tabelat përmbledhëse të RVB</i>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas analizës së rregullore së programit të studimit, GVJ konfirmon se Programi i studimit MSHKF, është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (shtojca 1, VKM 879); organizohet me 120 ECTS dhe kohëzgjatje normale dy vite akademike me kohë të plotë, i ofruar në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015.</p> <p>Sipas RVB për këtë kriter, shihet se kodi i programit të studimit është 7/120/Msc/KF/Al. Shkresa konfirmuese e kodifikimit të programit të studimit është në pritje për të ardhur nga MAS në kohën e vizitës në</p>

	<p>Institucion. Sipas verifikimit të dosjes së syllabuseve, programet lëndore janë të pajisuar me kodet përkatëse në përputhje me VKM 310/2022.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e programit të studimit 2. Syllabuset e lëndëve 		
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konfirmon se programi MSHKF në KUB është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore si Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë; VKM nr 41, VKM nr 879, VKM nr 185, VKM nr 310 etj.</i></p> <p><i>Programi është i organizuar në 120 kredite përgjatë dy viteve akademike, i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite dhe i kodifikuar në nivel program dhe në nivel lënde. Në dijeninë e GVJ, përmbajtja e planit mësimor është e ngjashme së paku 70% me programe me emër të ngjashëm të ofruar në IAL të tjera në vendin tonë. Sic paraqitet programi i studimit jep njohuri në nivel të specializuar të financës, kontabilitetit dhe auditimit, garanton punësimin dhe ekuivalentimin e transferimin e studimeve për shkak të hartimit të tij në një format të përputhshëm me aktet rregullatore në fuqi dhe në ngjashmëri me programe të tjera.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Sipas dokumentave në DVV, GVJ konstaton se KUB është IAL jopublike dhe është krijuar në zbatim të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” bazuar në VKM nr. 651, dt 14.09.2011 “Për licensimin si Institucioni Arsimit të Lartë” me Urdhër nr. 3 dt 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. KUB ka filluar aktivitetin akademik në vitin mësimor 2011 – 2012 fillimisht me emërtimin “Akademia Profesionale e Biznesit” me dy fakultete, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë në të dy ciklet e studimit, Bachelor dhe Master. Me urdhrin nr. 39, dt. 30.01.2018 është riorganizuar me emërtimin aktual Kolegji</p>

Universitar i Biznesit duke shtuar edhe një njësi tjetër kryesore, Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale. Sipas tërësisë së Vendimeve të Akreditimit që gjenden në DVV, GVJ konfirmon se KUB plotëson kriteret ligjore pasi është akredituar institucionalisht në vitin 2012 (Urdhri nr 557), 2017 (Vendimi nr. 100) dhe 2022 (Vendimi nr.03). Vendimi i fundit i akreditimit është dhënë për katër vite deri në 06/01/2026 duke përbushur këtë kërkesë ligjore për akreditim.

Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit MSHKF është Fakulteti i Ekonomisë i cili, duke qenë i organizuar në 3 departamente si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi sipas të cilit një njësi kryesore organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente.

1. Departamenti i Menaxhimit
2. Departamenti i Financë Kontabilitetit.
3. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës

Sipas nenit 13, pika 4, të Statutit të KUB, Departamenti si njësi bazë, mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor shkencor, por GVJ nuk hasi evidencë të kësaj praktike.

Fakulteti i Ekonomisë ofron gjithsej 8 programe studimi (tabela 3 në anekset e RVB): 3 programe studimi në nivelin bachelor, 3 programe studimi në Master i Shkencave, 2 programe studimi në Master Profesional.

Njësia bazë që ofron programin MSHKF është Departamenti Financë Kontabilitet dhe sipas tabelës 3 në RVB, kjo njësi bazë ofron gjithsej 4 programe studimi: 1 program studimi në nivelin bachelor (I cili ka tre profile, Financë Kontabilitet, Admintrim Biznesi dhe Banka e Institucione Financiare), 1 program studimi në Master i Shkencave Kontabilitet Financë me profil Kontabilitet Auditim, dhe 2 programe studimi në Master Profesional.

Programi i studimit MSHKF ofrohet në përputhje me ligjin 85/2015 në dy vite akademike dhe me 120 ECTS, është akredituar për herë të parë me urdhrin nr 562 datë 30.11.2016 dhe është riorganizuar me Vendim të Senatit Akademik të KUB nr. 24, dt. 13.03.2019 si master me dy profile: 1) Kontabilitet Financë dhe 2) Kontabilitet Auditim.


Nga tabelat në RVB konstatohet se në programin e studimit MSHKF janë angazhuar staf PAE dhe PAK si më poshtë në vitin e fundit akademik.

Programi i studimit MSHKF me profil	2022-2023	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	2
Prof.As	1	0
Dr	5	1
Total	8	3

	<p>Raportet numerike të të stafit akademik PAE/PAK të angazhuar në këtë program studimi janë 8/3 ose 73%/27%, kurse raportet numerike të ngarkesës mësimore të stafit PAE/PAK janë 720/180 orë në auditor ose 80%/20% duke plotësuar kërkesat ligjore. Bie në sy gjithashtu se në këtë program studimi nuk është angazhuar asnjë personel akademik me gradë më të ulët se Dr. duke plotësuar kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Në tërësi, GVJ formon opinionin se në bazë të organizimit dhe përbërjes, njësia kryesore dhe njësia bazë që ofrojnë këtë program studimi plotësojnë kriteret ligjore pra ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Statuti i KUB 2. RVB Programi i Studimit MSHKF me profil 3. Vendimet e Akreditimit të KUB 4. Tabelat e RVB
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Në nenin 13, pika 2 të Statutit të KUB citohet se Departamenti si njësi bazë e Institucionit mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës akademik. Por nga shqyrtimi i tabelave të RVB, GVJ konstaton se njësia bazë që ofron programin e studimit nuk ka të angazhuar personel ndihmës akademik / administrativ. Duke qenë se Plani Mësimor i programit të studimit nuk parashikon orë laboratorike kjo mund të jetë arsyeja e mos angazhimit të stafit PNA. Megjithatë GVJ e ngriti këtë çështje gjatë vizitës në Institucion pasi në dokumentin Organograma e KUB konstatohet se ka disa struktura në funksionin ndihmës administrativ. Gjatë vizitës GVJ u informua se Personeli Ndihmës Akademik është në nivel njësie kryesore dhe asiston në funksion të ofrimit të aktiviteteve akademike të programit të studimit.</p> <p>Në RVB për këtë kriter nuk gjendet formulimi i duhur dhe GVJ këshillon organizimin më të mirë të RVB, por konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri, pavarësisht mos paraqitjes së mirë të RVB në këtë kriter.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. RVB Programi i Studimit MSHKF me profil 2. Organograma e KUB
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, Institucioni ka angazhuar staf ndihmës akademik dhe administrativ për monitorimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve mësimore të lidhura me programin e studimit dhe ka dhënë një listë gjithpërfshirëse të kompetencave dhe detyrave të këtij stafi në këtë kontekst. Megjithatë, GVJ nuk ndeshi evidencë të dorëzuar paraprakisht në lidhje me emërimin, rolin dhe funksionet e një koordinatori të programit të studimit. Pyetur gjatë vizitës në Institucion, drejtues të tij u shprehën se rolin e koordinatorit të programit të studimit e luan përgjegjësi i njësisë bazë që ofron programin, në këtë rast përgjegjësi i DFK, dhe funksionet dhe kompetencat e tij janë të parashikuara në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit.</p>

	<p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>RVB Programi i Studimit</i> 2. <i>Rregullorja e njësisë bazë</i> 3. <i>Rregullorja e programit të studimit</i> 		
Konkluzione	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si edhe mbështetur në konfirmimet e marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmon se në KUB, njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, MSHKF, Fakulteti i Ekonomisë dhe njësia bazë DFK janë në përgjithësi të organizuara konform kërkesave ligjore në fuqi. KUB ka dy fakultete dhe një njësi kryesore tjetër, Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale. Fakulteti i Ekonomisë ka tre departamente në përbërjen e tij, secili me minimumin 7 pedagogë staf akademik efektiv. DFK plotëson kriterin që të ketë të paktën 7 pedagogë akademikë efektivë nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada. DFK nuk ka personel ndihmës akademik të dedikuar për njësinë bazë por vetë Institucioni dhe Fakulteti i Ekonomisë, si njësi kryesore ka të angazhuar staf ndihmës në ndjekjen e praktikave mësimore dhe orëve laboratorike apo aktiviteteve të tjera të programit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV (Rregullorja e Programit të Studimit, Plani Mësimor i Programit të Studimit, Udhëzime për studentët, etj) dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit MSHKF në KUB disponohen nga Fakulteti i Ekonomisë (njësia kryesore) dhe Departamenti Financë Kontabilitet (njësia bazë) si edhe janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht. GVJ konfirmoi publikimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe informacione të tjera rreth tij edhe në faqen e internetit të institucionit në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullore e programit të studimit MSHKF me profil</i> 2. <i>Plani Mësimor i Programit të Studimit</i>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të DVV, GVJ konstatoi se elementët e rëndësishëm të programit të studimit janë parashtuar në Rregulloren e Programit të Studimit. Sipas kësaj rregulloreje (neni 4), shihet se ky program është i organizuar me 120 ECTS, në katër semestra dhe në dy vite akademike që</p>

<p>të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>kanë kohëzgjatje normale 30 javë dhe 60 kredite në cdo vit. Në fund të cdo semestri ka një sezon provimesh dhe në fund të vitit akademik ka një sezon vjeshte. Programi mësimor zhvillohet nga dita e mërkurë në ditën e shtunë të cdo jave (konfirmuar gjatë vizitës në Institucion) dhe jo më shumë se 25 orë mësimore në javë. Orari mësimor është përshtatur për të akomoduar nevojat e studentëve.</p> <p>Sipas Planit mësimor të programit të studimit (neni 8 në rregullore), ai ofrohet në dy profile: Kontabilitet Financë dhe Kontabilitet Auditim dhe për cdo profil janë renditur lëndët përkatëse të vlerësuara në kredite (cdo lëndë ka midis 5 dhe 6 kredite). Për të dy profilet parashikohet që në semestrin e katërt të kryhen praktika mësimore me 12 ECTS dhe mikroteza ose provimi final me 18 ECTS. Plani mësimor përmban informacion të plotë në lidhje me orët në auditor dhe jashtë auditorit për secilën prej lëndëve. Sipas nenit 11 të rregullores së programit të studimit, studenti është i detyruar të frekuentojë leksionet dhe seminarët jo më pak se 50% të tyre kurse detyrimet e tjera duhet të shlyhen në masën 100%.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Rregullorja e programit të studimit MSHKF me profil.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme të pranimit në programin e studimit MSHKF në KUB, kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë përshkruar në Rregulloren e këtij programi studimi. Në nenin 5 të rregullores citohet se në MSHKF me profil pranohen studentë që kanë mbaruar me sukses studimet në ciklin e parë Bachelor dhe të kenë plotësuar kriteret shtesë që miratohen dhe shpallen cdo vit nga KUB e i dërgohen ministrisë dhe QSHA (Qendrës së Shërbimeve Arsimore). Këto të fundit janë përfshirë në DVV në emërtimin “Politika të Pranimit të studentëve” dhe sipas pikës 2 të saj, shihet se për vitin e fundit akademik 2022 – 2023, KUB ka specifikuar se pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve do bëhet për ata studentë që kanë përfunduar studimet Bachelor në degë të përafërta studimesh, kjo në përputhje edhe me ligjin. Gjatë vizitës në nstitution, GVJ u informua se në këtë program studimi kryesisht aplikonin studentë që kanë Bachelor në Financë, ose Administrim Biznesi.</p> <p>Në lidhje me transferimet, në programin e studimit MSHKF me profil në KUB kanë të drejtë të transferohen studentë nga institucione të tjera të arsimit të lartë vendase ose të huaja, publike ose private si edhe lejohet transferimi në dalje i studentëve të saj për në institucione të tjera të arsimit të lartë. Nuk jepen detaje në lidhje me kushtet e pranimit të transferimit përveçse përmendet se ky proces organizohet sipas udhëzimeve të përvitshme të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe në përputhje me Statutin, Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren për Ekuivalentimin e Studimeve.</p>

	<p>Në lidhje me ekuivalentimin e programeve të studimeve, KUB ka hartuar një rregullore të posacme sipas së cilës ekuivalentimi kryhet nga një Komision i Ekuivalentimit të Studimeve (KES). KES është një organ kolegjal me jo më pak se tre anëtarë në përbërjen e tij, nga një anëtar prej cdo njësi kryesore në KUB. Përbërja e KES miratohet nga Senati Akademik. Objekti i punës i Komisionit është ekuivalentimi i diplomave dhe programeve të plota apo të pjesshme të studimit. Rregullat e ekuivalentimit dhe dokumentat që duhet të dorëzohen nga studentët për të garantuar një process ekuivalentimi sa më të plotë dhe transparent përshkruhen me hollësi në Rregulloren e Ekuivalentimit në KUB.</p> <p>Aktualisht programi i studimit ka pasur 1 transferim në vitin akademik 2022 – 2023 (tabelat e RVB).</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e programit të studimit MSHKF me profil.</i> 2. <i>Dokumenti “Politika të Pranimit të studentëve”</i> 3. <i>Tabelat e RVB</i> 4. <i>Rregullore e Ekuivalentimit te studimeve.</i>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar jo vetëm Planin Mësimor që është pjesë e tabelave të RVB, por edhe programet lëndore përkatëse të programit të studimit MSHKF në KUB të cilat janë pjesë e DVV. Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me leksionet, praktikat në auditor, seminarët dhe orë laboratorit (nëse ka) në përputhje kjo me VKM nr.41 si edhe mënyrën e vlerësimit që ndiqet në cdo lëndë. Komponentët formues të programit janë formuluar konform formateve të kërkuara sipas VKM nr. 41 të ndryshuar nga VKM nr. 879.</p> <p>Sipas tabelës nr. 14 në RVB dhe konfirmuar nga GVJ edhe në programet lëndore të programit të studimit, nota përfundimtare e studentit në MSHKF në KUB është rezultante e këtyre elementëve të vlerësimit: ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive (10% e vlerësimit), plotësimi i detyrimeve laboratorike dhe detyrave të kursit (10% e vlerësimit), testimet gjatë vitit (20% e vlerësimit) dhe provimi përfundimtar (60% e vlerësimit). Përqindja e rëndësisë për cdo komponent vlerësimi është e përcaktuar edhe në cdo syllabus, në përgjithësi konform edhe nenit nr 12, pika 3 e rregullores së programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e programit të studimit MSHKF me profil Kontabilitet Auditim.</i> 2. <i>Tabelat e RVB</i> 3. <i>Dosja e syllabuseve të lëndëve të programit</i>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim</p>	<p>Nga ana procedurale, GVJ konfirmon se sipas nenit 25 të Rregullores së programit të studimit MSHKF në KUB, programi i studimit mund të</p>

<p>dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>rishikohet me kërkesë të njësisë bazë që ofron programin ose të zyrës së kurrikulave si rezultat i kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme, por edhe me kërkesë të secilit pedagog. Riorganizimi mund të parashikojë bashkime të lëndëve apo ndarje të tyre, pa çenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program. Njësia bazë ka të drejtën të propozojë ndryshime deri në masën 20% të krediteve të programit duke krijuar edhe profile. Këto propozime shqyrtohen nga dekanati dhe miratohen nga Senati akademik.</p> <p>Në tabelën 11 të RVB, GVJ konstaton ndryshimet e Planit Mësimor të cilat konsistojnë kryesisht në ndryshim dhe sistemim të krediteve, përvec një ndryshimi të lëndës dhe në gjykimin e GVJ janë në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes dhe organizimit të programit të studimit. GVJ gjithashtu konstatoi ruajtjen e materialeve të lidhura me programin e studimit edhe në gjuhën angleze dhe ekzistencën e tyre në DVV.</p> <p>GVJ gjithashtu pyeti stafin e angazhuar në programin e studimit në lidhje me praktikën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit dhe konfirmon angazhimin e vazhdueshëm të stafit në këtë drejtim. Kërkesa nga pedagogu i drejtohet përgjegjësit të departamentit dhe ndjek procedurën përkatëse. Institucioni është i hapur të përshtatet me kërkesat e pedagogut. Sipas stafit akademik, kurrikula është dicka dinamike që duhet të reflektojë ndryshimet e vazhdueshme në treg ose në profesion në mënyrë që të qëndrojë konkurruese.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e programit të studimit MSHKF me profil. 2. Tabelat e RVB 						
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, shqyrtoi një sërë dokumentacionesh të DVV, si Tabelat e RVB, Rregullorja e Njesisë Kryesore, Rregullorja e Programit të Studimit, Plani Mësimor, Programet Lëndore. Sipas konfirmimeve të GVJ ky programi studimi paraqitet i detajuar me elementet përkatëse të kërkuara në kuadrin ligjor dhe është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë sipas Kornizës 7 të KSHK. Ai është një program me 120 ECTS i shtrirë në katër semestra dhe dy vite akademike me 15 javë secili. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim të vazhdueshëm sipas një procedure të parashikuar në rregulloren përkatëse dhe që sipas konfirmimeve të GVJ ndiqet në mënyrë rigorozë dhe së cilës i kushtohet vëmendje e posacme nga profesori. Pranimet, transferimet dhe ekuivalentimet e studimeve në këtë program janë gjithashtu të parashikuara në rregullore të posacme brenda institucionit, rregullore që janë transparente. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="558 1792 762 1870"></th> <th data-bbox="762 1792 948 1870">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="948 1792 1160 1870">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="558 1870 762 1910"></td> <td data-bbox="762 1870 948 1910"></td> <td data-bbox="948 1870 1160 1910" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IL4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së Planit Mësimor të programit të studimit (në tabelat e RVB), dhe përmbajtjes edhe të syllabuseve të vecanta, GVJ mund të konfirmojë se programi i studimit përfshin një gamë të pasur lëndësh të ndryshme të formimit të nevojshëm profesional dhe njohuri në disiplina të lidhura me financën, kontabilitetin, auditimin dhe disiplina mbështetëse të tyre. Veprimtaritë e parashikuara në cdo lëndë, në gjykimin e GVJ duket se mundësojnë formimin teorik dhe praktik të nevojshëm të studentëve në funksion të punësimit të tyre, por edhe në vazhdimësinë e mëtejshme të studimeve.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Plani Mësimor i programit të studimit.</i> 2. <i>Dosja e Syllabuseve.</i>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektiveve formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Objektivat formues specifikë të programit të studimit janë listuar në Rregulloren përkatëse (neni 3) dhe janë formimi i specialistëve të lartë në fushën e kontabilitetit dhe financës dhe kontabilitet auditimit; dhënia e eksperiencës së nevojshme për të mundësuar formimin e profesionistëve të aftë; thellime në disiplina si standardet e kontabilitetit, auditimit dhe të raportimit financiar apo të disiplinave mbështetëse si qeverisje korporatash, drejtim strategjik dhe financa ndërkombëtare; formimi i përgjithshëm i figurës së profesionistit të lartë kontabël dhe auditues.</p> <p>Një përfundim më i detajuar i këtyre objektiveve formuese përsëritet në trajtën e rezultateve të të nxënit në cdo program lëndor. Nga shqyrtimi i shpërndarjes së lëndëve në vite e semestra dhe nga organizimi i tyre, GVJ formoi bindjen se në këtë formë që paraqiten, Plani Mësimor mundëson arritjen e objektiveve formues të programit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Plani Mësimor i programit të studimit.</i> 2. <i>Rregullorja e programit të studimit MSHKF me profil.</i> 3. <i>Dosja e Syllabuseve.</i>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi tabelat e RVB, Planet Mësimore të cdo periudhë të përfshirë në akreditim dhe ndryshimet përkatëse gjatë periudhës, si edhe programet lëndore të lëndëve të ofruara në programin e studimit MSHKF në KUB, konfirmon se struktura e programit, lëndët e përfshira në të dhe raportet mes torisë dhe praktikës janë të përshtatshëm për profilet financë/kontabilitet/auditim. Gjithashtu, në dijeninë e GVJ, emërtimi i lëndëve të programit të studimit, përmbajtja e tyre dhe literatura e parashikuar paraqet e ngjashme me programe studimi ndërkombëtare në fushën e kontabilitet financës dhe të kontabilitet auditimit.</p>



	<p>Gjatë vizitës në Institucion studentët u shprehën se kontakti me përmbajtjen e lëndëve dhe njohuritë e transmetuara nga profesorët e lëndëve i bënin të sigurt për të përballuar kërkesat e punës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Plani Mësimor i Programit të Studimit MSHKF me profil</i> 2. <i>Tabelat e RVB</i> 												
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Struktura e programit MSHKF me profil në KUB, dhe ndarja e veprimtarive formuese dhe ngarkesa totale në auditor paraqiten në tabelat e RVB si më poshtë:</p> <table border="0"> <tr> <td>• Leksione</td> <td>450 orë</td> </tr> <tr> <td>• Seminare</td> <td>450 orë</td> </tr> <tr> <td>• Ushtrime / Laboratore</td> <td>0 orë</td> </tr> <tr> <td>• Praktikë profesionale</td> <td>75 orë</td> </tr> <tr> <td>• Diploma</td> <td>300 orë</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>1.275 orë</td> </tr> </table> <p>Raporti Teori (leksione) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt.prof) rezulton 450 orë teori / 825 orë praktikë ose afërsisht 35% / 65%.</p> <p>Këto raporte anojnë nga veprimtaritë praktike pra kryerja e seminareve, praktika në profesion dhe përgatitja e diplomës, cka u mundëson studentëve të formohen nga ana profesionale, të zgjerojnë njohuritë e tyre kërkimore-shkencore dhe të arrijnë objektivat e të nxënit në këtë program studimi duke garantuar punësimin e tyre në profile të punës. Në dijeninë e GVJ duke qenë se kjo shpërndarje e veprimtarive formuese është e ngjashme edhe me programe të tjera studimi me të njëjtën fushë apo fokus, bën të mundur transferimin e studimeve dhe lehtësimin e kryerjes së mobilitetit të studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Tabelat e RVB</i> 	• Leksione	450 orë	• Seminare	450 orë	• Ushtrime / Laboratore	0 orë	• Praktikë profesionale	75 orë	• Diploma	300 orë	Totali	1.275 orë
• Leksione	450 orë												
• Seminare	450 orë												
• Ushtrime / Laboratore	0 orë												
• Praktikë profesionale	75 orë												
• Diploma	300 orë												
Totali	1.275 orë												
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Sipas RVB për këtë pikë përmirësimi i syllabuseve është një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e pedagogëve të lëndës të cilët duke u nisur nga eksperiencia e tyre apo literatura të reja me të cilat përballen mund të përmirësojnë vazhdimisht përmbajtjen e lëndëve, natyrisht pa cënuar qëllimin dhe objektivin e lëndës. Nga ana procedurale GVJ konstaton se në nenin 25 të Rregullores së programit të studimit MSHKF në KUB, parashikohet që programi i studimit mund të rishikohet me kërkesë të njësisë bazë që ofron programin ose të zyrës së kurrikulave dhe si rezultat i kërkesave të tregut të punës, e dinamikave të brendshme.</p> <p>Më tej, nga shqyrtimi më i detajuar që GVJ u bëri përmbajtjes së dosjes së syllabuseve, u konstatua se këto syllabuse në përgjithësi garantojnë marrjen e aftësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës për profesionistë finance, kontabilistë dhe auditues. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ gjithashtu dëshmoi angazhimin serioz të profesorit në drejtim të të qenit gjithmonë të përditësuar përsa i përket kërkesave të</p>												

	<p>profesionit financë, kontabilitet apo auditim. Gjithashtu, literatura bazë dhe ndihmëse ishte kryesisht e viteve të fundit, nga autorët më të njohur në vend në fushat e kontabilitet auditim, financë dhe paraqitet cilësore dhe e përditësuar me elementet e nevojshme për marrjen e njohurive kritike në financë, kontabilitet dhe auditim.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm. 2. Rregullorja e Programit të Studimit. 3. Syllabuset e Programit të Studimit. 						
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Në gjykimin e GVJ dhe mbështetur në njohurinë dhe formimin e tyre, përmbajtja e programit të studimit MSHKF në KUB dhe elementet e tij garantojnë plotësisht përfitimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave të synuara sic edhe janë formuluar në Rregulloren e programit të studimit. Lëndët e ofruara në program garantojnë që studentët të mund të marrin njohuri teorike dhe praktike në fusha të përgjithshme të financës, kontabilitetit dhe auditimit, si edhe njohuri specifike psh në lidhje me taksimin, etikën e avancuar në profesion, analizën metodologjike, analizën e avancuar financiare, kontabilitetin publik, etj.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e Programit të Studimit. 2. Syllabuset e Programit të Studimit. 						
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit MSHKF në KUB, GVJ konstaton se ky program, në mënyrën sesi është organizuar dhe strukturuar jep mundësinë që studentët që e përfundojnë atë të mund të zgjedhin midis dy mundësive, ose vijimin e mëtejshëm të studimeve në programe të tjera brenda dhe jashtë vendit; ose punësimin në përshtatje me profilin dhe pritshmëritë e tregut të punës për punonjës auditimi, finance e kontabiliteti ose edhe si profesionistë të pavarur të licencuar me licencat profesionale përkatëse në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e Programit të Studimit. 2. Syllabuset e Programit të Studimit. 						
<p>Konkluzione</p>	<p>Për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së këtij standardi GVJ shqyrtoi me vëmendje organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e elementeve të programit të studimit MSHKF në KUB, shpërndarjen mes veprimtarive formuese, shpërndarjen kohore, syllabuset e lëndëve dhe përputhshmërinë e tyre me synimet dhe misionin e programit të studimit. GVJ shprehet për një përmbushje plotësisht të këtij standardi.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IL5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Sic theksohet në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së programit të studimit është në fokus të vëmendjes dhe orientohet nga zhvillimet e tregut. Zakonisht ky proces nis në fund të cdo viti akademik në bazë të vlerësimeve të studentëve dhe të partnerëve.</p> <p>Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, përfaqësues të departamentit u shprehën se përditësimi i përmbajtjes së programit ishte një aktivitet periodik dhe në një farë mënyre i detyruar nga kërkesat e tregut dhe studentëve të programit të cilët vijnë nga eksperiencia praktike në profesion. Vazhdimësia e përmirësimit të materialeve bëhet në ndjekje të përmirësimit të vazhdueshëm të këtij profesioni edhe për shkak se një pjesë e mirë e stafit akademik PAK janë përfaqësues me emër të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në vend. Drejtues të Institucionit u shprehën gjithashtu se ruajtja e kontakteve të vazhdueshme me institucionet partnere me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi ishte një praktikë e zakonshme në Institucion.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Studim i tregut të punës për programin e studimit MSC KF.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter përmenden shumë praktika institucionale si angazhimi i studentëve me përfaqësim në Senatin Akademik, pjesëmarrja e tyre në procesin e vlerësimit të mësimit nëpërmjet pyetësoreve të përgatitura nga NJSBC. GVJ shqyrtoi Rregulloren e NJSBC dhe në nenin 4, pikat 2, 3 dhe 4 ndeshi evidencë për parashikimin e procedurës së vlerësimit të programeve të studimit mbështetur edhe tek sondazhet me studentët. Gjithashtu një raport përmbledhës mbi analizën e sondazhit bazuar tek studentët dhe kryer nga IQE ishte pjesë e DVV. Sipas këtyre dokumenteve dilnin në pah perceptimet e studentëve në lidhje me procedurat mësimore të programit të studimit MSHKF.</p> <p>Sipas tabelave në RVB, numri i këtyre të fundit është 32 studentë të diplomuar në vitin akademik 2019 – 2020; 34 studentë të diplomuar në vitin akademik 2020 – 2021; 28 studentë të diplomuar në vitin akademik 2021 – 2022.</p> <p>Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi i programit të studimit u shprehën se ruhen kontakte me studentët alumni të cilët duke qenë se rezultojnë të punësuar rreth 93% në profesion, janë një burim i mirë</p>


	<p>reflektimi në funksion të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e funksionimit të NJSBC 2. Raport përmbledhës mbi analizën e pyetësorit me studentët 3. Sondazhi me studentët, Janar 2023 4. Raporti i IQE 5. Tabelat e RVB 						
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Sic GVJ konstaton nga dosja e CV e stafit të angazhuar në këtë program studimi, PAE por sidomos PAK, një pjesë e tyre janë anëtarë të rrjeteve profesionale dhe shoqatave me emër në kontabilitet dhe auditim në vendin tonë. Përfshirja e stafit cilësor mundëson shfrytëzimin e lidhjeve të tyre në funksion të përshtatjes sa më të afërt të përmbajtjes së programit të studimit me kërkesat e tregut. Në të vërtetë, GVJ vlerëson që stafi akademik cilësor dhe lider në fushën e kontabilitetit dhe auditimit në vend është një ndër pikat më të forta të këtij program studimi. Profesorë PAK në program janë pjesëtarë të organizmave politikëbërëse të kontabilitetit dhe auditimit në vend si Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, ose shoqatave profesionale përkatëse.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. CV e stafit akademik per programin Msc KF.pdf 						
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi përmbajtjen e DVV dhe për më tepër pas kontakteve me stafin dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion shprehet për përmbushjen plotësisht të këtij standardi. KUB është i angazhuar në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave të të gjitha programeve që ai ofron duke u konsultuar me përfaqësues të tregut dhe biznesit të cilët kontaktohen gjatë aktiviteteve të ndryshme të përbashkëta institucionale. KUB gjithashtu reflekton kërkesat për përmirësim të programit nga studentët aktualë dhe të diplomuar të cilët duke qenë në një masë të madhe të diplomuar në profesion paraqiten si një trysni positive ndaj KUB që ky i fundit të përmirësojë pa reshtur kurrikulat e tij. Së fundmi, bashkëpunimi i pasur i Institucionit me shoqata dhe rrjete profesionale të fushës garanton maksimumin e cilësisë përsa i përket përmbajtjes së programit të studimit.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi IL6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të studimit, MSHKF me profil në KUB specifikohen objektivat kryesorë të formimit të cilët janë: Përgatitja e</p>

<p>objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>specialistëve të aftë në fushën e financë, kontabilitet auditimit dhe pajisja e tyre me njohuri të avancuara praktike, teorike dhe shkencore, të krijojnë dije me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të formojnë specialistë të lartë, që t'u përgjigjen kërkesave të tregut të punës, si dhe të krijojnë specialistë për të gjitha fushat profesionale në ekonomi në pozicionet: financierë, kontabilistë, dhe, në mendimin e GVJ, shkojnë paralel me objektivin e Shqipërisë për t'u zhvilluar ekonomikisht dhe për t'u anëtarësuar në BE.</p> <p>GVJ gjykon se këto objektiva të programit të studimit janë në përputhje me prioritetet dhe objektivat madhorë të Institutit sic përcaktohen në Strategjinë e KUB, për ngritjen e një stafi akademik konkurrues dhe profesionist në fushën e tyre të studimit dhe hulumtimit si edhe tërheqjen e mendimit shkencor të personaliteteve më në zë të fushës së ekonomisë në vend dhe nxitjen e botimeve shkencore dhe konferencave në bashkëpunim me partner të një profili të lartë kërkimor - shkencor.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e Programit të Studimit MSHKF me profil</i> 2. <i>Strategjia e KUB</i> 3. <i>Strategjia e Kërkimit Shkencor në KUB</i>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Statutit të KUB dhe Rregullores bazë të funksionimit të saj, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësi bazë që ofrojnë programin e studimit MSHKF me profil, bashkërendojnë detyrat e tyre në kuadrin e mësimdhënies, dhe veprimtarisë kërkimore dhe garantojnë lirinë akademike të shprehur në fleksibilitetin e organizimit të orëve mësimore dhe metodologjive didaktike që zgjedh secili prej stafit akademik. Kjo liri akademike dhe respektimi i saj u konfirmuan edhe gjatë vizitës në Institucion me stafin pedagogjik të pranishëm gjatë vizitës të cilët u shprehën pozitivisht për mbështetjen e Institutit. Përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies dhe përshtatja e procesit mësimor në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit, ishte një tjetër faktor i dëshmuar nga GVJ gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Statuti i KUB</i> 2. <i>Rregullorja e Përgjithshme e funksionimit të KUB</i> 3. <i>Rregullorja e Programit të Studimit MSHKF me profil</i>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga RVB, GVJ informohet se DFK, njësi bazë që ofron programin e studimit MSHKF me profil, vazhdimisht nxit studentët të angazhohen në projekte studimore dhe kërkimore duke përmendur detyrimet e parashikuara në Planin Mësimor, aktivitetet institucionale si edhe projektet e bashkëpunimit institucional. Sic GVJ e konfirmon, këto</p>

	<p>praktika janë të përfshira me bazë dokumentare në DVV. Kështu, u has evidencë për organizimin e aktivitetit “Kërkimi im fillon” në janar të vitit 2020, aktivitet në të cilin kanë marrë pjesë pedagogë dhe studentw të Fakultetit të Ekonomisë. Gjithashtu, në tabelat e RVB raportohet se për programin e studimit MSHKF me profil janë angazhuar 12 studentë në punime shkencore individuale të pedagogëve, 15 studentë në projekte shkencore në rang Departamenti, 30 studentë në projekte shkencore në rang Fakulteti dhe 17 studentë për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë.</p> <p>Informacioni për shkallën e përfshirjes së studentëve u mbështet nga këta të fundit gjatë intervistave me ta në fazën e vizitës së GVJ në Institucion. Organizimi i rregullt periodik i konferencave studentore ishte një tjetër praktikë pozitive që u konfirmua me studentët e programit.</p> <p>Bazuar në këto konstatime, GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumenti “Kërkimi im Fillon” 2. Tabelat e RVB
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter përmenden një sërë elementësh në mbështetje të aktiviteteve studimore dhe kërkimore. GVJ konstaton (në dokumentin “Plani i Buxhetit për vitin 2023”) se për cdo vit akademik KUB ka financuar aktivitetet e kërkimit shkencor me përqindje gjithmonë në rritje duke filluar nga 5% në vitin 2018 e deri në 8.1 % në vitin 2021.</p> <p>KUB gjithashtu financon veprimtarinë dhe buxhetin e Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në KUB me 50% nga të ardhurat nga mësimdhënia dhe pjesa tjetër nga projekte kërkimore.</p> <p>Këto u konfirmuan edhe gjatë vizitës në Institucion ku u pa theksi i drejtuesve institucionale kah financimit të plotë të botimeve të stafit në revista shkencore me faktor impakti dhe Scopus, si edhe nxitja e tyre për të zgjeruar sa më shuëm pjesëmarrjen në konferenca shkencore.</p> <p>GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumenti “Plani i Buxhetit për vitin 2023” 2. Rregullore e Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.
<p>Konkluzione</p>	<p>Për të konfirmuar orientimin kërkimor dhe shkencor dhe shkallën e përmbushjes së këtij standardi, GVJ u mbështet në evidencën e dorëzuar si edhe në konfirmimin me stafin akademik, stafin mbështetës si edhe me studentët. GVJ gjen evidencë të kënaqshme për rëndësinë që Institucioni i jep studimeve dhe kërkimeve shkencore duke financuar me një përqindje të konsiderueshme aktivitete të rëndësishme në këtë drejtim, duke përfshirë në numra të konsiderueshëm studentë në punime shkencore, konferenca studentore, dhe projekte në rang njësie bazë dhe njësie</p>

	<i>kryesore dhe duke mbështetur edhe me projekte shkëmbimi Erasmus + student dhe staf të këtij programi studimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, ka evidencë për procedurat e menaxhimit të projekteve kërkimore dhe shkencore qysh në hapat e para të tyre, pra që në përgatitjen e project propozimeve. Në dokumentin Rregullore e Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve ndeshen të dhëna të detajuara në lidhje me mënyrën e funksionimit të kësaj trukture e cila është e dedikuar për bashkërendimin e aktiviteteve të KUB me partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit. Kjo zyrë ka si objektiv të saj ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, nxitjen e bashkëpunimit me partnerë të huaj, rritjen e vizibilitetit, asistencën e stafit akademik për përgatitje dhe menaxhim projektsh, etj.</p> <p>Gjithashtu, në dokumentin “Aspekte të veprimtarisë në kuadrin e Erasmus +” jepet informacion në lidhje me mobilitetet e kryera nga stafi në kuadrin e marrëveshjeve Erasmus. Një pjesë e stafit janë edhe pedagogë të angazhuar në programin e studimit MSHKF me profil.</p> <p>GVJ konfirmoi edhe gjatë vizitës në Institucion rezultatet shumë të mira të punës në drejtim të projekteve shkencore dhe aktiviteteve kërkimore. KUB ka bërë hapa të rëndësishëm drejt formimit të partneriteteve ndërkombëtare që vazhdojnë në kohë dhe ka shtuar numrin e projekteve ku është partner. GVJ vlerëson shumë pozitivisht punën në këtë drejtim dhe rezultatet e arritura sidomos për programin e studimit MSHKF me profil.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullore e Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.</i> 2. <i>Dokumenti “Aspekte të veprimtarisë në kuadrin e Erasmus +”</i>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ konstaton se në Strategjinë e KUB, Kërkimi Shkencor zë një vend të vecantë. Në pikën 5.6 të Strategjisë thuhet se KUB do të mbështesë të gjitha iniciativat për organizimin e Konferencave Shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar që i shërbejnë thellimit të dijeve shkencore të stafit akademik, të studentëve dhe të tërheqë përherë e më tepër mendimin më të avancuar shkencor bashkëkohor. Në kwtë Strategji përmendet gjithashtu qëllimi i KUB për të orientuar fokusin e tij tek studentët duke u krijuar dhe dhënë mundësinë që të angazhohen dhe të nxiten në aktivitete të ndryshme që nxjerrin në pah prirjet që ata kanë.</p>

	<p>Njësitë kryesore bashkëpunojnë me Qeverinë Studentore dhe me Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun për të mundësuar angazhimin e studentëve. Të gjitha këto u konfirmuan gjatë vizitës në Institucion gjatë së cilës GVJ vërejti angazhimin maksimal të të gjithë stafit akademik dhe studentëve në studime shkencore dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Tabelat e RVB.</i> 2. <i>Strategjia e KUB</i>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Nga tabelat e RVB, GVJ konstaton shkallën e përfshirjes së stafit pedagogjik dhe studentëve në studime dhe projekte. Këtu raportohet se janë gjithsej 12 studentë të Fakultetit të Ekonomisë që kanë kryer një mobilitet Erasmus + në harkun kohor 2017 – 2022; 14 përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ kanë kryer mobilitete për trajnime ose mësimdhënie; dhe është marrë një cmim ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor. Në total janë organizuar 10 aktivitete shkencore të organizuara nga njësia përgjegjëse për Programin e Studimit. Gjithashtu, në tabelat e RVB raportohet se për programin e studimit MSHKF me profil Kontabilitet Auditim janë angazhuar 12 studentë në punime shkencore individuale të pedagogëve (angazhimi i studentëve u konfirmua edhe gjatë vizitës në Institucion), 15 studentë në projekte shkencore në rang Departamenti, 30 studentë në projekte shkencore në rand Fakulteti dhe 17 studentë për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë. Edhe në dokumentin “Konferencat shkencore në vitet 2020, 2021 dhe 2022” paraqitet një përmbledhje e aktiveve shkencore përgjatë kësaj periudhe. GVJ gjykon për përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Tabelat e RVB.</i> 2. <i>Dokumenti “Konferencat shkencore në vitet 2020, 2021 dhe 2022”.</i>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit MSHKF me profil Kontabilitet Auditim të ofruar nga Fakulteti Ekonomik në KUB, një ndër objektivat formues të programit është edhe përgatitja e specialistëve të aftë në fushat e kontabiliteti, auditimit, ekspertëve fiskalë dhe financiarë. Në gjykimin e GVJ, ky objektiv është i arritshëm në mënyrë cilësore nëpërmjet tërësisë së njohurive që lëndët e programit ofrojnë në formën, strukturën dhe përmbajtjen me të cilën paraqiten në dosjen e DVV. Kjo tërësi lëndësh, mbështetet në programe të ngjashme ndërkombëtare, në materiale mësimore të përditësuar dhe cilësore dhe çfarë është më e rëndësishme ofrohet nga staf akademik i kualifikuar dhe me zë në fushën e disiplinave kontabël, financiare dhe audituese të cilët janë autoritete në fushën e tyre. Sipas të dhënave nga tabelat e RVB shihet gjithashtu se ndër studentët e diplomuar nga ky program studimi (në të dyja profilet) vitet e fundit, ka</p>

	<p>një numër të konsiderueshëm të studentëve të punësuar në përputhje me profilin përkatës (rreth 93%). Kjo konfirmon konkurrueshmërinë e programit të studimit dhe aftësinë e tij për të formuar specialistë të aftë në këto fusha.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e programit të studimit MSHKF me profil Kontabilitet Auditim.</i> 2. <i>Tabelat e RVB</i>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Sipas njohurisë që GVJ disponon në lidhje me organizimin e disa profesioneve të rregulluara dhe të licensuara në vend si profesioni i Kontabilistit të Miratuar, Audituesit Ligjor, dhe Audituesit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë, mund të konfirmojë se përmbajtja e programit të studimit, lëndët e përfshira në të dhe materiali i kërkuar, janë në përputhje me kërkesat për licensim përkatës. Po kështu, CV të stafit akademik të angazhuar (PAE dhe PAK) në programin e studimit, tregojnë që ata janë shumë të përfshirë në autoritetet standardvënëse dhe në shoqatat profesionale, duke lehtësuar komunikimin e informacionit dhe rrjeteve të tyre të njohjes edhe në favor të Institucionit, programit të studimit, dhe vetë studentëve. Këta të fundit mund të shfrytëzojnë gjithë bagazhin e formimit profesional të profesorit në funksion të rritjes në karrierat e tyre.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>RVB e programit të studimit</i> 2. <i>Programet lëndore të programit të studimit</i> 3. <i>CV të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit</i>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Në gjykimin e GVJ ky kriter nuk lidhet me programin e studimit MSHKF në KUB. (<i>Në RVB të Institucionit përmenden Direktivat Rregulluese në fushën e Kontabilitetit dhe Auditimit në BE, por një pjesë e këtyre direktivave janë tashmë të shfuqizuara.</i>)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Pasi analizoi me kujdes këtë standard, GVJ ka formuar opinionin se programi i studimit MSHKF me profil Kontabilitet Auditim në KUB kompletton njohuritë e studentëve duke garantuar formimin akademik dhe shkencor të tyre si edhe jep lehtësi në certifikime profesionale të mëtejshme në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Në DVV ka evidencë për bashkëpunimin e departamentit përgjegjës për ofrimin e programit të studimit me struktura brenda KUB (si Zyra për Projekte dhe Kërkimin Shkencor), por edhe me partnerë jashtë Institucionit në favor të thellimit të njohurive shkencore dhe projekteve kërkimore të cilat janë në funksion të institucionit në tërësi por edhe të programit të studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1											
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.											
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ shqyrtoi Planin Mësimor të Programit të Studimit MSHKF në KUB, dhe tërësinë e syllabuseve të lëndëve të ofruara në këtë program studimi duke konstatuar format e mëposhtme të mësimdhënies: leksione, seminarë, praktikat profesionale dhe provime formimi/diploma.</p> <p>Tabela 13 në RVB jep informacionin e detajuar sa më poshtë:</p> <table border="0"> <tr> <td>• Leksione</td> <td>450 orë</td> </tr> <tr> <td>• Seminarë</td> <td>450 orë</td> </tr> <tr> <td>• Praktikë profesionale</td> <td>75 orë</td> </tr> <tr> <td>• Diploma/ Provim Formimi</td> <td>300 orë</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>1.275 orë</td> </tr> </table> <p>GVJ konfirmon shpërndarjen e formave të mësimdhënies dhe kontrollit të njohurive mes kategorive të ndryshme por edhe të shtrira në kohë përgjatë gjithë semestrit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tabelat e RVB 2. Syllabuset e lëndëve të programit të studimit. 	• Leksione	450 orë	• Seminarë	450 orë	• Praktikë profesionale	75 orë	• Diploma/ Provim Formimi	300 orë	Totali	1.275 orë
• Leksione	450 orë										
• Seminarë	450 orë										
• Praktikë profesionale	75 orë										
• Diploma/ Provim Formimi	300 orë										
Totali	1.275 orë										
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit MSHKF në KUB në nenet 11 & 12 të saj parashikon format e mësimdhënies dhe detyrimet e studentit ndaj lëndës. Format e mësimdhënies janë të larmishme që nga leksionet, seminarët, ushtrimet, detyra kursi, dhe projekte cka, në gjykimin e GVJ ofron mënyra të ndryshme dhe nxitëse për mësimnxënie nga ana e studentëve. Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ formoi përshtypjen se stafi akademik nxiste angazhimin e vazhdueshëm të studentëve duke u dhënë mundësinë atyre të shprehnin talentet e tyre sipas individualitetit të cdo studenti. Vetë studentët vinin të interesuar tyë mësonin më shumë në funksion të zgjerimit të njohurive teorike por edhe të aftësive praktike të tyre. Bëhen leksione të hapura dhe pedagogët janë efektivë</p>										

	<p>gjatë këtyre leksioneve pasi studentët bëhen më të përfshirë. Pedagogët i përshtasin metodat e mësimi në përputhje me orientimiin që ata kanë dhe interesat e tyre. Ata janë studentë të punësuar dhe shpesh orientohen në bazë të punësimit të tyre dhe pyetjeve konkrete që lidhen me to.</p> <p>Edhe infrastruktura institucionale që është në funksion të këtij program studimi dëshmon për kushte të optimale të zhvillimit të programit mësimor. Cdo klasë ishte e pajisur me tabela dhe mjete audiovizive (kompjuter dhe laptop) të cilat, sipas studentëve të programit të studimit përdorëshin paralelisht nga stafi akademik dhe zgjonin interes tek studentët.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e programit të studimit.</i> 2. <i>Vizita e ambienteve të Institucionit.</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri, GVJ gjykon me rëndësi konfirmimin e e përmirësimi të vazhdueshëm të aftësive pedagogjike – didaktike të stafit PAE dhe PAK. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ dëshmoi faktin e një niveli shumë të ulët të rotacionit të stafit. Prezenca e stafit për një kohë të gjatë dhe fakti që nuk ka rotacion të shpeshtë dëshmon për seriozitetin e institucionit në angazhimin e stafit. Stafi dëshmon se punon me pasion për të dhënë njohuri studentëve dhe angazhohet për të qenë vazhdimisht në mbështetje të studentëve nëpërmjet informimit të vazhdueshëm të tyre në lidhje me mundësitë – si internship, konferenca etj. dhe komunikimi i hapur në lidhje me feedback të studentëve. Përpos pjesës akademike dhe praktike stafi akademik e shihte fort të rëndësishëm edhe rolin e mentorit dhe këshilluesit të karrierës pr studentët. Këta të fundit vazhdimisht kërkojnë opinion për orientimin e tyre në lidhje me situatat e caktuara si psh si të pozicionohen në tregun e punës, si të rriten në karrierë dhe si të zgjedhin vende pune të mira dhe afatgjata. Të pasurit e një qasje fleksibël dhe idetë inovatore nga ana e institucionit është shumë mirë për të përfshirë studentët dhe për t'i motivuar dhe GVJ mbështet përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Analiza e aktivitetit</i>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ shqyrtoi kuadrin e formimit akademik dhe profesional të stafit të angazhuar në programin e studimit MSHKF në KUB dhe duke gjykuar nga backgroundi i tyre konfirmon kompetencën dhe përgatitjen e stafit për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve në funksion të arritjes së objektivave të të nxënit. Stafi i KUB jo vetëm janë emra të njohur në profesion në vendin tonë por kanë një nivel të lartë të arsimit dhe trajnimeve profesionale jashtë vendit.</p> <p>Sic edhe vetë stafi u shpreh gjatë vizitës në Institucion, ata gjithashtu përdorin metoda të larmishme në mësimdhënie për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve. Theksi nga ana e pedagogëve është edhe tek parimet etike të profesionit kontabël dhe auditees cka afrohet jo vetëm si kaputll në cdo lëndë të profesionit në programin e studimit por është edhe si lëndë e vecantë – Etika e avancuar. Sipas shprehjeve të vetë stafit gjatë vizitës në Institucion, procesi mësimor konsiderohet i shenjtë dhe është proces serioz dhe marrëdhënia me studentët është për të nxitur mendimet e lirshme të studentëve.</p> <p>Nga ana e pedagogëve merren situata konkrete dhe diskutohen me studentët, ngrihen pyetje kërkimore dhe bëhen kërkime shkencore serioze duke ndjekur metoda interaktive. Kjo angazhon studentët dhe i bën ata më të lirshëm gjatë orëve të mësimt.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Lista e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi 2016 - 2022.</i> 2. <i>Lista e pedagogëve të arsimuar e të kualifikuar jashtë.</i>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi si pjesë të DVV edhe pyetësorët për vlerësimin e procesit mësimor nga ana e studentëve për disa programe studimi të ofruara në KUB. Sipas këtyre pyetësorëve, studentët vlerësojnë përmbajtjen e lëndës, si edhe angazhimin e stafit akademik në përcimin e informacionit të lidhur me lëndën. Pyetësorët me studentët administrohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas rregullores së kësaj të fundit dhe në përputhje me qëllimin e funksionimit të njësisë për të garantuar cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Gjatë vizitës në Institucion u konfirmua me stafin dhe studentët se këta pyetësorë shpërndahen dhe plotësohen gjatë javës së fundit të mësimt dhe para organizimit të provimit përfundimtar të lëndës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023</i> 2. <i>A3.42 Formular i Vleresimit te Vazhduar dhe Perfundimtar</i> 3. <i>Rregullore e NJSBC (Dokumenti A5.78)</i>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë</p>	<p>Sic GVJ konfirmon nga përmbajtja e DVV, Institucioni ka miratuar ngritjen e disa strukturave në funksion të garantimit të cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik, KUB ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Këshillin e Etikës, Zyrën e Kurrikulave dhe Komisionin e Promovimit të Veprimtarive Shkencore dhe Kualifikuese të Stafit Akademik. Në gjykimin e GVJ këto struktura ndihmojnë Institucionin në garantimin e një procesi cilësor didaktik. Më</p>

<p>përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>tejt nga shqyrtimi i Rregullores së NJSBC, shihet se kjo njësi mbështet zhvillimet inovatore të procesit mësimor dhe ndjek problemet që kanë lidhje me aktivitetet dhe dokumentet për vlerësimin e programeve të studimit në nivel institucional.</p> <p>Vetë stafi e konfirmon mbështetjen institucionale në këtë drejtim dhe konfirmon kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme, kryesisht në kuadrin e shkëmbimeve Erasmus+ ku jepet mundësia e rritjes profesionale të stafit dhe e ndërkombëtarizimit të Institucionit në përgjithësi.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendimi i senatit nr.1;14 Date 14.10.2022 2. Rregullore e NJSBC (Dokumenti A5.78) 								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Universitar i Biznesit ka ngritur strukturat e nevojshme që garantojnë kryerjen cilësore të procesit mesimor dhe didaktik në programet e studimit që ofron. Institucioni gjithashtu angazhohet në trajnime të vazhdueshme të stafit në kuadër të marrëveshjeve të shkëmbimit Erasmus + me partnerë të tjerë jashtë vendit, sic dëshmohet gjatë vizitës në Institucion. GVJ gjithashtu konfirmoi aplikimin e metodave të ndryshme të kontrollit të njohurive tek studentët dhe modele të larmishme mësimdhënie të cilat nxisin një atmosferë bashkëpunuese në klasë. GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1003 766 1086">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="766 1003 965 1086">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="965 1003 1165 1086">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1165 1003 1402 1086">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1086 766 1122"></td> <td data-bbox="766 1086 965 1122"></td> <td data-bbox="965 1086 1165 1122"></td> <td data-bbox="1165 1086 1402 1122" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregullorja e Programit të Studimit MSHKF në KUB, në nenet 11 dhe 12 të saj parashikon me detaje mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe dijeve të studentëve. Kontrolli i dijeve realizohet me shkrim, me gojë, ose në mënyrë të kombinuar. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe pikët për notën finale janë rezultat i kombinimit të elementëve si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i vazhduar (1 – 40 pikë) (pjesëmarrje 10 pikë, aktivizim 10 pikë, teste e detyra kursi, 20 pikë). 2. Provimi përfundimtar (1 – 60 pikë)
	<p>Sipas rregullores, vlerësimi i vazhduar në masën 40% është i detyrueshëm, por në raste të lëndëve aplikative, pedagogu dhe titullari i modulit kanë të drejtën të organizojnë një shpërndarje të ndryshme të peshës së elementeve të vlerësimit të vazhduar duke e përcaktuar atë në programin lëndor.</p> <p>Sic GVJ konstatoi, kriteret e testimit dhe vlerësimit të njohurive ishin përfshirë gjithashtu edhe në programet lëndore sipas kërkesave të</p>

	<p>kuadrit përkatës ligjor dhe ishin të njohura nga ana e studentëve të programit në orën e parë të çdo lënde ku bëhet shpjegimi i përmbajtjes së lëndës dhe i detyrimeve të studentit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e Programit të Studimit.</i> 2. <i>Programet Lëndore.</i> 										
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Programet lëndore parashikojnë prezantimin e përmbajtjes, organizimit, literaturës dhe detyrimeve të studentit në orën e parë të secilës prej tyre.</p> <p>Nga takimi me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lënde/moduli me elementet e lëndës, ndër të tjera edhe me metodologjinë e vlerësimit. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit nëpërmjet mënyrave të brendshme të komunikimit mes studentëve dhe pedagogëve të programit që ishin emailt institucionale me të cilën pajisen të gjithë studentët e programit të studimit. Gjithashtu, mënyra e përgjithshme e vlerësimit me notë bëhet me dije edhe në Guidën Studentore që është një material publik dhe lehtësisht i aksesueshëm. Pra GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht pasi studentët janë të informuar në lidhje me elementët e lëndës në mënyra të ndryshme.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Programet Lëndore</i> 2. <i>Guida studentore</i> 										
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sic GVJ është shprehur edhe më lart, nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të Studimit, MSHKF në KUB ofron mënyra të larmishme të testimit dhe vlerësimit të njohurive. Këto forma vlerësimi janë përmbledhur edhe në tabelat e RVB dhe GVJ konstatoi se respektohet në pothuajse të gjitha programet lëndore që pati mundësinë të shqyrtonte.</p> <table border="0" data-bbox="608 1368 1177 1536"> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Testimet gjatë vitit</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>60%</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>100%</td> </tr> </table> <p>GVJ gjykon se përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin njohuritë dhe kompetencat e fituara në njërin ose disa prej formave të zgjedhura të vlerësimit të njohurive (me shkrim, ose me gojë), të cilat duke qenë edhe të shpërndara përgjatë semestrit paraqesin vlerësim të vazhduar për studentët duke u dhënë mundësinë të angazhohen në forma të përshtatura për ta.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Tabelat e RVB</i> 2. <i>Rregullorja e Programit të Studimit MSHKF në KUB</i> 	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%	Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)	10%	Testimet gjatë vitit	20%	Provimi përfundimtar	60%	Totali	100%
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%										
Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)	10%										
Testimet gjatë vitit	20%										
Provimi përfundimtar	60%										
Totali	100%										

Konkluzione	<i>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe informacionet e lidhura me mënyrën e vlerësimit të studentëve të programit MSHKF në KUB, si Rregulloren e Programit të Studimit, Programet Lëndore dhe tabelat e RVB formoi bindjen se mënyra e vlerësimit në këtë program përfshin forma të ndryshme kontrolli dhe testimi. Këto forma të ndryshme të vlerësimit të njohurive, bëhen pjesë e rregulloreve të posacme dhe u komunikohen studentëve para fillimit të lëndës. Ato mund të garantojnë një shpërndarje dhe mbulim të mirë të vlerësimit të cdo studenti në këtë program pasi janë të shpërndara gjatë semestrit dhe kanë modalitete të ndryshme testimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>GVJ konstatoi se sipas Rregullores së Programit të Studimit MSHKF në KUB, kontrolli i dijeve realizohet me shkrim, me gojë, ose në mënyrë të kombinuar. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe pikët për notën finale janë rezultat i kombinimit të elementëve: (1) Vlerësimi i vazhduar (1 – 40 pikë) (pjesëmarrje 10 pikë, aktivizim 10 pikë, teste e detyra kursi, 20 pikë); dhe (2) Provimi përfundimtar (1 – 60 pikë). Po sipas rregullores, vlerësimi i vazhduar në masën 40% është i detyrueshëm.</p> <p>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10%</p> <p>Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj) 10%</p> <p>Testimet gjatë vitit 20%</p> <p>Vlerësimi i vazhduar total 40%</p> <p>Provimi përfundimtar 60%</p> <p>GVJ konstatoi gjithashtu se kjo mënyrë e parashikuar në rregullore zbatohet në të gjitha programet lëndore të shqyrtuara. Vlerësimi i studentëve bëhet në Portalin Studentor të KUB.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Rregullorja e programit të studimit MSHKF në KUB</i> <i>Programet Lëndore</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në RVB të Institucionit për këtë kriter, citohen të jenë përdorur mënyrat elektronike të vlerësimit gjatë mësimit online dhe GVJ nuk konstaton në DVV evidencë për aplikime të tjera të metodave elektronike të vlerësimit. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi u shpreh se për shkak të numrave të studentëve, përdorimi i mjeteve elektronike të vlerësimit për provimet përfundimtare nuk paraqitet efektiv, por që abuzimi në vlerësim dhe rritja e transparencës garantohej nga procedura e sekretimit të fletoreve të studentëve. Kjo procedurë u konfirmua në

	<p>mënyrë të pavarur edhe nga studentët e programit por edhe nga sekretaria e KUB. GVJ mbështet përmbushjen e plotëtë këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve në programin e studimit MSHKF në KUB është shtjelluar nga GVJ në kriteret më lart dhe gjendet e përfshirë në mnyrë transparente në rregulloren e programit të studimit si edhe në programet lëndore përkatëse / syllabuse. Vlerësimi me notë bëhet mbështetur në totalin e vlerësimeve gjatë vitit dhe provimit përfundimtar (Rregullorja e programit të studimit, neni 12, pika 2) dhe është sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me nota kaluese nga 5 deri në 10 dhe me intervale prej 10 pikësh për cdo notë. Kjo mënyrë vlerësimi përfshihet gjithashtu edhe në syllabuset e cdo lënde tek seksioni i Tabelës së Vlerësimit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi me stafin dhe studentët e programit se vlerësimi përfundimtar i lëndës ndjek formën dhe mënyrën e parashikuar një rregullore dhe syllabus dhe nuk ka shmangie nga ky rregull. Shmangie nuk kishte pasur as gjatë procesit mësimor online dhe as më vonë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Rregullore e programit të studimit MSHKF në KUB.</i></p> <p>2. <i>Programet lëndore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, Institucioni thekson kujdesin që ka pedagogu i lëndës që të bëjë vlerësime me komentet e nevojshme të cilat diskutohen individualisht me cdo student në mënyrë që këta të fundit të informohen për performancën e tyre në një element të caktuar të vlerësimit si edhe të mund të japin një feedback nëse kjo është e nevojshme. Notat dërgohen në sekretari dhe hidhen në regjistrat e vlerësimeve vetëm pasi bëhet ballafaqimi me studentin.</p> <p>Kjo praktikë u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion në bisedat me stafin dhe studentët e programit të studimit. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren Institucionale (nenet 13 & 14), GVJ konstaton se janë parashikuar procedura të posacme në lidhje me zhvillimin e provimeve, dhe disa nga këto rregulla janë në funksion të shmangies së plagjiaturës dhe kopjimit. Studentëve nuk u lejohet të përdorin pajisje celulare në provim, për cdo 40 studentë caktohet minimalisht një pedagog në administrimin e sallës, tezat e provimit përgatiten në më shumë se një variant, tezat e provimit ndryshohen në cdo sezon provimi etj.</p> <p>Përvec sa parashikohet në Rregulloren Institucionale dhe në Rregulloren e Programit të Studimit, GVJ u bind edhe gjatë vizitës në Institucion, se plagjiatura merrej seriozisht dhe ndaj studentëve</p>

	<p>merreshin masa si përjashtimi i tyre nga sezoni përkatës i provimeve dhe dhënia e paralajmërimit për mospërsëritjen e akteve anti etike në provime.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e Institucionit</i> 2. <i>Rregullorja e Programit të Studimit MSHKF në KUB</i>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e përgjithshme të institucionit, rezultati i provimit i komunikohet studentëve brenda afateve të parashikuara (neni 14) që është jo më vonë se një javë nga data e kryerjes së provimit. Ky afat përgjithësisht u konfirmua se respektohej edhe gjatë vizitës së GVJ në Institucion ku nuk u konstatuan shmangie. Kominukimi i rezultatit të provimit bëhet individualisht për çdo student nga pedagogu i lëndës ose nga sekretaria mësimore dhe me numër ID të çdo studenti, në faqen e pedagogut në Portalin e KUB ose duke ia dërguar secilit student në adresën email që ai ka në KUB (neni 14, rregullorja e programit të studimit).</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e Institucionit</i> 2. <i>Rregullorja e Programit të Studimit MSHKF në KUB</i>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (nenet 14, 15, 16) GVJ konstatoi se nga ana procedurale ishte parashikuar se pas shpalljes së rezultateve paraprake, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij. Afati për këtë hap të procesit është tre ditë. Ankesa bëhet me shkrim pranë sekretarisë mësimore e cila ka edhe përgjegjësinë për të arkivuar dokumentacionin shoqërues (ankimin e studentit dhe procesverbalin e provimeve). Procedura të vecanta në këtë drejtim Institucioni ka parashikuar në Rregulloren e zhvillimit të provimeve të KUB.</p> <p>Procedurat e zhvillimit të provimeve u bëhen me dije studentëve dhe ndiqen rigorozisht nga Institucioni sic edhe e konfirmon GVJ. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Rregullorja e Programit të Studimit.</i> 2. <i>Dokumenti A3.39 në DVV, Procedurat e provimeve</i> 3. <i>Rregullorja e zhvillimit të provimeve në KUB.</i>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në rregulloret përkatëse, GVJ konstatoi se nga ana procedurale ishte parashikuar se studentët kanë të drejtë të apelojnë për vlerësimin e provimit përfundimtar duke paraqitur një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore jo më vonë se tre ditë pune nga data e shpalljes së rezultateve të provimeve në sekretari. Kërkesa e studentit duhet t'i drejtohet Departamentit përkatës që është përgjegjës për programin përkatës të studimit. Në këto raste, Departamenti ngre një komision i cili ngarkohet të rishikojë vlerësimin e dhënë nga pedagogu dhe jep përgjigje e cila sipas rregullores do të konsiderohet e formës përfundimtare.</p>


	<p>Sipas rregullores së KUB, dokumentacioni mbështetës për administrimin e procedurës së ankimimit ruhet në një kopje pranë sekretarisë mësimore si edhe i dërgohet në një kopje edhe përgjegjësit të njësisë kryesore që është përgjegjëse për programin e studimit të ofruar. Kjo procedurë u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion. Kriteri përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e Programit të Studimit. 2. Rregullore Institucionale e KUB 3. Dokumenti A3.39 në DVV, Procedurat e provimeve 		
Konkluzione	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin në DVV si Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren e programit të studimit MSHKF në KUB duke konstatuar parashikimin në to të gjitha procedurave të nevojshme në lidhje me vlerësimin e studentëve, procedurën e ankimimit dhe rishikimit të vlerësimit, si edhe vlerësimin përfundimtar të tyre dhe arkivimin e dokumentacionit shoqërues. Vlerësimi i studentëve në këtë program studimi bëhet me notë kaluese nga 5 deri në 10. Nota duhet të shpallet deri në një javë pas provimit dhe studentët kanë tre ditë afat për procedurën e ankimimit. Gjatë procedurës, departamenti ngre një komision të posacëm i cili shqyrton kërkesën e studentit dhe merr një vendim të formës përfundimtare për vlerësimin. Dokumentacioni i plotë administrohet në një kopje nga sekretaria mësimore dhe një kopje nga njësia kryesore e cila ofron programin e studimit. Në përputhje me sa më lart, GVJ është e mendimit se ky kriter përmbushet plotësisht</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Dhënë tërësinë e lëndëve të përfshira në këtë program studimi si edhe përmbajtjet e detajuara të tyre në cdo program lëndor, sic janë shqyrtuar nga GVJ, garantohet thellimi i njohurive profesionale aplikative në fushat e financës, kontabilitetit dhe auditimit por edhe aftësimi i studentëve për t'u angazhuar në veprimtari me fokus të vecantë kërkimin shkencor. Programi MSHKF në KUB ka potencialin që të përgatisë profesionistë kontabël dhe auditues të aftë si edhe të mprehë aftësitë shkencore të tyre nëpërmjet detyrave, projekteve dhe praktikave profesionale si edhe ofrimin e lëndëve si metodologji kërkimi dhe ekonometri. Në nenin 19 të Rregullores së programit të studimit parashikohen klauzola lidhur me punën shkencore si pjesë e të gjithë procesit të arsimimit në programin e studimit. Puna shkencore do të realizohet si gjatë orës së mësimimit ashtu edhe në organizimin e</p>

	<p>veprimtarive kërkimore e shkencore nga studentët gjatë realizimit të programit mësimor në formën e eseve dhe detyrave të kursit me karakter aplikativ. Rregullorja specifikon se prioritet duhet të ketë organizimi i debatit akademik për të gjitha veprimtaritë me peshë në formimin e studentëve për fushën e programit të studimit dhe organizimi i debateve akademike në bashkëpunim me strukturat e administratës publike e private në terren dhe programet e studimeve. Sipas rregullores, puna individuale e studentëve duhet të orientohet në mënyrë të tillë që ata të angazhohen në hulumtim dhe studime sipas fushave dhe pasurimit të lëndëve dhe moduleve dhe GVJ konfirmon ndjekjen në realitet të kësaj praktike duke bërë që ky kriter të përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Plani mësimor i programit të studimit.</i> 2. <i>Programet Lëndore</i> 3. <i>Rregullorja e Programit të Studimit MSHKF në KUB.</i>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor (tabelat në RVB), GVJ konstatoi se ka disa lëndë të cilat fokusohen në trajtimin e elementeve që lidhen me teknologjinë dhe kompjuterizimin si lënda sistemet e informacionit të menaxhimit, apo edhe me Etikën (lëndë me zgjedhje, Etika e Avancuar), në përshtatje kjo me zhvillimet e profesionit të kontabilistit dhe audituesit në vitet e fundit. GVJ vlerëson pozitivisht ofrimin e lëndës së Etikës së Avancuar e cila synon të zgjojë tek studentët ndërgjegjësimin për dimensionin human e social të profesionit të kontabilistit dhe audituesit në përputhje kjo edhe me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit në profesionin përkatës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Plani mësimor i programit të studimit.</i> 2. <i>Tabelat në RVB</i>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Nga analiza e programeve lëndore, GVJ konstatoi se në to është parashikuar një përmbledhje e lëndës në javën e fundit (të 15të) të zhvillimit të procesit mësimor. Vec kësaj, të gjitha programet lëndore kanë të përfshira si një seksion të vecantë në fillim të tyre “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit”, kjo në përputhje edhe me kërkesat e VKM nr.41 të ndryshuar. Ky element liston përfitimet e pritshme nga cdo lëndë e programit për të mbërritur në përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në Institucion u konstatua se stafi akademik ia dedikon javën e fundit të semestrit një përmbledhjeje të njohurive të marra dhe përgatitjes së studentëve për provimin përfundimtar të lëndës që është edhe detyrimi përmblyës i cdo lënde.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Programet lëndore</i>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë</p>	<p>Plani Mësimor i Programit të Studimit MSHKF në KUB parashikon praktika profesionale në semestrin e fundit të studimeve si një instrument për praktikimin e njohurive teorike të përfuara gjatë</p>

<p>njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikata profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>studimeve. Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, GVJ formoi përshtypjen se ata ishin të hapur për të nxitur bashkëpunimin e studentëve, punën e tyre në grup me qëllim aftësimin për problemzgjdhje të çështjeve komplekse. Stafit përmendi përdorimin e metodave interaktive si puna në laboratore të informatikës me platforma të fokusuar në menaxhimin e portofoleve dhe menaxhimin e riskut cka i angazhon studentët gjatë procesit mësimor; raste studimore dhe detyra kursi që nxisin studentët për të punuar në grup dhe për të ndarë përvojat e tyre; përdorimi i softuerëve kontabël në mësimdhënien e lëndëve me profil kontabël (raportim financiar ose taksimi i avancuar). Studentët janë aktivë nëse angazhohen me metoda interaktive gjatë procesit mësimor. Ata angazhohen me internship dhe praktika. Vetë studentët u shprehën pozitivisht për klimën suportuese nga stafi i Institucionit dhe dëshmojnë për mbështetjen që kanë pasur në këtë drejtim.</p> <p>Puna shkencore në Institucion dhe në funksion të programit të studimit reerohet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në Rregulloren e programit të studimit. Në nenin 19 të kësaj rregulloreje përmenden qëllimet e punës shkencore të stafit akademik dhe studentëve si veprimtari që duhet të jenë të mirëorganizuar dhe të orientuara në mënyrë të tillë që të angazhohen në hulumtime e studime sipas fushave.</p> <p>GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumenti A4.53 – Leksione të hapura 2. Rregullorja e Programit të Studimit MSHKF në KUB.
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Si pjesë të DVV, GVJ ndeshi edhe evidencë për leksione të hapura që janë zhvilluar në KUB dhe që demonstrojnë ndërthurjen e mësimdhënies nga stafi i Institucionit me të tjerë partnerë bashkëpunues për të mundësuar trajtimin e ideve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë lidhur me programin specifik të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion dhe diskutimeve me stafin e programit të studimit dhe studentët përkatës, GVJ u bind më tej për jetën e pasur akademike në KUB cka dëshmon për përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumenti A4.53 – Leksione të hapura
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuar kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>GVJ është e mendimit se Institucioni plotëson këtë kriter dhe angazhohet në mënyrë të evidentuar në avancimin e ideve inovatore të studentëve pasi janë organizuar një sërë konferencash shkencore në të cilat studentët kanë qenë në fokus. KUB rezulton të ketë zhvilluar gjithsej katër konferenca studentorë (në vitet 2016, 2018, 2019, dhe 2021) dhe dy konferenca të përbashkëta ndërkombëtare me bashkëpunim me institucionet partnere. Kontributi financiar i Institucionit ka qenë në drejtim të organizimit të këtyre konferencave sic edhe evidentohet në DVV.</p>





	<i>Referencë:</i> 1. Dokumenti A2.30 Lista e Konferencave Studentore Shkencore.		
Konkluzione	GVJ mbështet shkallën e përmbushjes së plotë të këtij kriteri pasi Institucioni tregon nëpërmjet evidencave në DVV se ka një shkallë të lartë angazhimi në avancimin e ideve inovatore të studentëve duke i mbështetur ata të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre mësimor, dhe kërkimor duke organizuar konferenca studentore dhe duke kërkuar angazhimin e studentëve edhe në konferenca dhe evente të tjera kërkimore-shkencore të Institucionit. Mësimdhënia kryhet në mënyrë profesionale nga një staf cilësor akademik dhe profesional i njohur në këtë fushë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Sipas nenit 18 të Rregullores së Programit të Studimit MSHKF në KUB, detyrim përmbyllës është përgatitja e diplomës në mënyrë individuale. Diploma në përfundim të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në Kontabilitet Financë me profil Kontabilitet Auditim mbrohet me temë diplome (neni 18, pika 1). Tema e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite ECTS sipas Planit Mësimor. Fakulteti vendos në dispozicion të studentëve udhëzimin për punimin e diplomës dhe fazat e përgatitjes së punimit dhe kjo kërkohet sipas nenit 18, pika 3 e rregullores së programit të studimit. Përveç sa është parashikuar në rregulloren e programit të studimit, institucioni përgatit edhe një urdhër të rektorit për mbrojtjen e diplomave ku caktohen komisionet përkatëse, datat dhe modalitete të tjera në përputhje me rregulloren përkatëse. <i>Referenca:</i> 1. Rregullorja e programit të studimit. 2. Dokumenti A3.41 Urdher rektori per mbrojtje diplome. 3. Dokumenti A3.41 Udhezim Mikroteze. Model vleresimi te mikrotezes Udheheqes Anetar Komisione
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas Rregullores së Programit të studimit (neni 18) dhe konfirmuar edhe gjatë vizitës në Institucion, studenti ka të drejtë të zgjedhë si udhëheqës një pedagog me eksperiencë sipas përcaktimeve të drejtuesit të njësisë bazë. Për realizimin e punimit, dekani nxjerr urdhrin përkatës për caktimin e udhëheqësve të temave të studentëve. Sipas rregullores, studenti është i detyruar të respektojë afatet e përcaktuara në programin e punimit të diplomës dhe të këshillave të udhëheqësit shkencor.

	<p>Gjatë vizitës në Institucion GVJ konfirmoi se studentët e programit ishin aktualisht duke punuar me temat e diplomës me pedagogët udhëheqës të zgjedhur prej tyre. KUB asiston nëpërmjet vënies në dispozicion të sallave të laboratorit për punimin e temës si edhe bibliotekës elektornike (JSTOR) për shfrytëzimin e materialeve për shqyrtimin e literaturës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e programit të studimit. 2. Dokumenti A3.41 Urdher rektori per mbrojtje diplome
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, detyrimet përmbyllëse për programin e studimit MSHKF në KUB parashikojnë vetëm përgatitje të punimit të diplomës dhe jo provim final.</p> <p><i>Pra ky kriter nuk ka aplikim për këtë program studimi.</i></p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e programit të studimit.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit dhe udhëzimit për përgatitjen e diplomës në KUB, udhëheqësi i punimit të diplomës asiston studentët në procesin e diplomimit duke përcaktuar grafikun e konsultimeve përgjatë të cilave kontrollohet ecuria e përgatitjes së punimit dhe i udhëzon ata për elemente të nevojshme të këtij procesi. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga student dhe lejon mbrojtjen e punimit duke plotësuar një formular të vlerësimit të studentit.</p> <p>Kjo procedurë e parashikuar në rregulloren e programit të studimit dhe në paketën orientuese u konfirmua edhe nga stafi dhe studentët gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>GVJ konfirmon në DVV dokumentacionin shoqërues.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e programit të studimit. 2. Dokumenti A3.41 Udhezim Mikroteze. Model vleresimi te mikrotezes Udheheqes Anetar Komisione
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Referuar parashikimeve të nenit 19 të Rregullores së Programit të Studimit në lidhje me punën shkencore, vihet re se Institucioni i mëshon rëndësi të vecantë alternimit të kërkimit shkencor dhe sidomos aplikimit të saj në fazën e përgatitjes së punimit të diplomës. Vetë studentët dhe stafi i programit të studimit, gjatë vizitës në Institucion u shprehën pozitivisht për mbështetjen institucionale në këtë faze qoftë nëpërmjet shfrytëzimit të ambienteve të KUB, aksesit në bibliotekën fizike apo online për shfrytëzimin e materualeve por sidomos asistencës së përhershme nga stafi i Institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e programit të studimit

<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të punimit të temës së diplomës, studentët vlerësohen me nota sipas sistemit shqiptar, (neni 18, pika 2 e rregullores së programit të studimit) dhe të vlerësuara gjithashtu edhe në kreditë ECTS. Nota i komunikohet studentëve në përfundim të mbrojtjes me gojë të punimit të diplomës para komisionit të ngritur për këtë qëllim.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në Institucion, konfirmoi pranë sekretarisë mësimore vlerësimet me notë të studentëve dhe regjistrin e posacëm të diplomave.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Rregullorja e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Rregullorja Institucionale e KUB si edhe Rregullorja e Programit të studimit parashikojnë se studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Kontabilitet Financë me profil Kontabilitet Auditim në zbatim të kësaj rregulloreje pajisen me diplomën përkatëse universitare e cila përmban emërtimin e fakultetit dhe të programit të studimit.</p> <p>Pajisja me diplomë e studentëve mbështetet nga GVJ në bazë të verifikimit në vend të regjistrin të lëshimit të diplomave verifikuar në sekretarinë mësimore të KUB.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Rregullorja e KUB.</i></p> <p>2. <i>Rregullorja e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas RVB të plotësuar nga Institucioni për këtë kriter, dokumentacioni i plotë në lidhje me studentët në KUB, administrohet nga sekretaria mësimore. Kur studenti diplomohet apo largohet, dosja e tij transferohet në arkivën e institucionit në përputhje me bazën përkatëse ligjore. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë që të kërkonte informacione për studentët aktualë dhe ata të diplomuar pranë sekretarisë mësimore. Ndër këto informacione, u kërkuan të dhëna edhe në lidhje me studentët e diplomuar dhe u konstatua përmbushja e kërkesave për informacion të paraqitur nga ana e tyre. Sipas konfirmimit të GVJ, sekretaria mësimore mban në mënyrë të rregullt informacionet për studentët si të dhëna të përgjithshme në lidhje me ta që nga momenti i fillimit të studimeve si formularët e regjistrimit, kopje e dokumnetit ID, kontrata e lidhur me studentët, ashtu edhe evidenca gjatë studimeve si evidencat për vlerësimet dhe notat, etj.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se në dokumentacionin e DVV të paraqitur nga Kolegji Universitar i Biznesit janë përshkruar në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmblylëse të programit të studimit. MSHKF me profil Kontabilitet Auditim në KUB parashikon si detyrim përmblylëse përgatitjen e punimit të diplomës. Punimi i</p>

	<i>diplomës është individual dhe punohet në udhëheqjen shkencore të një pedagogu me eksperiencë nga KUB. Gjatë punës, student ka të drejtën të orientohet dhe asistohet nga pedagogu udhëheqës dhe të shfrytëzojë infrastrukturën e institucionit për këtë qëllim. Në përfundim të procesit të diplomës studenti pajiset me diplomë “Master i shkencave në Kontabilitet Financë me profil Kontabilitet Auditim” si edhe me suplementin e diplomës. Bazuar në këto elemente që u verifikuan edhe për shkallën e realizimit të tyre gjatë vizitës në Institucion, GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfuturit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet pasi programi i studimit është Master i Shkencave.		
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi pasi nuk parashikohet kryerja e praktikave klinike apo stazheve dhe programi i studimit është Master i Shkencave.		
Kriteri 3. Praktikatat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter nuk aplikohet pasi programi i studimit është Master i Shkencave.		
Konkluzione	N/A		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																																						
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																																						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																					
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ, referuar shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të DVV, (Dosjes së Programit të Studimit si dhe të dhënave tabelare për personelin akademik) konstaton se; Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit si njësi bazë për këtë program studimi, ka në përbërje personel akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohen në realizimin me sukses të programit të studimit, Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” me profil: Kontabilitet Auditim. Të dhënat për personelin akademik përgjegjës për programin e studimit paraqiten si më poshtë:																																																					
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik për Programin e Studimit</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>7</td> <td>7</td> <td>7</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit akademik për Programin e Studimit	2022-2023		2021-2022		2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	2	2	1	2	1	3	Prof. Asoc.	0	1	1	1	1	1	Dr./PhD.	3	1	4	1	3	1	MSc.	2	1	1	3	2	4	Totali	7	5	7	7	7	9	Për sa i përket kualifikimeve të Personelit Akademik: <ol style="list-style-type: none"> Për vitin akademik 2020-2021, 62.5% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 37.5% janë me Msc; Për vitdemik 2021-2022, 71% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 29% janë me Msc; Për vitin akademik 2022-2023, 75% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, 25% janë me Msc. Të dhënat për raportin midis personelit akademik efektiv (PAE) dhe personelit akademik me kontratë (PAK) janë:				
Kualifikimi i stafit akademik për Programin e Studimit	2022-2023		2021-2022		2020-2021																																																	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																
Prof.Dr.	2	2	1	2	1	3																																																
Prof. Asoc.	0	1	1	1	1	1																																																
Dr./PhD.	3	1	4	1	3	1																																																
MSc.	2	1	1	3	2	4																																																
Totali	7	5	7	7	7	9																																																

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2020-2021, është në raportin 7/9 ose 44% me 56%. 2. Për vitin akademik 2021-2022, është në raportin 7/7 ose 50% me 50%. 3. Për vitin akademik 2022-2023, është në raportin 7/5 ose 58% me 42%. <p>Fakulteti i Ekonomisë si një njësi kryesore ka në përbërjen e tij dhe 1 (një) anëtarë si personel ndihmës akademik, që ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies dhe koordinimin e aspekteve administrative, përfshirë dhe këtë program studimi. Referuar shqyrtimit të CV-ve të stafit akademik, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar, me eksperiencë akademike, profesionistë dhe ekspertë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Gjithashtu një pjesë e tyre janë përfaqësues të organizatave dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit në vendin tonë.</p> <p>Personeli akademik që angazhohet në procesin e mësimdhënies në programin e studimit, Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” me profil: Kontabilitet Auditim, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok. 2, Dosja e Programit të Studimit; 3. Dok. A1.10, Staf i FE; 4. Dok. Tabelat përmbledhëse për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse/bazë për vitet 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023; 5. Dok. CV e stafit akademik_MSh_KF&KA; 6. Dok. A2.22, Syllabuset e lëndëve; 7. Dok. A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 8. Dok. A2.23, Plani mësimor, ngarkesa mësimore sipas lëndëve, 9. Dok. A4.43, Staf akademik i departamentit sipas lëndëve për programin e studimit.
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga takimi i realizuar nga GVJ me P/Dep. dhe stafin akademik u konfirmua se Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit si njësi bazë, ka synuar të realizojë përputhjen e fushave akademike-kërkimore të përgjithshme dhe specifike të personelit akademik me objektivat e programit të studimit. Fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program</p>

	<p>studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të personelit akademik të këtij programi, shumica e stafit akademik efektiv të angazhuar për këtë program studimi, janë të kategorisë Profesor dhe me gradën Doktor. Fushat kryesore kërkimore të personelit akademik janë kontabiliteti, raportimi financiar dhe auditimi, të cilat pasurohen dhe me fushat specifike kërkimore si ofrimi i shërbimeve të sigurisë dhe konsulencës, zbatimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, metodologjia e kërkimit, analiza e pasqyrave financiare, etj. GVJ, gjykon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; 3. A2.18, Rregullore e Dep.F-K; 4. Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 5. Dok. A1.10, Staf i FE; 6. Dok. CV e stafit akademik_MSh_KF&KA; 7. Dok. A2.22, Syllabuset e lëndëve; A2.23, Plani mësimor, ngarkesa mësimore sipas lëndëve; A4.44, Ngarkesa e stafit akademik sipas lëndëve; 8. Dok. Tabelat përmbledhëse për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse/ bazë: 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023.
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, plan buxhetit për vitin 2023, Institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme, të ardhura këto që vijnë kryesisht nga tarifat e studentëve (95-98%), të ardhura nga trajnimet dhe projektet dhe të ardhura të tjera. Nga takimi i realizuar me rektoratin, GVB, P/Dep., dhe stafin akademik u konfirmua se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka një qëndrueshmëri dhe mbështetje të plotë nga ana e institucionit. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok.A4.51, Plan Buxheti për 2023; 2. Dok.24; A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; 3. Dok. 23, Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; 4. Dok. Tabelat përmbledhëse për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse/ bazë: 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023.
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që</p>	<p>GVJ, duke analizuar dokumentat shoqërues të DVV (Statutin e IAL, Rregulloren e Marrëdhënieve të Punës për procedurat e rekrutimit të stafit akademik, dosjet e stafit akademik në zyrën e burimeve njerëzore),</p>

garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

takimin me stafin akademik që janë të angazhuar në programin e aplikuar për akreditim, konstaton se; procedura e rekrutimit të stafit akademik, është në përputhje me objektivat e institucionit dhe programin e studimit aplikuar për akreditim. Në përputhje me nenin 59, të Ligjit 80/2015, të gjithë pedagogët e angazhuar në programin e aplikuar për akreditim, mbajnë gradë minimalisht të ciklit pasardhës në raport me programin ku janë angazhuar në mësimdhënie.

Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, konsultimi me formatin e dosjes së stafit, statutin e institucionit, rregulloren e marrëdhënieve të punës për procedurat e rekrutimit të stafit akademik si edhe duke iu referuar bazës ligjore e nënligjore në fuqi, GVJ arriti në konkluzionin se percaktohen qartë procedurat për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazen ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Referuar nenit 44 të Statutit të IAL, si dhe nenit 7-13 të rregullores për marrëdhëniet e punës, Përgjegjësi i Departamentit të njësisë bazë, bën propozimin rektoratit për nevojat për rekrutimin e Stafit Akademik.

Procedura e zhvillimit të konkursit si dhe kriteret e përzgjedhjes të kandidatëve, bëhen publike nga Zyra e Burimeve Njerëzore në faqen e web-it të institucionit. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision "ad hoc" i ngritur nga rektori, ku pjesë e tij, janë drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i burimeve njerëzore dhe përgjegjësi i departamentit/njësisë bazë.

Përzgjedhja dhe rekrutimi kalon në disa faza, duke i bërë prezent rezultatet e vlerësimit për secilin kandidat. Pas përfundimit të procesit, kandidatët që janë përzgjedhur dhe vlerësuar pozitivisht nga komisioni, njoftohen zyrtarisht për të nënshkruar kontratën e punës. Nga verifikimi në mënyrë rastësore i dy dosjeve të personelit akademik (1 PAE dhe 1 PAK), rezultoi se ato kishin të gjithë dokumentacionin përkatës (Përmbajtja e dosjes, CV, fotokopja e kartës ID, fotokopje e diplomave, listës notave, gradave, titujve të noterizuar, fotokopje të çertifikatave, dëshmisë së gjuhës huaj, fotokopja e librezës sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja nga punëdhënësi për personelin akademik me kontratë, kontrata e punës etj.) GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.


Referenca:

1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 41-53;
2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;
3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, A2.18, Rregullore e Dep.F-K;
4. Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; Dok. A1.10, Staf i FE;
5. Dok.7, Politikat e burimeve njerëzore, politikat e punësimit, përfshirë rekrutimin dhe përzgjedhjen; Rregullore për

	<p><i>Marrëdhëniet e Punës për procedurat e rekrutimit të stafit akademik në KUB, neni 7-19;</i></p> <p>6. <i>Dok.A4.51, Formati i dosjes personale të stafit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ, referuar dokumentacionit përkatës, (<i>Dosjes së Programit të Studimit si dhe të dhënave për personelin akademik dhe ndihmës akademik</i>) konstaton se Fakulteti i Ekonomisë si një njësi kryesore ka në përbërjen e tij dhe 1 (një) anëtarë si personel ndihmës akademik, që ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies dhe koordinimin e aspekteve administrative. Personeli ndihmës akademik, ndihmon në realizimin e praktikave mësimore si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe pajisjeve përkatëse. Nga vizita e realizuar në ambjentet e KUB, rezultoi se në funksion të këtij program studimi është laborator i informatikës me kapacitet me 50 PC, në të cilët janë të instaluar programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha web, Bilanc), dhe programe të tjera për realizimin e praktikave mësimore. GVJ gjykon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 4, Statuti i IAL, neni 52;</i> 2. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 54;</i> 3. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;</i> 4. <i>Dok. A1.10, Stafi i FE;</i> 5. <i>Dok. A4.55, Infrastruktura dhe mjediset e KUB.</i>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga konsultimi me Rregulloren e Institucionit, Rregullores për marrëdhëniet e punës, Formatin e Dosjes personale të Stafit Akademik, si dhe vizitën në Zyrën e Burimeve Njerëzore, administratës dhe arkivit pranë institucionit, GVJ konstaton se, kjo zyrë disponon listën dhe dosjet e stafit akademik dhe personelit administrativ të institucionit, të detajuar sipas njësisë kryesore, njësisë bazë. Nga përzgjedhja rastësore e dosjeve për anëtarët e stafit akademik, të dhënat për dosjet janë të plota dhe të përditësuara me dokumentacionin shoqëruar. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 2. <i>Dok.7, Politikat e burimeve njerëzore, politikat e punësimit, përfshirë rekrutimin dhe përzgjedhjen; Rregullore për Marrëdhëniet e Punës për procedurat e rekrutimit të stafit akademik, neni 61-62;</i> 3. <i>Dok.A4.51, Formati i dosjes personale të stafit;</i> 4. <i>Dok. CV e stafit akademik_MSh_KF&KA;</i> 5. <i>Dok. A4.46, Lista e stafit akademik për njësinë kryesore/bazë.</i>

<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se; institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, KUB mbështetet në një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucionesh publike dhe biznese private, të cilat mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale dhe përgatitjen e mikrotezës për studentët e këtij programi studimi. Një praktikë tjetër e rëndësishme e ndjekur nga institucioni janë edhe leksionet e hapura që zhvillohen nga lektorë vendas, si profesionistë të fushës së kontabilitetit dhe auditimit, të adiministratës publike si dhe përfaqësues të bizneseve në Shqipëri, por edhe lektorë të huaj, të ftuar në kuadër të programeve Erasmus +.</p> <p>Nga takimi i realizuar me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi u konfirmua se; Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit për të siguruar mbarëvajtjen dhe respektimin e detyrimeve të studentit, ngarkon një pedagog përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së praktikës profesionale nga studentët. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, A2.18; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok. A1.14-A1.17, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; 4. Dok. A2.20, dosja e departamentit, udhëzimet për përgatitjen e diplomës dhe praktikës profesionale; A4.47, Personalitete për zhvillimin e leksioneve të hapura, si dhe marrëveshjet për praktikën dhe temën e diplomës; 5. Dok. Raport i përfitueshmërisë së KUB nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët e biznesit; 6. Dok. A3.32; Aspekte të veprimtarisë në kuadër të programeve Erasmus +; 7. Dok. A4.48; Model marrëveshje bashkëpunimi dhe model për vlerësimin e praktikës profesionale.
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqëruar të DVV (lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, dok. për praktikën mësimore etj), GVJ konstatoi se; janë përcaktuar në mënyrë të detajuar organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale për këtë program studimi. Praktika profesionale është pjesë përbërëse e planit mësimor e kategorizuar si lëndë e formimit plotësues me 12 kredite. Praktika profesionale nga studentët kryhet pranë, firmave dhe studiove të kontabilitetit dhe auditimit, bankave dhe shoqërive të sigurimit, subjekteve/bizneseve të ndryshme private, institucioneve publike, etj., me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Për realizimin e praktikës KUB, bashkëpunon me institucione publike qendrore dhe lokale si, dhe një sërë bizneseve private. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, ngarkon një pedagog përgjegjës për mbikëqyrjen e praktikës profesionale nga ana e studentëve. Në përfundim</p>

	<p>të zhvillimit të praktikës profesionale, drejtuesit e institucioneve dhe bizneseve bëjnë vlerësime duke plotësuar formularët përkatës, për ndjekjen dhe kryerjen e praktikës profesionale nga studentët. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 2. <i>Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA, neni 13;</i> 3. <i>Dok. A1.14-A1.17, Lista e marëveshjeve të bashkëpunimit;</i> 4. <i>Dok. A2.20, Dosja e departamentit, udhëzimet për përgatitjen e diplomës dhe praktikës profesionale; A4.48; Model marëveshje bashkëpunimi dhe model për vlerësimin e praktikës profesionale.</i>
<p>Konkluzione</p>	<p>Referuar shqyrtimit të CV-ve të stafit akademik, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” me profil: Kontabilitet Auditim, janë në përputhje me natyrën dhe specifikat e programin të studimit dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>GVJ, duke analizuar dokumentat shoqërues (Statutin e IAL, Rregulloren e Marrëdhënieve të Punës për procedurat e rekrutimit të stafit akademik, dosjet e stafit akademik në zyrën e burimeve njerëzore), takimin me stafin akademik që janë të angazhuar në programin e aplikuar për akreditim, konstaton se; procedura e rekrutimit të stafit akademik, është në përputhje me objektivat e institucionit dhe programin e studimit aplikuar për akreditim. Fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim.</p> <p>GVJ nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se; institucioni ka një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucioneve publike dhe biznese private, që mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale për studentët e këtij programi studimi. Praktika profesionale nga studentët kryhet pranë, firmave dhe studiove të kontabilitetit dhe auditimit, bankave dhe shoqërive të sigurimit, subjekteve/bizneseve të ndryshme private, institucioneve publike, etj., me të cilat institucioni ka marreveshje bashkëpunimi. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, ngarkon një pedagog përgjegjës për mbikqyrjen e praktikës profesionale nga ana e studentëve. Në përfundim të zhvillimit të praktikës profesionale, drejtuesit e institucioneve dhe bizneseve bëjnë vlerësime duke plotësuar formularët përkatës, për ndjekjen dhe kryerjen e praktikës profesionale</p>

	nga studentët. <i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht nga ana e IAL_KUB.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit shoqëruar të DVV (<i>Të dhëna për infrastrukturën dhe mjediset_KUB</i>) si dhe të dhënave të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVBP); GVJ, konstaton se KUB, disponon hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Nga takimi me përfaqësues të institucionit, si dhe të dhënave të RVBP, u konstatua se ky institucion deri në muajin Shkurt 2023, ka pasur në funksion të zhvillimit të procesit mësimor, kërkimor-shkencor dhe administrativ, dy godina (Godina A, dhe B). Nga muaji Mars 2023 e në vazhdim godina A, nuk është më në funksion, pasi është shembur. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, dhe përfaqësuesit e KUB u konfirmua se kjo nuk ka ndikuar në zhvillimin e mësimin, pasi janë marrë masat për akomodimin dhe funksionimin normal të procesit mësimor në godinën B. Mësimi për ciklin bachelor dhe kolegjin profesional 2-vjeçar zhvillohet paradite, ndërsa për ciklin master zhvillohet mbasdite.</p> <p>Nga vizita në institucion (Godina B), GVJ rezulton se ambientet për zhvillimin e procesit mësimor (sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët, etj.), janë të pajisura me teknologjinë e duhur, kompjuter (PC) dhe projektorë për të lehtësuar dhe zhvilluar sa më mirë leksionet, seminarët, praktikat mësimore si dhe aktivitetet e punës në grup të studentëve. Zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë të pajisura me PC, dhe infrastrukturën e nevojshme për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve.</p> <p>Referuar të dhënave për infrastrukturën dhe mjediset e IALP_KUB, sallat e leksioneve, seminareve, laboratorëve, bibliotekës, librarisë, zyrave, etj, për të dy godinat (Godina A, dhe B), GVJ konstaton se, KUB disponon mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. GVJ, gjykon për përmbushjen e këtij kriteri. Nga takimi me përfaqësues të institucionit u konfirmua se për të ofruar, infrastrukturën e nevojshme dhe të mjaftueshme për studentët, stafin akademik dhe administrativ, KUB ka lidhur një kontratë qeraje për një godinë tjetër/mjedise të tjera shtesë (<i>Dok. kontrata e qerasë, datë</i></p>

	<p>13.02.2023), me qëllim garantimin në vijimësi të zhvillimit normal të procesit mësimor (leksioneve, seminareve, praktikave mësimore, etj.). GVJ, gjykon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok. A4.49, Mjediset e klasave dhe laboratorëve; Dok. A4.55, infrastruktura dhe mjediset e KUB; Dok. Tabelat përmbledhëse_KUB. 4. Dok. Kontratë qeraje_Godina e re_KUB.
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe njohurive specifike të GVJ, konstatohet se kërkesat e këtij kriteri plotësohen nga KUB. Infrastruktura sa i përket mjediseve mësimore, godina B (sallave të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve) janë të pajisura me mjete dhe pajisje bashkëkohore për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve dhe është në përputhje me nivelin e njohurive të stafit akademik e ndihmës akademik. Sallat e leksioneve, laboratorëve janë të pajisur me kompjuter (PC) dhe projektorë. Studentëve u mundësohet akses në internet falas dhe Wi-Fi ishte funksional. GVJ konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok. A4.49, Mjediset e klasave dhe laboratorëve; Dok. A4.55, infrastruktura dhe mjediset e KUB; Dok. Tabelat përmbledhëse_KUB.
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të ngarkuar në platformën e ASCAL si dhe nga vizita e realizuar në ambjentet e KUB (Godina B), rezultoi se në funksion të këtij program studimi është laborator i informatikës me kapacitet me 50 vende i pajisur me PC, në të cilët janë të instaluar programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha web, Bilanc), dhe programe të tjera për realizimin e praktikave mësimore të studentëve. Pajisjet kompjuterike ishin të parametrave optimalë për nevojat e punës të stafit akademik dhe zhvillimit të procesit mësimor. Programet kompjuterike në sallat e laboratorëve janë instaluar në përshtatje me programet mësimore sipas fushave dhe programeve që mbulojnë departamentet përkatës. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok. A4.49. Mjediset e klasave dhe laboratorëve; Dok. A4.55. Infrastruktura dhe mjediset e KUB; Dok. Tabelat përmbledhëse_KUB.
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga dokumentacioni i depozituar në DVV, si dhe nga vizita e GVJ në institucion (Godina B), rezulton se KUB ka 4 Laboratorë, (Laboratori i Informatikës, Laboratori i Mekanikës, Laboratori Elektrik dhe Elektronikës). Për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” me profil: Kontabilitet Auditim është në funksion, Laboratori i Informatikës. Ky laborator ka një kapacitet prej 50 vende, i pajisur me PC, projektorë, në të cilat janë të instaluar, programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha web, Bilanc), për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe praktikave mësimore për studentët. GVJ, gjykon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok. A4.49, Mjediset e klasave dhe laboratorëve; Dok. A4.55, infrastruktura dhe mjediset e KUB; Dok. Tabelat përmbledhëse_KUB.
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV në portalin e ASCAL, si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentët, rezulton se institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe organizata publike, sipërmarrje dhe biznese private, për zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e ciklit bachelor dhe master, duke i ofruar dhe mundësinë e punësimit, mbas përfundimit të studimeve. Praktika profesionale nga studentët e këtij programi studimi kryhet pranë, firmave dhe studiove të kontabilitetit dhe auditimit, subjekteve/bizneseve të ndryshme private, administratës publike, etj me të cilat institucioni ka marreveshje bashkëpunimi.</p> <p>Nga bisedat me stafin akademik dhe studentët u konfirmua se një pjesë e stafit akademik të jashtëm i punësuar pranë KUB, u mundësonte studentëve të kryenin praktikën profesionale në zyrat, shoqatat apo sipërmarrje private ku ata ishin të punësuar dhe kishin marrëveshje bashkëpunimi me këtë institucion. Gjithashtu referuar dokumentacionit dhe vizitës në institucion, KUB disponon 3 Laboratorë, (Laboratori i Informatikës, Laboratori i Mekanikës, Laboratori Elektrik dhe Elektronikës), me kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve sipas programeve specifike të studimit. Për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” me profil: Kontabilitet Auditim është në funksion, Laboratori i Informatikës. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok. A1.14-A1.17, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; A4.48; Model marrëveshje bashkëpunimi dhe model për vlerësimin e praktikës profesionale. 						
Konkluzione	<p>Nga analiza e dokumentacionit shoqërues si dhe vizita në institucion; GVJ, konstaton se KUB, disponon mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Ambientet për zhvillimin e procesit mësimor (sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët, etj.), janë të pajisura me kompjuter (PC) dhe projektorë për të lehtësuar dhe zhvilluar sa më mirë leksionet, seminarët, praktikat mësimore si dhe aktivitetet e punës në grup të studentëve. Zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë të pajisura me PC, mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve.</p> <p>Referuar dokumentacionit të ngarkuar në platformën e ASCAL si dhe nga vizita e realizuar në ambjentet e KUB (Godina B), për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Kontabilitet Financë" me profil: Kontabilitet Auditim është në funksion, Laboratori i Informatikës. Ky laborator ka një kapacitet prej 50 vende, i pajisur me PC, projektorë, në të cilat janë të instaluar, programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha web, Bilanc), për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe praktikave mësimore për studentët.</p> <p>IAL-KUB ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe organizata publike, sipërmarrje dhe biznese private, për zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e ciklit bachelor dhe master. Praktika profesionale nga studentët e këtij programi studimi kryhet pranë, firmave dhe studiove të kontabilitetit dhe auditimit, subjekteve/bizneseve të ndryshme private, administratës publike, etj me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjithashtu referuar dokumentacionit dhe vizitës në institucion, KUB disponon 3 Laboratorë, (Laboratori i Informatikës, Laboratori i Mekanikës, Laboratori Elektrik dhe Elektronikës), me kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve sipas programeve specifike të studimit. <i>GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimdhënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, literatura bazë e përdorur në modulet e këtij programi studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore që u ofrohet studentëve, në vartësi të modulit, përfshin: tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, materiale në web, etj. Nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi, rezultojnë se literatura bazë apo ndihmëse, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB, u konstatua se; për realizimin e procesit mësimor, biblioteka e KUB, luan një rol të rëndësishëm duke mbështetur me literaturë shtesë studentët për procesin mësimor dhe kërkimor shkencor. Misioni dhe qëllimi i bibliotekës është që të plotësojë nevojat e studentëve dhe stafit akademik me materiale dhe informacione në funksion të programit mësimor. Literatura bazë ofrohet nga tekstet ose leksione e printuara që gjenden në bibliotekë, fotokopje të leksioneve disponohen nga libraria e institucionit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit listën e inventarit të librave në bibliotekë dhe të dhënave të RVB, rezultojnë se ka mbi 7.000 tituj librash. GVJ gjykon për përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 2. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;</i> 3. <i>Dok.A2.22, Syllabuset e Lëndëve;</i> 4. <i>Dok.A4.50, Lista e inventarit të librave të bibliotekës;</i> 5. <i>https://kub.edu.al/libraria/.</i>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqëruar si dhe gjatë vizitës dhe takimit të GVJ me përfaqësues të IAL-KUB, u konfirmua se në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, institucioni parashikon fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste dhe literaturë shtesë. Drejtuesit e njësisë kryesore dhe stafit akademik, bashkëpunojnë për të shtuar dhe përditësuar fondin e bibliotekës me botime dhe materiale bashkëkohore në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor.</p> <p>Botimet e stafit akademik, konferencave shkencore të KUB, publikimet nga institucione publike brenda vendit dhe jashtë vendit, pasurojnë fondin e bibliotekës të institucionit. Nga institucioni, parashikohet një fond i veçantë në buxhet, për shtimin e fondit të bibliotekës me libra të rinj nga autorë vendas dhe të huaj. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 1, Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 2. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;</i> 3. <i>Dok. A4.50, Lista e inventarit të librave të bibliotekës;</i>

	<p>4. Dok. A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB (Godina B), konstatohet se institucioni disponon dhe vë në dispozicion të studentëve, bibliotekën mësimore brenda mjediseve të saj. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në portalin e ASCAL (<i>Infrastruktura dhe mjediset e KUB</i>), si dhe nga vizita në institucion, rezulton se biblioteka pranë KSLP, ka një kapacitet prej 70 vendesh të disponueshëm me një sipërfaqe 47 m².</p> <p>Nga takimi i GVJ me punonjësën e bibliotekës u konfirmua se biblioteka ka në fondin e saj mbi 7.000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj që përfshin (tekste, scripture, revista, botime të ndryshme, si dhe materiale të tjera etj.). Pasurimi i bibliotekës bëhet çdo vit, bazuar në kërkesat e personelit akademik, njësisive bazë, njësisive kryesore dhe miratimit nga drejtuesit e institucionit. Kjo bibliotekë është në shërbim të studentëve nga e Hëna deri ditën e Premte, ndërsa gjatë sezonit të provimeve qëndron e hapur edhe ditën e Shtunë dhe ditën e Diel. Kancelaria, libraria dhe shërbimet për fotokopje, janë pjesë e mjediseve të KUB. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok.A4.50, Lista e inventarit të librave të bibliotekës; Dok. A4.55, <i>Infrastruktura dhe mjediset e KUB</i>; 4. Dok. A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; 5. https://kub.edu.al/libraria/.
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB, konstatohet se kërkesat e këtij kriteri për tipet e ndryshme të literaturës fizike përmbushen plotësisht. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, literatura bazë e përdorur në modulet e këtij programi studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore që u ofrohet studentëve, në vartësi të modulit, përfshin: tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, materiale në web, etj. Nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi, rezulton se literatura, qoftë bazë apo ndihmëse, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të këtij programi studimi.</p> <p>Referuar informacionit të ofruar nga punonjësja e bibliotekës si dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se biblioteka ka në fondin e saj mbi 7.000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj që përfshin (tekste, scripture, revista, botime të ndryshme, si dhe materiale të tjera etj.), për fakultetin e Ekonomisë, Drejtësisë si dhe Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale. Nga takimi i GVJ me përfaqësues të institucionit, si dhe të dhënave të raportit financiar për vitin 2022, është parashikuar një fond i veçantë në</p>

	<p>buxhet rreth 200-300 mijë lekë, për shtimin e fondit të bibliotekës me libra të rinj nga autorë vendas dhe të huaj. Biblioteka ka një literaturë të pasur dhe të mjaftueshme, e cila u shërben studentëve në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor, si dhe përgatitjen e temave të diplomës. GVJ, gjykon përmbushjen e këtij kriteri plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok.A4.50, Lista e inventarit të librave të bibliotekës;; Dok. A4.55, infrastruktura dhe mjediset e KUB; 4. Dok. A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; 5. https://kub.edu.al/libraria/.
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV dhe vizita në institucion, konstatohet se biblioteka është në funksion të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ në orare shërbimi të përshtatshme. Referuar të dhënave të dokumentacionit (<i>tabelat përmbledhëse</i>) për platformat online, studentëve dhe stafit akademik u ofrohet akses online në bibliotekat virtuale sic janë Questia FE, FD, JSTOR, Academia.edu, elibrary, ebsco, gutenberg, cobis, readprint, etj. Institucioni bën abonimin 1 vjeçar, duke u ofruar akses dhe shërbimin pa pagesë të bibliotekave online për stafin akademik dhe studentët e programit të studimit. Sa më sipër, ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok.A4.50, Lista e inventarit të librave të bibliotekës;; Dok. A4.55, Infrastruktura dhe mjediset e KUB; Dok. Tabelat përmbledhëse_KUB; 4. Dok. A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; 5. https://kub.edu.al/libraria/.
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Referuar dokumentacionit në DVV në sistemin e ASCAL (<i>Infrasktruktura dhe mjediset e KUB</i>), si dhe takimi me punonjësen e bibliotekës, u konfirma se biblioteka pranë KSLP, ka një kapacitet prej 70 vendesh. Ajo është e pajisur me kompjuter dhe internet falas, dhe është në shërbim të studentëve për sigurimin e literaturës në bibliotekat virtuale si dhe për tu përdorur për përgatitjen e detyrave të kursit, temat e diplomës, si dhe nevoja të tjera për studentët.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësive kryesore/bazë; 2. Dok.A4.50, Lista e inventarit të librave të bibliotekës; 3. Dok. A4.55, Infrastruktura dhe mjediset e KUB; Dok. Tabelat përmbledhëse_KUB; 4. https://kub.edu.al/libraria/.
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe administrativ të këtij institucioni, u confirmua se mësimi për programin e studimit MSh_KF&KA zhvillohet pasdite. Biblioteka apo sallat e leksioneve u mundësojnë studentëve studimin në orare të ndryshme. Biblioteka ofron shërbimin nga dita e Hënë deri ditën e Premte nga ora 09.00-15.00 dhe 16.00 - 20.00. Shërbimet në bibliotekë ofrohen nga një punonjës që është caktuar si person përgjegjës. GVJ, konstatoi se biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe numrin e studentëve. Njëkohësisht, për shkak të disponimit të bibliotekës online, oraret e aksesimit të informacionit nga studentët janë fleksibël dhe mundësojnë kapacitetet për përdorimin optimal të mjedisit fizik të bibliotekës. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësive kryesore/bazë; 2. Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit MSh_KF&KA; 3. Dok.A4.50, Lista e inventarit të librave të bibliotekës; 4. Dok. A4.55, Infrastruktura dhe mjediset e KUB; 5. https://kub.edu.al/libraria/.
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitet përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqëruar si dhe gjatë vizitës të GVJ u confirmua se në funksion të mësimdhënies, institucioni parashikon fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste dhe literaturë shtesë. Referuar kërkesës së personit përgjegjës të bibliotekës, personelit akademik dhe drejtuesve të njësive bazë, parashikohen blerjet e teksteve dhe librave të rinj duke pasuruar dhe përditësuar fondin e bibliotekës me botime dhe materiale bashkëkohore.</p> <p>Institucioni parashikon çdo vit një fond të veçantë në buxhet, për shtimin e fondit të bibliotekës me libra të rinj nga autorë vendas dhe të huaj, të cilët shërbejnë si literaturë plotësuese në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor. Nga personi përgjegjës i bibliotekës u confirmua se fondi dhe database i librave dhe materialeve të tjera në bibliotekë është i informatizuar. Nga vizita në mjediset e bibliotekës së KUB, GVJ konstatoi se kërkesat e këtij kriteri, përmbushen plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësive kryesore/bazë;

	<p>2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;</p> <p>3. Dok.A4.50, Lista e inventarit të librave të bibliotekës; Dok.A4.52, Gjendja e sotme e librave në bibliotekë;</p> <p>4. Dok. A4.55, Infrastruktura dhe mjediset e KUB;</p> <p>5. https://kub.edu.al/libraria/.</p>								
Konkluzione	<p>Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB, u konstatua se biblioteka e KUB, luan një rol të rëndësishëm duke mbështetur me literaturë shtesë studentët dhe stafin akademik për procesin mësimor dhe kërkimor shkencor.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues si dhe gjatë vizitës dhe takimit të GVJ me përfaqësues të IAL-KUB, u konfirmua se në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, institucioni parashikon fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste të reja dhe literaturë shtesë. Nga takimi i GVJ me punonjësin e bibliotekës u konfirmua se biblioteka ka në fondin e saj mbi 7.000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj që përfshin (tekste, scripture, revista, botime të ndryshme, si dhe materiale të tjera etj.). Pasurimi i bibliotekës bëhet çdo vit, bazuar në kërkesat e personelit akademik, njësive bazë, njësive kryesore dhe miratimit nga drejtuesit e institucionit.</p> <p>Referuar të dhënave të dokumentacionit (tabelat përmbledhëse) për platformat online, studentëve dhe stafit akademik u ofrohet akses online në bibliotekat virtuale. Institucioni bën abonimin 1 vjeçar, duke u ofruar akses dhe shërbimin pa pagesë të bibliotekave online për stafin akademik dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>GVJ, konstatoi se biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe numrin e studentëve. <i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht nga ana e IAL_KUB.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues si dhe gjatë vizitës në KUB, përkatësisht në zyrat përkatëse dhe sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se, institucioni disponon një sistem përmes të cilit administron dokumentacionin që lidhet për informimin e studentëve, regjistrimet, dhe zhvillimin e procesit mësimor.

	<p>Nga takimi i realizuar me përfaqësues të institucionit, stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se portali i KUB, si një platformë teknologjike ofron një sërë shërbimesh dhe informacionesh të nevojshme për studentët dhe stafin akademik lidhur me zhvillimin e procesit mësimor. Logimi në këtë sistem bëhet përmes adresave personale të email-it, për stafin akademik dhe studentët. Gjithashtu, nga takimi me përfaqësues të zyrave të KUB, u konfirmua se gjithë ky proces bazohet në akte administrative, rregullore dhe udhëzime përkatëse nga ana e institucionit. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; 3. Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; 4. Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 5. Dok.A4.53, Organigrama e KUB.
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (Organigrama e KUB), ky institucion ka në strukturën e vet, Zyrën e Burimeve Njerëzore, që administron dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, u konstatua se kjo zyrë mban një dokumentacion të plotë të stafit akademik dhe jo akademik, sikurse edhe pedagogëve të ftuar për realizimin e programit të studimit. Ky dokumentacion ruhet manualisht dhe elektronikisht, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok. 4, Statuti i IAL; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok.3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok.A4.53, Organigrama e KUB).
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit shoqërues, konsultimi me faqen e web-it si dhe gjatë vizitës në KUB, u konstatua se institucioni ka faqen e tij të web-it (https://kub.edu.al/). Nga takimi i GVJ me studentët dhe personelin akademik, u konfirmua se ata disponojnë adresën e tyre të email-it, të unifikuar nën domain e KUB. Përmes adresës realizohet komunikimi i vazhdueshëm dhe i shpejtë i pedagogut me studentët, me stafin akademik, ndihmës akademik dhe personelin administrativ. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;

	<p>2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit;</p> <p>3. https://kub.edu.al/.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita e GVJ dhe komunikimi me përfaqësuesit e KUB, si dhe verifikimi i dokumentacionit shoqërues, u konfirmua se gjatë periudhës së pandemisë COVID 19, janë përdorur platformat online të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit si Google Classroom, Zoom, Meet. Çdo student dhe pedagog është pajisur me kredencialet e veta për përdorimin e këtyre platformave online. Këto platforma janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë për zhvillimin e mësimit (leksioneve, seminareve dhe provimeve online).</p> <p>Gjithashtu, personeli akademik dhe studentët, kanë adresën e tyre të email-it, nën domain e KUB, përmes të cilës realizohet komunikimi i vazhdueshëm midis stafit akademik dhe studentëve. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok. A3.38, Rregullore e zhvillimit të procesit mësimor online, 3. Dok. Tabelat përmbledhëse_KUB 4. https://kub.edu.al/.
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të ngarkuar në sistemin e ASCAL-it, GVJ konstaton se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si pjesë e strukturës së KUB, ka të përcaktuar në rregulloren e saj, procedurat për të monitoruar në kohë reale dhe periodike, zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor. Strukturat e tjera të KUB, sigurojnë mbarëvajtjen e aktiviteteve administrative duke siguruar një mjedis dhe klimë bashkëpunuese për studentët dhe stafin akademik në drejtim të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Sa i përket aspektit administrativ, institucioni ka instaluar kamera dhe sisteme sigurie për të garantuar dhe raportuar në kohë mbi sigurinë dhe kujdesin e shërbimeve të ofruara. Ky kriter përmbushet nga e IAL_KUB.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, 4. Dok. A6.72, Rregullore e NjSBC; 5. Dok.A4.53, Organigrama e KUB.

<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga konsultimi dhe logimi në faqen zyrtare të këtij institucioni, GVJ konstaton se informacioni ofrohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Në këtë faqe, jepet informacion për IAL-KUB, fakultetet, programet e studimit, kurikulat, stafin akademik, aktivitete dhe njoftime të ndryshme rreth institucionit. Dokumentet kryesore dhe ato më të rëndësishme rreth institucionit, fakulteteve, programeve të studimit, stafit akademik, aktiviteteve dhe njoftimeve të ndryshme rreth institucionit etj., ofrohen dhe në gjuhën angleze. Gjithashtu informacioni për për IAL-KUB, ofrohet përmes guidës studentore si dhe shpërndahet, përmes kanaleve dhe rrjeteve të ndryshme të informimit si web, twitter, linkedin, etj. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, 4. Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023; 5. https://kub.edu.al/; https://en.kub.edu.al/.
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues si dhe gjatë vizitës në KUB, përkatësisht në zyrat përkatëse dhe sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se, institucioni disponon një sistem përmes të cilit administron dokumentacionin që lidhet për informimin e studentëve, regjistrimet, dhe zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Nga takimi i realizuar me përfaqësues të institucionit, stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se portali i KUB, si një platformë teknologjike ofron një sërë shërbimesh dhe informacionesh të nevojshme për studentët dhe stafin akademik lidhur me zhvillimin e procesit mësimor. Nga vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, u konstatua se kjo zyrë mban një dokumentacion të plotë të stafit akademik dhe jo akademik, sikurse edhe pedagogëve të ftuar për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues, faqes së web-it, u konstatua se institucioni ka faqen e tij të web-it (https://kub.edu.al/). Nga takimi i GVJ me studentët dhe personelin akademik, u konfirmua se ata disponojnë adresën e tyre të email-it, të unifikuar nën domain e KUB. Përmes adresës realizohet komunikimi i vazhdueshëm dhe i shpejtë i pedagogut me studentët, me stafin akademik, ndihmës akademik dhe personelin administrativ.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentave shoqëruese të ngarkuar në portalin e ASCAL-it, GVJ konstaton se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si pjesë e strukturës së KUB, ka të përcaktuar në rregulloren e saj, procedurat për të monitoruar në kohë reale dhe periodike, zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor.</p> <p>Nga konsultimi dhe logimi në faqen zyrtare të këtij institucioni, GVJ konstaton se informacioni ofrohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.</p>




	Në këtë faqe, jepet informacion për IAL-KUB, fakultetet, programet e studimit, kurikulat, stafin akademik, aktivitete dhe njoftime të ndryshme rreth institucionit. <i>GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>IAL-KUB, bazuar në Ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, referuar dokumentacionit të depozituar në ASCAL (<i>Statutit të KUB, Neni 39, Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, Rregullores së KUB, si dhe Rregullores së Programit të Studimit MSh_KF_KA</i>), siguron financimin dhe mbështetjen financiare për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor si dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, (<i>Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimi për vitin 2022</i>), konstatohet se janë parashikuar treguesit për të ardhurat, shpenzimet dhe mbështetjen financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Referuar shqyrtimit të raportit vjetor për vitin 2021-2022, analizohen të dhënat për planin buxhetor, strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas viteve (2021-2025) për mbështetjen financiare të programeve të studimit. KUB, bazuar në ligjin 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” përgatit çdo vit pasqyrat financiare. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 35-40; 2. Dok.5, Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, 3. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 4. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit MSh_KF&KA; 5. Dok.A4.51, Plan Buxheti për 2023; 6. Dok.24; A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; 7. Dok. 23, Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; 8. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ, referuar shqyrtimit të dokumentacionit në DVV (<i>Statutit të KUB, Neni 39-40, Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, Rregullores së KUB, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit_MSh_KF_KA</i>), KUB, harton planin buxhetor në nivel institucioni, dhe të ndarë sipas njësive kryesore dhe njësive bazë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, (<i>Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimi për vitin 2022 si dhe raportit vjetor të KUB për vitin 2021-2022</i>), konstatohet se janë parashikuar në mënyrë të detajuar të dhënat për të ardhurat që përfshijnë (të ardhurat nga tarifat e studentëve, projektet dhe trajnimet si dhe të ardhura të tjera) dhe shpenzimet të detajuara (në shpenzime operative, për procesin mësimor, kërkimor-shkencor, për investime, për paga, etj) në funksion të mbështetjes financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Gjithashtu institucioni, parashikon, fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste të reja dhe literaturë shtesë si dhe akses për studentët dhe stafin akademik në bibliotekat online lidhur me procesin mësimor dhe kërkimin-shkencor. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 39-40; 2. Dok.5, Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, 3. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësive kryesore/bazë; 4. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 5. Dok.A4.51, Plan Buxheti për 2023; 6. Dok.24; A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; Dok. 23, 7. Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; 8. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ, referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e ASCAL, konkretisht, strukturës organizative, rezulton se KUB, ka në strukturën e saj Zyren e Programimit dhe Raportimit Financiar që është përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e kërkesave ligjore. Gjithashtu nga takimet e GVJ me strukturat përkatëse, u konfirmua se është ngritur dhe funksionon një Sistem Kontrolli i Brendshëm i cili kryen auditimin e brendshëm të institucionit. Sa i përket sigurimit dhe zbatimit të standardeve për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor, funksionon Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Gjithashtu, KUB, i nënshtrohet kontrollit dhe vlerësimit periodik, institucional dhe të programeve të studimit nga ASCAL dhe pasqyrave financiare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.</p>

	<p>Referuar të dhënave të RVB si dhe dokumentacionit të ngarkuar në faqen e ASCSL-it, nga GVJ konstatohet se; pasqyrat financiare vjetore të KUB, auditohen gjithashtu nga një kompani ndërkombëtare auditimi “Grant Thornton”. Raportet e vlerësimit, dhe auditimit, nga strukturat e KUB, si dhe institucionet e pavaruara jashtë KUB-it, publikohen në faqen zyrtare të KUB. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; 3. Dok.24; A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; 4. Dok. 23, Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; 5. Dok. A4.53, Organigrama e KUB; 6. Dok. A6.84, Raporti Grant Thornton; 7. https://kub.edu.al/aktet-ligjore/; https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar në DVV, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, institucioni për çdo vit akademik, organizon mbledhje të hapur me Senatin Akademik, Bordin e Administrimit mbi rezultatet dhe problematikat, referuar raporteve të vlerësimit dhe auditimit. Në takimin e GVJ me përfaqësues të KUB, u konfirmua se në këto mbledhje marrin pjesë pedagogë, studentë dhe personel administrativ. Në raportet vjetore jepen informacione për burimet financiare për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe atij kërkimor-shkencor. Referuar të dhënave të raporteve vjetore buxhetore, institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare dhe se ka kapacitete të mjaftueshme financiare për mbështetjen në vazhdimësi të programeve të studimit. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; 4. Dok.24; A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; 5. Dok. 23, Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; 6. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për</p>	<p>GVJ referuar shqyrtimit të raporteve vjetore buxhetore, konstaton se KUB, disponon burime financiare të qëndrueshme që sigurohen kryesisht nga tarifat e studentëve (95-98%). Gjithashtu, institucioni siguron të ardhura nga pjesëmarrjet në projekte të ndryshme kombëtare</p>

<p>ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>dhe ndërkombëtare. Një burim tjetër i të ardhurave sigurohen nga trajnimet dhe kualifikimet e profesionistëve kontabël që realizon, Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB), si pjesë e strukturës së KUB.</p> <p>Referuar të dhënave të dokumentacionit të ngarkuar në faqen e ASCAL-it, (<i>Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022</i>), konstatohet se institucioni garanton në vijimësi qëndrueshmëri financiare dhe se ka burime të mjaftueshme për mbështetjen dhe ecurinë normale të programeve të studimit. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; 4. Dok.24; A4.54, Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022; 5. Dok. A4.54/2, Raport për punën shkencore; 6. Dok. Tabelat përmbledhëse.
<p>Konkluzione</p>	<p>IAL-KUB, bazuar në Ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, referuar dokumentacionit përkatës (<i>Statutit të KUB, Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, Rregullores së KUB, si dhe Rregullores së Programit të Studimit MSh K-F KA</i>), siguron financimin dhe mbështetjen financiare për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor si dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, (<i>Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimi për vitin 2022 si dhe raportit vjetor të KUB për vitin 2021-2022</i>), konstatohet se janë parashikuar në mënyrë të detajuar të dhënat për të ardhurat që përfshijnë (të ardhurat nga tarifat e studentëve, projektet dhe trajnimet si dhe të ardhura të tjera) dhe shpenzimet të detajuara (në shpenzime operative, për procesin mësimor, kërkimor-shkencor, për investime, për paga, etj) në funksion të mbështetjes financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Institucioni, parashikon, fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste të reja dhe literaturë shtesë si dhe akses për studentët dhe stafin akademik në bibliotekat online lidhur me procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor.</p> <p>Nga takimet e GVJ me strukturat përkatëse, u konfirmua se është ngritur dhe funksionon një Sistem Kontrolli i Brendshëm i cili kryen auditimin e brendshëm të institucionit. Sa i përket sigurimit dhe zbatimit të standardeve për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor, funksionon Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Gjithashtu, KUB, i nënshtrohet kontrollit dhe vlerësimit periodik, institucional dhe të</p>


	<p>programeve të studimit nga ASCAL dhe pasqyrave financiare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.</p> <p>Referuar të dhënave të RVB si dhe dokumentacionit të ngarkuar në faqen e ASCSL-it, nga GVJ konstatohet se; pasqyrat financiare vjetore të KUB, auditohen gjithashtu nga një kompani ndërkombëtare auditimi "Grant Thornton". Raportet e vlerësimit, dhe auditimit, nga strukturat e KUB, si dhe institucionet e pavaruara jashtë KUB-it, publikohen në faqen zyrtare të KUB.</p> <p>GVJ referuar shqyrtimit të raporteve vjetore buxhetore, konstaton se IAL-KUB, disponon burime financiare të qëndrueshme dhe garanton në vijimësi mbështetjen dhe ecurinë normale të programeve të studimit.</p> <p><i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht nga ana e IAL_KUB.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues në DVV (<i>Statutit, Planit Strategjik i Zhvillimit të Institucionit, Rregullores së KUB, etj.</i>), faqes zyrtare, https://kub.edu.al/, GVJ konstaton se nga institucioni janë hartuar aktet rregullatore, kriteret dhe procedurat, që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, që nga momenti i regjistrimit, zhvillimit të procesit mësimor deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Zbatimi i procedurave dhe mbajtjes së dokumentacionit përkatës që nga momenti i regjistrimit të studenteve, zhvillimit të procesit mësimor, deri në diplomimin e tyre, u konfirmua dhe nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore. KUB, ka përcaktuar qartë, kuotat e propozuara, kriteret e pranimit, dhe gjithë procedurat duke i promovuar dhe bërë publike të faqja e saj zyrtare. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Dok. 4, Statuti i IAL;</i> <i>Dok.5, Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2021-2026;</i>

	<p>3. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i></p> <p>4. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin përkatës, konstatohet se procedurat e aplikimit, pranimit, mësimdhënies dhe diplomimit të studentëve në programin e aplikuar për akreditim, kryhet mbi parimet e barazisë. KUB, bazuar në statutin dhe rregulloret përkatëse të zyrave dhe strukturave të tij, garanton barazinë dhe të drejtat e tyre si studentë. Ky kriter përmbushet nga ana e IAL-KUB.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Dok. 4, Statuti i IAL;</i> <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA.</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ nga konsultimi me faqen zyrtare të KUB, konstaton se publikohen kriteret për pranimin në ciklin e dytë të studimeve përpara fillimit të çdo viti të ri akademik (https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet). Bazuar në Ligjin 80/2015, kriteret e pranimit të studentëve të KUB, i referohen notës mesatare, kuotave të propozuara nga njësitë bazë dhe njësitë kryesore në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM dhe udhëzimet përkatëse të MAS. GVJ, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Dok. 4, Statuti i IAL;</i> <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;</i> <i>Dok. 18, Politikat e pranimit të studentëve;</i> <i>Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023;</i> <i>https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet.</i>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Referuar dokumenteve të sipërcituara, si edhe syllabuseve të lëndëve (mënyra e vlerësimit të dijeve), ecurinë e diplomimeve apo mobilitetet konkludohet se kriteret e pranimit, transferimit të studentëve, janë lehtësisht të kuptueshme dhe aksesueshme nga publiku. Sa i përket transferimeve dhe ekuivalentimit, bëhen në përputhje me kërkesat e rregullores së KUB, rregullores së programit të studimit dhe rregullores për ekuivalentimin e studimeve. Nga kontrolli dhe vizita në faqen zyrtare të KUB, konstatohet se informacioni i ngarkuar është i plotë, i</p>

	<p>përditësuar, lehtësisht i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga publiku. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. 18, Politikat e pranimet të studentëve; 5. A2.21, Rregullore për ekuivalentimin e studimeve; 6. Dok. A5.56, Syllabus, Menyra e vlerësimit të dijeve; 7. Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023; 8. https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet.
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me faqen e KUB, konstatohet se nga institucioni përpara fillimit të çdo viti të ri akademik, publikohen në mënyrë të vazhdueshme informacioni lidhur me kriteret, kuotat, dokumentacionin e nevojshëm për pranimin në programin e studimeve_MSh_KF&KA. (https://kub.edu.al/pranimet/).</p> <p>Informacioni ofrohet, gjithashtu përmes guidës studentore, mediave, reklamave televizive, pjesëmarrjen në panairë dhe evente të ndryshme, ditët e hapura në KUB, takimeve informuese me maturanët, (përmes fletëpalosjeve, broshurave, posterave, etj.) si edhe në rrjetet sociale (Facebook, Twiter, LinkedIn, etj). Në fillim të çdo viti akademik, informacionet dhe materialet publicitare janë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të web-it të KUB. GVJ, gjykon sa më sipër ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. 18, Politikat e pranimet të studentëve; 5. Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/pranimet/.
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit dhe GVB si dhe konsultimi me dokumentacionin për politikat e mbështetjes, përkrahjes, për studentët dhe faqen e KUB, konstatohet se nga institucioni përpara fillimit të çdo viti të ri akademik, publikohen kriteret e veçanta lidhur me kriteret, kuotat, dokumentacionin e nevojshëm për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve me aftësi të veçanta, dhe shtresave të marginalizuara. (https://kub.edu.al/pranimet/).</p>

	<p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. 20, Politikat e mbështetjes, përkrahjes, për studentët; 5. Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/pranimet/.
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me përfaqësues të institucionit si dhe konsultimi me dokumentacionin për politikat e mbështetjes, përkrahjes, për studentët dhe faqen e KUB, konstatohet se nga institucioni përpara fillimit të çdo viti të ri akademik, publikohen kriteret e veçanta lidhur me kriteret, kuotat, dokumentacionin e nevojshëm për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve/studentëve nga shtete të tjera.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. 20, Politikat e mbështetjes, përkrahjes, për studentët; Dok. 5. Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/pranimet/.
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, lidhur me politikat e mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe faqen e KUB, konstatohet se nga institucioni përpara fillimit të çdo viti të ri akademik, përcakton kriteret për dhënie e bursave, për studentët me mesatare me qëllim rritjen e cilësisë pranimeve në programet e studimit. Gjithashtu nga takimi me përfaqësues të rektoratit të KUB, u konfirmua se, institucioni aplikon tarifa të reduktuara për studentët me nevoja social-ekonomike/shtresat në nevojë. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok.20, Politikat e mbështetjes, përkrahjes, për studentët; 5. Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/pranimet/.
<p>Konkluzione</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (Statutit, Planit Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, Rregullores së KUB, etj.), faqes zyrtare, https://kub.edu.al/, GVJ konstaton se nga institucioni janë</p>


	<p>hartuar aktet rregullatore, kriteret dhe procedurat, që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, që nga momenti i regjistrimit, zhvillimit të procesit mësimor deri në diplomimin e tyre.</p> <p>KUB, bazuar në statutin dhe rregulloret përkatëse të zyrave dhe strukturave të tij, garanton barazinë dhe të drejtat e tyre si studentë.</p> <p>GVJ nga konsultimi me faqen zyrtare të KUB, konstaton se publikohen kriteret për pranimin në ciklin e dytë të studimeve përpara fillimit të çdo viti të ri akademik, bazuar në Ligjin 80/2015, si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM dhe udhëzimet përkatëse të MAS. (https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet).</p> <p>Sa i përket transferimeve dhe ekuivalentimit, bëhen në përputhje me kërkesat e rregullores së KUB, rregullores së programit të studimit dhe rregullores për ekuivalentimin e studimeve. Nga kontrolli dhe vizita në faqen zyrtare të KUB, konkludohet se kriteret e pranimit, transferimit të studentëve, janë lehtësisht të kuptueshme dhe aksesueshme nga publiku. Nga konsultimi me faqen e KUB, konstatohet se nga institucioni përpara fillimit të çdo viti të ri akademik, publikon informacionin lidhur me kriteret, kuotat, dokumentacionin e nevojshëm për pranimin në programin e studimeve_MSh_KF&KA. (https://kub.edu.al/pranimet/).</p> <p>Informacioni ofrohet, gjithashtu përmes guidës studentore, mediave, reklamave televizive, pjesëmarrjen në panairë dhe evente të ndryshme, ditët e hapura në KUB, takimeve informuese me maturantët, (përmes fletëpalosjeve, broshurave, posterave, etj.) si edhe në rrjetet sociale (Facebook, Twiter, LinkedIn, etj). GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit dhe GVB si dhe konsultimi me dokumentacionin për politikën e mbështetjes, përkrahjes, për studentët dhe faqen e KUB, konstatohet se nga institucioni përpara fillimit të çdo viti të ri akademik, publikohen kriteret e veçanta lidhur me kriteret, kuotat, dokumentacionin e nevojshëm për pranimin dhe përzjedhjen e studentëve me aftësi të veçanta, shtresave të marginalizuara dhe nga shtete të tjera. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si dhe nga takimi i GVJ me përfaqësues të rektoratit të KUB, u konfirmua se, institucioni aplikon tarifa të reduktuara për studentët me nevoja social-ekonomike/shtresat në nevojë. <i>GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga konsultimi me syllabuset e lëndës, konstatohet se në rubrikën e kontrollit/vlerësimit të dijeve, GVJ konstaton se janë të plota procedurat dhe kriteret për vlerësimin e vazhduar dhe provimin përfundimtar. Gjithashtu nga biseda me studentët rezultoi se informacioni për përparimin akademik është lehtësisht i aksesueshëm përmes accountit që kanë studentët në portalin e KUB si dhe nga zyrat e sekretarisë. GVJ nga vizita në sekretarinë mësimore, konstatoi se kjo zyrë në përputhje me detyrat e përcaktuara në rregulloren e saj, mban të dhëna të plota dhe të vazhdueshme për studentët, lidhur me frekuentimin, vlerësimet, notat, kreditet për kalimin nga një vit akademik në tjetrin. GVJ, sa më sipër konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok.8. Rregullore e Sekretarisë Mësimore_KUB; 4. Dok. A2.22, Syllabuset e lëndëve; A5.56, Syllabus, Menyra e vlerësimit të dijeve; 5. Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023.
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues në DVV, (statutit dhe rregulloreve përkatëse të KUB), konstatohet se institucioni informon studentët lidhur me kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve apo studimeve të mëparshme. Pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës nga studenti, në përputhje me rregulloren e KUB, rregulloren e programit të studimeve dhe atë të ekuivalentimit të studimeve, Komisioni i Ekuivalentimit të Njësisë kryesore/bazë, përcakton njohjen e lëndëve në përputhje me kurikulën dhe planin mësimor të programit përkatës. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A2.21, Rregullore për ekuivalentimin e studimeve; 5. https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet.
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, si edhe takimi i GVJ me studentët dhe stafin akademik, u konfirmua se studentët kanë plotësisht mundësinë të informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve për vlerësimin e vazhduar dhe provimin përfundimtar (pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare, esse/detyra kursi,</p>

	<p>provimi i ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar). Njohja e studentëve me kriteret dhe procedurat për vlerësimin e dijeve bëhet në fillim të çdo viti akademik/semestri sipas lëndëve nga pedagogu përkatës dhe sekretaria mësimore. GVJ, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok. A2.22, Syllabuset e lëndëve; A5.56, Syllabus, Menyra e vlerësimit të dijeve.
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me statutin, rregulloren përkatëse, faqen zyrtare, udhëzimin për përgatitjen e mikrotezës, konstatohet se institucioni informon studentët në lidhje me procedurat dhe kriteret e përgatitjes të temës së diplomës. Gjatë takimeve të GVJ me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se, studenti për të realizuar me sukses temën e diplomës informohet që në fillimin e vitit të dytë kalendarik, përmes njoftimit në ambientet e institucionit, publikimit të udhëzimit online në faqen zyrtare dhe informacionit të ofruar nga sekretaria mësimore. Paketa udhëzuese për përgatitjen e mikrotezës përmban, programin e punës, listën e temave orientuese, kërkesen e studentit për pedagogun udhëheqës, afatet për përgatitjen e temës, si dhe udhëzimin për përgatitjen e mikrotezës.</p> <p>Nga takimi me studentët u konfirmua se përgatitja e mikrotezës bëhet nën drejtimin e një pedagogu udhëheqës duke respektuar kriteret në udhëzimin përkatës për përgatitjen e mikrotezës. Për realizimin e temës së diplomës, studenti punon në mënyrë të pavarur, duke komunikuar me pedagogun udhëheqës. GVJ, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok. A3.41, A5.57, Udhëzim për përgatitjen e mikrotezës.
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe faqes zyrtare të KUB, konstatohet se institucioni në mënyrë sistematike dhe periodike në kuadër të regjistrimeve dhe pranimeve të reja, çdo vit publikon, udhëzues, guida studentore, spote publicitare, fletëpalosje, broshura, nëpërmjet të cilave kandidatët për studentë të ardhshëm njihen dhe informohen me kriteret, procedurat, facilitetet, tarifat dhe dokumentacionin e nevojshëm, për tu regjistruar si studentë pranë IAL-KUB.</p>

	<p>Informacioni ofrohet, gjithashtu përmes mediave, pjesëmarrjes në panairë dhe evente të ndryshme, organizimit të ditëve të hapura, takimeve informuese me maturantët si edhe rrjeteve sociale (Facebook, Twiter, LinkedIn, etj). Në fillim të vitit akademik, informacionet dhe materialet publicitare janë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të web-it. GVJ, sa më sipër gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit MSh_KF&KA; 4. Dok. 18, Politikat e pranimit të studentëve; Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023; 5. https://kub.edu.al/pranimet/.
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga konsultimi me syllabuset e lëndës, GVJ konstaton se janë të plota procedurat dhe kriteret për vlerësimin e vazhduar dhe provimin përfundimtar. Gjithashtu nga biseda me studentët rezultoi se informacioni për përparimin akademik është lehtësisht i aksesueshëm përmes accountit që kanë studentët në portalin e KUB si dhe nga zyrat e sekretarisë. Referuar dokumentacionit shoqërues, konstatohet se institucioni informon studentët lidhur me kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve apo studimeve të mëparshme, në përputhje me rregulloren e KUB, si dhe rregulloren e programit të studimeve dhe atë të ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Nga konsultimi me syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, si edhe takimi i GVJ me studentët dhe stafin akademik, u konfirmua se studentët kanë plotësisht mundësinë të informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve për vlerësimin e vazhduar dhe provimin përfundimtar (pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare, esse/detyra kursi, provimi i ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar). Njohja e studentëve me kriteret dhe procedurat për vlerësimin e dijeve bëhet në fillim të cdo viti akademik/semestri sipas lëndëve nga pedagogu përkatës dhe sekretaria mësimore.</p> <p>Gjatë takimeve të GVJ me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se, studenti për të realizuar me sukses temën e diplomës informohet, përmes njoftimit në ambientet e institucionit, publikimit të udhëzimit online në faqen zyrtare dhe informacionit të ofruar nga sekretaria mësimore. Paketa udhëzuese për përgatitjen e mikrotezës përmban, programin e punës, listën e temave orientuese, kërkesen e studentit për pedagogun udhëheqës, afatet për përgatitjen e temës, si dhe udhëzimin për përgatitjen e mikrotezës.</p>

	<p>Nga takimi me studentët u confirmua se përgatitja e mikrotezës bëhet nën drejtimin e një pedagogu udhëheqës duke respektuar kriteret në udhëzimin përkatës për përgatitjen e mikrotezës.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV dhe logimi në faqen zyrtare të KUB, konstatohet se institucioni në mënyrë sistematike dhe periodike në kuadër të regjistrimeve dhe pranimeve të reja, çdo vit publikon, udhëzues, guida studentore, spote publicitare, fletëpalosje, broshura, nëpërmjet të cilave kandidatët për studentë të ardhshëm njihen dhe informohen me kriteret, procedurat, facilitetet, tarifat dhe dokumentacionin e nevojshëm për tu regjistruar si studentë pranë IAL-KUB. Informacioni ofrohet, gjithashtu përmes mediave, pjesëmarrjes në panairë, organizimit të ditëve të hapura, takimeve informuese me maturanët si edhe rrjeteve sociale, etj. <i>GVJ konfirmon përbushjen plotësisht të këtij standardi.</i></p>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit dhe logimi në faqen zyrtare të institucionit, GVJ konstaton se KUB, publikon në faqen e web-it të gjithë informacionin mbi strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimit etj. Pra studentët kanë mundësinë të informohen hollësisht për detajet e programit të studimit të përzgjedhur, duke vizituar faqen online të KUB. Gjithashtu gjatë procesit të regjistrimeve, studentët informohen në mënyrë të detajuar pranë sekretarisë, lidhur me kriteret e pranimit, kohëzgjatjen e programit të studimit, kurikulën dhe planin mësimor, njohjen e diplomës, mundësitë e punësimit si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm. Kjo gjë u confirmua dhe gjatë takimit me studentët. Gjithashtu studentët informohen dhe nga stafi akademik mbi strukturën, organizimin dhe funksionimin e këtij programi studimi. GVJ, konfirmon se ky kriter përbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;

	<ol style="list-style-type: none"> 4. Dok.A5.59, Elementët e strukturës së programit të studimit; 5. Dok. A5.58, Guida Studentore 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-fe/; 7. https://kub.edu.al/pranimet/.
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues, konsultimi me faqen online të KUB si dhe syllabuset, konstaton se kurrikula dhe plani mësimor i programit të studimit, përmbajnë në detaje informacionin për veprimtaritë akademike, mësimore dhe profesionale të parashikuara. Më konkretisht gjenden informacione mbi modulet që do zhvillohen përgjatë këtij programi studimi, përmbajtjen e tyre, kreditet, semestrat kur do zhvillohen lëndët, kohëzgjatjen e praktikës profesionale si dhe informacioni për përgatitjen e mikrotezës dhe mbrojtjen e diplomës. Në syllabuset e lëndëve, gjenden informacione të detajuara, mbi qëllimet, objektivat, temat që do të zhvillohen në një modul të caktuar, format dhe mënyrat e kontrollit/vlerësimit të dijeve, pasqyra e vlerësimit në pikë/notë, dhe literatura bazë/detyrueshme apo e rekomanduar. GVJ, nga sa u trajtua më sipër, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok.A5.59, Elementët e strukturës së programit të studimit; 5. Dok, A2.22, Syllabuset e lëndëve; 6. Dok. A5.58, Guida Studentore; 7. https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-fe/; 8. https://kub.edu.al/pranimet/.
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentët dhe me përfaqësues të Zyrës së Studentit, dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), konfirmohet se studentëve iu ofrohet informacion i plotë dhe periodik mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të karrierës së tyre profesionale gjatë dhe pas përfundimit të studimeve. Gjithashtu në faqen zyrtare të KUB, publikohen njoftime për kryerjen e praktikave profesionale si dhe mundësitë e punësimit të studentëve për këtë program studimi pranë, firmave, studiove të kontabilitetit dhe auditimit, bankave, subjekteve/bizneseve të ndryshme private, institucioneve publike, etj., me të cilat institucioni ka marreveshje bashkëpunimi. Referuar analizës mbi gjurmimin e studentëve dhe treguesit e punësimit të përgatitur nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës mbi punësimin real të studentëve, rezulton se 91-93% e studentëve të diplomuar në këtë program studimi, janë të punësuar.GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p>


	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok.A5.60, Analiza mbi gjurmimin e studentëve dhe treguesit e punësimit nga ZSKK; 5. https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-fe/; 6. https://kub.edu.al/studentet-2/#qeveria_studentore; https://kub.edu.al/alumni/.
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si dhe nga takimet e GVJ me studentët konfirmohet, vënia në dispozicion e këtij informacioni në përmes zyrave përkatëse (sekretarisë mësimore, ZSKK, etj) si dhe përmes faqes zyrtare të institucionit. Para fillimit të çdo viti akademik, institucioni përmes zyrës së sekretarisë i ofron studentëve informacion të detajuar mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor për çdo program studimi. Gjithashtu në faqen e web-it, studentët mund të gjejnë informacionin e nevojshëm lidhur me orarin e mësimit, sallat e zhvillimit të mësimit, provimeve, laboratorët, bibliotekën, trajnimet, workshope si dhe njoftime për aktivitete të ndryshme në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor, kërkimor dhe shkencor, etj. Nga sa më sipër, ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-fe/; 4. https://kub.edu.al/publikohen-data-e-provimeve-te-sezonit-te-dimrit-ne-kub/.
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga takimi i realizuar nga GVJ me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se informacioni në lidhje me programin e studimit është lehtësisht i disponueshëm dhe i aksesueshëm edhe në distancë përmes faqes online të KUB.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të informacionit mundësohet nga të gjitha strukturat menaxheriale të përfshira (sekretaria mësimore, stafi akademik për mësimdhënien, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, NjSBC) si dhe struktura të tjera mbështetëse të administratës për zhvillimin e procesit mësimor. Ky sistem është lehtësisht i gjurmueshëm dhe i aksesueshëm për studentët. Nga takimi i realizuar me përfaqësues të institucionit, stafin akademik dhe studentët, u konfirmua gjithashtu se portali i KUB, si një platformë teknologjike ofron një sërë shërbimesh dhe informacione të nevojshme për studentët dhe stafin akademik lidhur me zhvillimin e procesit mësimor. Logimi në këtë sistem për stafin</p>

	<p>akademik dhe studentët, bëhet përmes adresave personale të email-it/accountit të tyre. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 2. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;</i> 3. <i>Dok.A4.53, Organigrama e KUB;</i> 4. <i>https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-fe/.</i> 		
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe faqes zyrtare të institucionit, GVJ konstaton se KUB, publikon në faqen e web-it të gjithë informacionin mbi strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimit etj. Gjithashtu gjatë procesit të regjistrimeve, studentët informohen në mënyrë të detajuar pranë sekretarisë, lidhur me kriteret e pranimit, kohëzgjatjen e programit të studimit, kurikulën dhe planin mësimor, njohjen e diplomës, mundësitë e punësimit si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues, konstaton se kurrikula dhe plani mësimor i programit të studimit, përmbajnë në detaje informacionin për veprimtaritë akademike, mësimore, modulet që do zhvillohen përgjatë këtij programi studimi, kreditet, kohëzgjatjen e praktikës profesionale si dhe informacioni për përgatitjen e mikrotezës dhe mbrojtjen e diplomës. Nga takimi i GVJ me studentët dhe me përfaqësues të Zyrës së Studentit, dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), konfirmohet se studentëve iu ofrohet informacion i plotë dhe periodik mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të karrierës së tyre profesionale gjatë dhe pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Para fillimit të çdo viti akademik, institucioni përmes zyrës së sekretarisë i ofron studentëve informacion të detajuar mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor për çdo program studimi. Gjithashtu në faqen e web-it, studentët mund të gjejnë informacionin e nevojshëm lidhur me orarin e mësimit, sallat e zhvillimit të mësimit, provimeve, laboratorët, bibliotekën, trajnimet, workshope si dhe njoftime për aktivitete të ndryshme në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor, kërkimor dhe shkencor, etj. Nga takimi i realizuar nga GVJ me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se informacioni në lidhje me programin e studimit është lehtësisht i disponueshëm dhe i aksesueshëm edhe në distancë përmes faqes online të KUB. <i>GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi nga IAL_KUB.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV të institucionit, GVJ konstaton se, KUB dhe njësitë përgjegjëse mbajnë statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, transferuar, ç’regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e MAS. Nga vizita në sekretarinë mësimore, të dhënat për studentët që ndjekin këtë program studimi, ishin të plota dhe të mbajtura me kujdes, si nga pikëpamja sasiore, ashtu edhe ajo cilësore në regjistrat përkatës në përputhje me udhëzimet përkatëse të MAS. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, GVJ konstatoi se; organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e zyrës së sekretarisë mësimore, përcaktohen në Statutin e KUB (neni 77), Rregulloren e KUB (neni 33), Njësisë Kryesore, (neni 45) si dhe në Rregulloren për funksionimin e sekretarisë mësimore. Nga vizita e GVJ pranë sekretarisë mësimore, rezultojnë se kjo zyrë, mban dhe disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, transferimet, ç’regjistrimet dhe numrin e studentëve të diplomuar, për çdo program dhe cikël studimi. Këto të dhëna statistikore raportohen në mënyrë periodike për çdo vit akademik pranë MAS, në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet përkatëse. GVJ, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok.8. Rregullore e Sekretarisë Mësimore_KUB; 5. Dok. Tabelat përmbledhëse_RVB; 6. Dok.A5.70, Të dhëna statistikore për studentët e diplomuar vitin 2021-2022; Dok.A5.61, Të dhëna statistikore për studentët e regjistruar, aktivë, të ç’regjistruar dhe të diplomuar për vitin 2021-2022.
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore, sikurse referuar të dhënave statistikore rezultojnë se, KUB mban dhe disponon statistika të sakta dhe të plota në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, dhe takimi me përfaqësues të sekretarisë mësimore, u konfirmua se veprimtaria e kësaj zyre (Sekretarisë mësimore) bazohet në Rregulloren e KUB/Njësisë Kryesore, si dhe në rregulloren për funksionimin e sekretarisë mësimore të KUB. Referuar të dhënave nga tabelat përmbledhëse të KUB dhe të dhënave që disponohen në sekretarinë mësimore, numri i studentëve të regjistruar</p>

dhe të diplomuar në programin e studimit, Master i Shkencave në “Kontabilitet Financë” me profil: Kontabilitet Auditim janë:

Viti	MSh_KF: Profili KF		MSh_KF: Profili KA		Totali	
	Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar	Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar	Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar
2022-2023	37	n/a	14	n/a	51	n/a
2021-2022	36	20	15	8	51	28
2020-2021	21	31	9	3	30	34
Totali	94	51	38	11	132	62

Në zbatim të rregullores së institucionit, si dhe rregullores të sekretarisë mësimore të KUB (nenet 14-29), nga kontrolli dhe verifikimi në sekretarinë mësimore të regjistrimit themeltar, regjistrimit të notave, regjistrimit të diplomave, etj., GVJ konstaton se të dhënat për nr e studentëve të regjistruar, transferimet, të ç’regjistruar dhe të diplomuar, mbahen në mënyrë të plotë dhe të saktë, si dhe në përputhje me udhëzimet përkatëse të MAS. GVJ, nga të dhënat e mësipërme, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.

Referenca:

1. Dok. 4, Statuti i IAL;
2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;
3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;
4. Dok.8. Rregullore e Sekretarisë Mësimore_KUB;
5. Dok. Tabelat përmbledhëse_RVB;
6. Dok.A5.61, Të dhëna statistikore për studentët e regjistruar, aktivë, të ç’regjistruar dhe të diplomuar për vitin 2021-2022;
7. Dok.A5.70, Të dhëna statistikore për studentët e diplomuar vitin 2021-2022.

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore, dhe verifikimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se të dhënat e studentëve, mbahen dhe ruhen në mënyrë të sigurtë. Institucioni garanton ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave si në formatin hardcopy pranë sekretarisë mësimore dhe në versionin elektronik. Sa i përket të dhënave në formatin elektronik, sistemi mbikqyret nga specialistët e IT të KUB, duke garantuar ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për studentët. Nga verifikimi me zgjedhje i dosjeve për studentët e regjistruar në këtë program studimi (një dosje), rezultoi se ato përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm (kërkesa/deklarata, foto, fotokopje e ID, diploma dhe lista e notave të shkollës mesme e noterizuar, diploma dhe lista e notave bachelor e


	<p>noterizuar, kontrata) në përputhje në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet përkatëse të MAS. Gjithashtu nga verifikimi me zgjedhje i procesverbaleve të provimit për dy module (2 procesverbale) dhe hedhjes së të dhënave në regjistrin e notave, rezultoi se ato ishin të sakta dhe pa gabime. Të dhënat dhe informacionet pranë kësaj zyre janë lehtësisht të verifikueshme dhe të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar. GVJ, nga të dhënat e mësipërme, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 2. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit MSh_KF&KA;</i> 3. <i>Dok.8. Rregullore e Sekretarisë Mësimore_KUB;</i> 4. <i>Dok. Tabelat përmbledhëse_RVB;</i> 5. <i>Dok.A5.61, Të dhëna stastikore për studentët e regjistruar, aktivë, të ç' regjistruar dhe të diplomuar për vitin 2021-2022;</i> 6. <i>Dok.A5.70, Të dhëna statistikore për studentët e diplomuar vitin 2021-2022.</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, dhe takimi me përfaqësues të institucionit, u konfirmua se sistemi i menaxhimit të informacionit mundësohet nga të gjitha strukturat menaxheriale të përfshira (sekretaria mësimore, sektori i IT, stafi akademik për mësimdhënien, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, NjsBC) si dhe struktura të tjera mbështetëse të administratës për zhvillimin e procesit mësimor. Dokumentacioni ruhet në sistemin kompjuterik të KUB, përmes portalit të tij, ku studentët dhe stafik akademik kanë accountin e tyre për ngarkimin e informacionit (vlerësimin e vazhduar, notave, etj.) lidhur me zhvillimin e procesit mësimor. Nga takimi me përfaqësues të KUB, u konfirmua se sistemi është në mbikqyrje nga specialistët e IT të IAL_KUB, duke garantuar menaxhimin dhe ruajtjen e informacionit dhe të dhënave përkatëse.</p> <p>Gjithashtu nga takimet e GVJ me strukturat përkatëse, u konfirmua se është ngritur dhe funksionon një Sistem Kontrolli i Brendshëm i cili kryen auditimin e brendshëm të institucionit. Sa i përket sigurimit dhe zbatimit të standardeve për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor, funksionon si strukturë, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC). GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 4, Statuti i IAL;</i> 2. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 3. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit;</i> 4. <i>Dok. A4.53, Organigrama e KUB.</i>

<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, (<i>Raportit vjetor të KUB për vitin 2021-2022; tabelat përmbledhëse RVB; dokumentacionit për cilësinë dhe në dalje të studentëve si dhe analizës së të dhënave për treguesit e punësimit nga ZSKK</i>), konstatohet se nga institucioni hartohen raporte analitike dhe periodike për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.</p> <p>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) në përputhje me rregulloren e KUB (neni 81), mban kontakte të vazhdueshme (përmes emailit, tel, rrjeteve sociale) lidhur me gjurmueshmërinë e studentëve të diplomuar mbi punësimin dhe karrierën e tyre profesionale. Referuar anketimeve dhe analizës së realizuar nga kjo zyrë për vitin akademik 2019-2021 dhe vitin 2022, rezulton se 91-93% e studentëve të diplomuar në këtë program studimi, janë të punësuar. GVJ, nga të dhënat e mësipërme, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. 23, Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; 5. Dok. Tabelat përmbledhëse RVB; 6. Dok A5.64; Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; 7. Dok.A5.60, Analiza mbi gjurmimin e studentëve dhe treguesit e punësimit nga ZSKK.
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se, institucioni dhe njësitet përgjegjëse mbajnë statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, transferuar, ç’regjistruar dhe numrin e studentëve të diplomuar në programin e studimit, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e MAS. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, GVJ konstatoi se; organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e zyrës së sekretarisë mësimore, përcaktohen në Statutin e KUB, Rregulloren e KUB/Njësisë Kryesore, si dhe në Rregulloren për funksionimin e sekretarisë mësimore.</p> <p>Nga vizita në sekretarinë mësimore, të dhënat për studentët që ndjekin këtë program studimi, ishin të plota dhe të mbajtura me kujdes në regjistrat përkatës, si nga pikëpamja sasiore, ashtu edhe ajo cilësore në përputhje me udhëzimet përkatëse të MAS. Këto të dhëna statistikore raportohen në mënyrë periodike për çdo vit akademik pranë MAS, në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet përkatëse.</p> <p>Nga vizita në sekretarinë mësimore, kontrolli dhe verifikimi i regjistrit themeltar, regjistrit të diplomimit, etj., konstatohet se të dhënat për nr e studentëve të regjistruar, transferimet, të ç’regjistruar dhe të diplomuar, mbahen në mënyrë të saktë dhe të plotë. Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se të dhënat e studentëve, mbahen dhe ruhen në</p>

	<p>mënyrë të sigurtë. Institucioni garanton ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave si në formatin hardcopy pranë sekretarisë mësimore dhe në versionin elektronik. Nga takimi me përfaqësues të KUB, u konfirma se sistemi është në mbikqyrje nga specialistët e IT të IAL_KUB, duke garantuar menaxhimin dhe ruajtjen e informacionit dhe të dhënave përkatëse për studentët. Të dhënat dhe informacionet pranë kësaj zyre janë lehtësisht të verifikueshme dhe të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar.</p> <p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit nga GVJ, konstatohet se nga institucioni hartohen raporte analitike dhe periodike për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) mban kontakte të vazhdueshme (përmes emailit, tel, rrjeteve sociale) lidhur me gjurmueshmërinë e studentëve të diplomuar mbi punësimin dhe karrierën e tyre profesionale. <i>Në përputhje me kriteret e mësimpërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, institucioni në statutin e tij, përcakton modalitetet e angazhimit të studentëve në zgjedhjet dhe pjesëmarrjen e tyre në strukturat drejtuese të KUB. Në organin më të lartë të KUB, Senat, studentët përfaqësohen me të zgjedhurin e tyre (<i>Dok A5.65, Vendim për emërimin në senat të përfaqësuesve të studentëve</i>). Në nenin 73 të Statutit të KUB (<i>Këshillat e Studentëve</i>), përcaktohen modalitetet, për organizimin dhe zgjedhjen e Këshillave Studentor në nivel njësie kryesore çdo dy vjet. Nga takimet e GVJ me përfaqësues të IAL-KUB dhe studentët u konfirmua se; këshilli studentor organizon takime me drejtuesit e institucionit sa i përket problematikave, propozimeve dhe kërkesave të studentëve. Gjatë vizitës së GVJ në KUB, u konfirmua se Këshilli Studentor/Qeverisja Studentore në bashkëpunim me ZSKK, dhe në përputhje me rregulloren e KUB (neni 81), organizon aktivitete të ndryshme në drejtim të procesit mësimor, si leksione të hapura, trajnime, këshillime, konferencat studentore, si dhe aktivitete sociale, humanitare, sportive, etj., për studentët. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>1. <i>Dok. 4, Statuti i IAL;</i></p>

	<p>2. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i></p> <p>3. <i>Dok A5.65, Vendim për emërimin në senat të përfaqësuesve të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Referuar të dhënave të RVB dhe dokumentacionit shoqërues në DVV, KUB, bazuar në statusin e tij, i kushton vëmendje përfshirjes së studentëve në struktura dhe komisione të ndryshme lidhur me procesin e vendimmarrjes siç janë (Senati Akademik, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Këshilli i Etikës). Gjithashtu në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm periodik kishte në përbërje të tij një student. Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>Sondazhi i NjsBC</i>), si dhe gjatë takimit të GVJ me studentët u konfirmua se ata marrin pjesë në vlerësimin e procesit të mësimdhënies përmes plotësimit të pyetësorëve, gjë që ka sjellë përmirësimin e procesit mësimor dhe rritjen e cilësisë së mesimdhënies dhe performancës së stafit akademik. GVJ, nga të dhënat e mësipërme, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 4, Statuti i IAL;</i> 2. <i>Dok A5.65, Vendim për emërimin në senat të përfaqësuesve të studentëve;</i> 3. <i>Dok. A5.68, Dok. A6. 73, Sondazhi dhe Raporti i NjsBC;</i> 4. <i>Dok. A6.70, Pyetësor Janar 2023;</i> 5. <i>Dok. A5.67, Urdhër i Rektorit për ngritjen e GVB.</i>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga konsultimi me statutin e KUB, neni 73, studentët përmes përfaqësuesve të Këshillit Studentor marrin pjesë në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit, të programeve të studimit. Nga takimi me studentët u konfirmua pjesëmarrja e tyre në mbledhjet dhe takimet me njësinë kryesore duke dhënë mendime dhe sugjerimet e tyre me qëllim përmirësimin e procesit mësimor. Përmes pyetësorëve të përgatitur nga NjsBC në fund të çdo semestri, studentët bëjnë vlerësimet sa i përket zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët marrin pjesë në grupin e procesit të akreditimit të programeve të studimit. Gjatë vizitës së GVJ në KUB, u konfirmua se Këshilli Studentor/Qeverisja Studentore në bashkëpunim me ZSKK, organizon aktivitete të ndryshme në drejtim të mbarëvajtjes së procesit mësimor, si leksionet e hapura, trajnime, këshillime, si dhe konferencat studentore. GVJ, nga të dhënat e mësipërme, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 4, Statuti i IAL;</i> 2. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 3. <i>Dok. A5.68, Dok. A6. 73, Sondazhi dhe Raporti i NjsBC;</i> 4. <i>Dok. A5.67, Urdhër i Rektorit për ngritjen e GVB;</i>

	<p>5. https://kub.edu.al/njsbc/;</p> <p>6. https://kub.edu.al/aktet-ligjore/;</p> <p>7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në zbatim të rregullores së KUB dhe rregulloreve të njësisë bazë dhe programit të studimit si dhe rregullores për procedurat e zhvillimit të provimeve, institucioni garanton të drejtën studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Nga takimi i GVJ me studentët u konfirmua se ata gëzojnë të drejtën e shprehjes së mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të provimit, vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Çdo student ka të drejtën e ankimimit të rezultatit të provimit, rishikimit të tezës dhe reflektimit nga ana e njësisë bazë/kryesore dhe pedagogut përgjegjës.</p> <p>Në përputhje me rregulloret e KUB (rregullorja e njësisë kryesore, rregullorja e Dep. dhe rregullorja e programit të studimit), si dhe gjatë takimit të GVJ me P.Dep., stafin akademik dhe studentët u konfirmua se pas marrjes dijeni për vlerësimin, kanë të drejtën të paraqesin ankesë me shkrim, (brenda 3 ditëve) pranë sekretarisë mësimore lidhur me vlerësimin dhe rezultatet e provimit. Kërkesat/ankesat e depozituara nga studentët nga sekretaria i dërgohen pedagogut përkatës për të bërë rishikimin e vlerësimit/tezës së bashku me studentin. Për ankesat e studentëve që nuk janë dakort me vlerësimin e rishikuar nga pedagogu, i paraqiten drejtuesit të njësisë kryesore i cili ja përcjellë ankesat përgjegjësit të departamentit përkatës. Pas marrjes dijeni për ankesën e studentëve, P/Dep., ngre një komision i cili kryen verifikimin përkatës të ankesës së studentit. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar dhe njofton studentin për vendimin e marrë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës së bashku me procesverbalin e provimit, dokumentohet dhe depozitohet një kopje në sekretarinë mësimore dhe një kopje i dërgohet drejtuesit të njësisë kryesore. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 96-97;</i> 2. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;</i> 3. <i>Dok. 13 dhe Dok. A3.40, Rregullore për procedurat e zhvillimit të provimeve, neni 16.</i>
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, institucioni në statutin e tij, përcakton modalitetet e angazhimit të studentëve në zgjedhjet dhe pjesëmarrjen e tyre në strukturat drejtuese të KUB. Në organin më të lartë të KUB, Senat, studentët përfaqësohen me të zgjedhurin e tyre. Nga</p>

takimet e GVJ me përfaqësues të IAL-KUB dhe studentët u konfirmua se; këshilli studentor organizon takime me drejtuesit e institucionit sa i përket problematikave, propozimeve dhe kërkesave të studentëve. Referuar të dhënave të RVB dhe dokumentacionit shoqëruar, KUB, bazuar në statusin e tij, i kushton vëmendje përfshirjes së studentëve në struktura dhe komisione të ndryshme lidhur me procesin e vendimmarrjes siç janë (Senati Akademik, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Këshilli i Etikës). Gjithashtu në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm periodik kishte në përbërje të tij një student.. Studentët përmes përfaqësuesve të Këshillit Studentor marrin pjesë në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit, të programeve të studimit. Nga takimi me studentët u konfirmua pjesëmarrja e tyre në mbledhjet dhe takimet me njësinë kryesore duke dhënë mendime dhe sugjerimet e tyre me qëllim përmirësimin e procesit mësimor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Sondazhi i NjsBC), si dhe gjatë takimit të GVJ me studentët u konfirmua se ata marrin pjesë në vlerësimin e procesit të mësimdhënies përmes plotësimit të pyetësorëve të përgatitur nga NjsBC në çdo fund semestri, gjë që ka sjellë përmirësimin e procesit mësimor dhe rritjen e cilësisë së mesimdhënies dhe performancës së stafit akademik. Gjatë vizitës së GVJ në KUB, u konfirmua se Këshilli Studentor/Qeverisja Studentore në bashkëpunim me ZSKK, organizon aktivitete të ndryshme në drejtim të mbarëvajtjes së procesit mësimor, si leksionet e hapura, trajnime, këshillime, si dhe konferencat studentore. Në zbatim të rregullores së KUB, rregulloreve të njësisë bazë dhe programit të studimit si dhe rregullores për procedurat e zhvillimit të provimeve, institucioni garanton të drejtën studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve.

Nga takimi i GVJ me studentët u konfirmua se ata gëzojnë të drejtën e shprehjes së mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të provimit, vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.

Çdo student ka të drejtën e ankimit të rezultatit të provimit, rishikimit të tezës dhe reflektimit nga ana e njësisë bazë/kryesore dhe pedagogut përgjegjës. *GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi nga IAL_KUB.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore, takimi me përfaqësues të Zyrës së Studentit, dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), si dhe nga biseda me studentët rezultoi se, këta të fundit kanë një sërë alternativa/mënyra për marrjen e informacionit dhe shërbimeve përmes sekretarisë mësimore, si dhe duke vizituar faqen online të KUB.</p> <p>Përmes sekretarisë mësimore studentëve i ofrohet informacioni lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, (orarin e mësimit, zhvillimin dhe frekuentimin e leksioneve dhe seminareve, grafikun e provimeve, procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, kriteret dhe procedurat e kalimit nga një vit akademik në tjetrin, kryerjen e praktikës profesionale, mbrojtjen e diplomës, etj.) si dhe shërbimet përkatëse që ofrohen nga kjo zyrë. Në zbatim të rregullores së KUB (neni 81), nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), studentëve u ofrohet shërbime si këshillime, trajnime, informacione, njoftime për aktivitete dhe evente të ndryshme, oferta pune, etj. Në zbatim të rregullores së KUB (neni 35), nga Zyra e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (ZKShP), studentëve i ofrohet informacion lidhur me programet erasmus +, pjesëmarrjen në projekte kërkimore dhe shkencore si dhe organizimin dhe pjesëmarrjen në konferencat shkencore studentore. GVJ, nga të dhënat e mësipërme, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësive kryesore/bazë; 3. Dok.A4.53, Organigrama e KUB; 4. Dok. A2.26/2; Dok. A2.31. Rregullore e Zyrës së kërkimit shkencor dhe projekteve; 5. Dok A1.17. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe Erasmus+; 6. https://kub.edu.al/publikohen-data-e-provimeve-te-sezonit-te-dimrit-ne-kub/. 7. https://kub.edu.al/project_categories/erasmus/
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Referuar bisedave me studentët, përmes sekretarisë mësimore studentëve u ofrohet informacion në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor si dhe shërbime të ndryshme.</p> <p>Referuar dokumentacionit shoqëruar të DVV, (statutit, neni 74, rregullores së KUB, neni 81), si dhe gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Studentit, dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), GVJ konstatoi se studentëve nga kjo zyrë, u ofrohet informacion lidhur me trajnimet,</p>

	<p>këshillimet, njoftime për aktivitete dhe evente të ndryshme, leksione të hapura, panairt e punës, praktikat profesionale, konferencat shkencore, mundësitë e punësimit, sondazhet lidhur me gjurmimin dhe punësimin e studentëve, takimet Alumni me studentët e diplomuar, si dhe organizimit të aktiviteteve të ndryshme sociale, humanitare, sportive etj. Faqja e web-it të KUB, mundëson ofrimin dhe shpërndarjen online të informacionit lidhur me fakultetet, programet e studimit, kriteret e pranimit, strukturën organizative, stafin akademik, si dhe njoftime të ndryshme në lidhje me procesin mësimor. Gjithashtu informacioni për KUB, shpërndahet dhe përmes rrjeteve sociale, (facebook, twitter, linkedin, etj). Këto platforma dhe rrjete sociale, menaxhohen nga Zyra e Marëdhënieve me Publikun dhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. GVJ, gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok A1.17. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe Erasmus+; 4. Dok. A3.32. Aspekte të veprimtarisë në kuadër të programeve Erasmus +; 5. Dok.A4.53. Organigrama e KUB; 6. https://kub.edu.al/; 7. https://kub.edu.al/project_categories/erasmus/
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Referuar bisedave të GVJ me studentët, si nga vizita në institucion me përfaqësues të Zyrës së Studentit, dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), rezultoi se ky kriter plotësohet. Kjo zyrë në bashkëpunim me Këshillin Studentor u ofron studentëve informacion lidhur me procesin mësimor, trajnimet, këshillime, njoftime për aktivitete dhe evente të ndryshme, organizimin e leksioneve të hapura, orientimin për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe mundësitë për punësimin e tyre, etj.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe ZSKK, disponojnë një database të dhënash për studentët si nr. tel, adresa e emailit, etj.</p> <p>ZSKK, mban kontakte të vazhdueshme lidhur me gjurmimin e studentëve të diplomuar mbi punësimin dhe karrierën e tyre profesionale si dhe organizimin e takimeve Alumni me studentët e diplomuar, etj. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.A4.53, Organigrama e KUB;




	<p>4. Dok.A5.60, Analiza mbi gjurmimin e studentëve dhe treguesit e punësimit nga ZSKK.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjatë takimeve të realizuara nga GVJ me GVB, P/Dep., dhe përfaqësues të Zyrës Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), u konfirmua se KUB dhe njësia bazë mban kontakte dhe shkëmben mendime në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar.</p> <p>Referuar analizës së kryer nga ZSKK për gjurmimin dhe punësimin e studentëve, për këtë program studimi për vitin akademik 2019-2021, janë anketuar 88% e studentëve të diplomuar dhe rezulton se 91% e tyre janë të punësuar nga të cilët 65% në profesion dhe 10% janë të vetëpunësuar. Ndërsa për vitin akademik 2022, janë anketuar 88% e studentëve të diplomuar dhe rezulton se 93% e tyre janë të punësuar nga të cilët 85% në profesion. Një tjetër mundësi komunikimi dhe kontakti janë dhe takimet Alumni të realizuara nga kjo zyrë, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis studentëve aktual dhe atyre të diplomuar. Nga të dhënat e mësipërme, ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.A4.53, Organigrama e KUB; 4. Dok.A5.60, Analiza mbi gjurmimin e studentëve dhe treguesit e punësimit nga ZSKK; 5. https://kub.edu.al/alumni/.
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore, takimi me përfaqësues të Zyrës së Studentit, dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), si dhe nga biseda me studentët rezulton se, këta të fundit kanë një sërë alternativa/mënyra për marrjen e informacionit dhe shërbimeve përmes sekretarisë mësimore, si dhe duke vizituar faqen online të KUB. Përmes sekretarisë mësimore studentëve i ofrohet informacioni lidhur me zhvillimin e procesin mësimor si dhe shërbimet përkatëse që ofrohen nga kjo zyrë. Nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), studentëve u ofrohen shërbime si këshillime, trajnime, informacione, njoftime për aktivitete dhe evente të ndryshme, oferta pune, etj. Gjithashtu nga Zyra e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (ZKShP), studentëve i ofrohet informacion lidhur me programet erasmus +, pjesëmarrjen në projekte kërkimore dhe shkencore si dhe organizimin dhe pjesëmarrjen në konferencat shkencore studentore.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës dhe Zyrës Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, GVJ konstatoi se, studentëve u ofrohet informacion lidhur me trajnimet, këshillimet, programet Erasmus, njoftime për aktivitete dhe evente të ndryshme, leksione të hapura, pjesëmarrjen në projekte kërkimore dhe shkencore, organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore, panaiet e punës,</p>


	praktikat profesionale, mundësitë e punësimit, sondazhet lidhur me gjurmimin dhe punësimin e studentëve, si dhe organizimit të aktiviteteve të ndryshme sociale, humanitare, sportive etj. Gjithashtu, ZSKK, mban kontakte të vazhdueshme, kryen sondazhe dhe përgatit raporte periodike për gjurmimin dhe punësimin e studentëve të diplomuar si dhe organizon takimet Alumni me studentët e diplomuar, etj. <i>Në përputhje me kriteret e mësimperme, GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit në DVV nga GVJ, u konstatua se KUB ka hartuar një udhëzues të veçantë për zhvillimin e procesit mësimor online gjatë periudhës së pandemisë. KUB duke marrë shkas nga situata e pandemisë COVID 19, ka implementuar metoda të ndryshme të mësimdhënies si mësimi në auditor, mësimi online dhe mësimi i kombinuar (<i>Rregullore e zhvillimit të procesit mësimor online</i>). Zhvillimi i procesit mësimor bazohet në këto komponentë: (leksione në auditor, seminare, ushtrime, esse/detyra kursi, praktika mësimore përmes programeve kompjuterike, puna në grup, praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës).</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, si dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës u konstatua se gjatë periudhës së pandemisë COVID 19, KUB ka zhvilluar mësimin online përmes platformave mësimore Google Classroom Zoom, Google Meet. Çdo student dhe pedagog është pajisur me kredencialet e veta për përdorimin e këtyre platformave online. Këto platforma janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë për zhvillimin e mësimin (leksioneve, seminareve dhe provimeve online). Nga vizita e realizuar në ambjentet e KUB, rezultoi se në funksion të këtij program studimi është laborator i informatikës, në të cilët janë të instaluar programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha web, Bilanc), të cilat mundësojnë realizimin e praktikave mësimore të studentëve.</p>


	<p>Gjithashtu, personeli akademik dhe studentët, kanë adresën e tyre të email-it, nën domain/portalin e KUB, përmes të cilës realizohet komunikimi i vazhdueshëm dhe efikas i informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ, konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 2. Dok. A3.38, Rregullore e zhvillimit të procesit mësimor online, 3. https://kub.edu.al/.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ, duke analizuar dokumentacionin shoqërues në DVV, konstaton se strukturat përgjegjëse të KUB-së bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 80/2015, “Mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e KUB; Rregulloren e KUB; si dhe Rregulloren për Funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; në mënyrë periodike, vlerësojnë performancën dhe aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike nga departamentet përkatëse dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC).</p> <p>Në KUB, ushtron veprimtarinë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si një strukturë përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, vlerësimin e efikasitetit dhe cilësisë së punës mësimore, kërkimore dhe shkencore.</p> <p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua se qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së saj është vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit, vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i performancës dhe rezultateve të punës kërkimore dhe shkencore si dhe veprimtarive të tjera administrative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në fund të çdo semestri të vitit akademik, organizon plotësimin e pyetësorit me studentët, duke i përfshirë ata në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, cilësinë e programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik. Pasi përpunohen të dhënat nga plotësimi i pyetësorëve, NjSBC, përgatit një raport të cilin ia përcjell njësisë kryesore dhe njësive bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, Instituti për Cilësi në Arsim (IQE), ka organizuar, plotësimin e një pyetësori me studentët dhe personelin akademik të KUB, në muajin Maj 2021, si dhe ka përgatitur një raport, i cili ka ndihmuar në përmirësimin e performancës të stafit akademik dhe cilësisë së mësimdhënies në këtë institucion. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 81-82;

	<ol style="list-style-type: none"> 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 112-113; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 6. Dok. A5.68, Sondazhi i NjSBC; Dok. A6.70, Pyetësor Janar 2023; 7. Dok. A6.69, Raport i Institutit për Cilësi në Arsim, Maj 2021; 8. https://kub.edu.al/njsbc/; 9. https://kub.edu.al/aktet-ligjore/; 10. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua përfshirja e studentëve për vlerësimin e zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Kjo zyrë në veprimtarinë e saj ka si qëllim, vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, cilësisë së mësimdhënies, rezultateve të punës kërkimore dhe shkencore si dhe performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Në përfundim të çdo semestri, NjSBC, organizon plotësimin e pyetësorit me studentët, duke i përfshirë ata në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, cilësinë e programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik.</p> <p>Gjithashtu kjo zyrë plotëson pyetësor dhe me stafin akademik, lidhur me kushtet e punës si dhe performancën e studentëve. Pyetësorët plotësohen fizikisht në hardcopy si dhe në formë elektronike përmes adresës së emailit. Pasi përpunohen të dhënat nga plotësimi i pyetësorëve, NjSBC, përgatit një raport të cilin ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 81-82; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 112-113; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 5. Dok. A5.68, Sondazhi i NjSBC; Dok. Dok. A6.70, Pyetësor Janar 2023; 6. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 7. https://kub.edu.al/njsbc/; 8. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.


<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit GVJ, konstatoi se; Organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC), përcaktohen në Statutin e KUB (neni, 81&82), në Rregulloren e KUB (neni (112&113) si dhe në Rregulloren për funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NjsBC, përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga senati akademik. Kjo njësi, në fund të çdo semestri organizon plotësimin e pyetësorit me studentët, duke i përfshirë ata në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, cilësinë e programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik. NjsBC, bazuar në rezultatet e plotësimit të pyetësorëve, përgatit raportin përkatës, që ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu një kopje të raportit nga kjo njësi, i paraqitet Rektorit të institucionit.</p> <p>Nga konsultimi me faqen e KUB, konstatohet se NjsBC ka rubrikën e saj në faqen zyrtare të institucionit, ku pasqyrohet veprimtaria e saj, dhe bëhen publike, raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 81-82; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 112-113; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjsBC; 5. Dok. A5.68, Sondazhi i NjsBC; Dok. Dok. A6.70, Pyetësor Janar 2023; 6. Dok. A6.73, Raport i NjsBC për vitin akademik 2022-2023; https://kub.edu.al/njsbc/; 7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua se rezultatet e anketave/pyetësorëve duke përfshirë edhe komentet përkatëse të bëra nga studentët, u përcillen departamenteve përkatëse dhe drejtuesve të njësisë kryesore të cilat më pas diskutohen në mbledhjet e organizuara me stafin akademik.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, referuar qëllimit të veprimtarisë të saj, evidenton dhe promovon praktikat më të mira në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në nivel departamenti dhe fakulteti. GVJ konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 81-82; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 112-113;

	<ol style="list-style-type: none"> 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit, Dok.A2.18, Rregullore e Dep.F-K; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 5. Dok. A5.68, Sondazhi i NjSBC; Dok. Dok. A6.70, Pyetësor Janar 2023; 6. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 7. https://kub.edu.al/njsbc/; 8. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit nga GVJ, u konstatua se KUB ka hartuar një udhëzues të veçantë për zhvillimin e procesit mësimor online gjatë periudhës së pandemisë, si dhe ka implementuar metoda të ndryshme të mësimdhënies si mësimi në auditor, mësimi online dhe mësimi i kombinuar. Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, si dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës u konstatua se gjatë periudhës së pandemisë COVID 19, KUB ka zhvilluar mësimin online përmes platformave mësimore Google Classroom Zoom, Google Meet. Në funksion të këtij program studimi, institucioni disponon laboratorin e informatikës, në të cilët janë të instaluar programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha web, Bilanc), të cilat mundësojnë realizimin e praktikave mësimore të studentëve.</p> <p>GVJ, duke analizuar dokumentacionin shoqërues, konstaton se strukturat përgjegjëse të KUB-së; në mënyrë periodike, vlerësojnë performancën dhe aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike nga departamentet përkatëse dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC).</p> <p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua se qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së saj është vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit, vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i performancës dhe rezultateve të punës kërkimore dhe shkencore si dhe veprimtarive të tjera administrative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. NjSBC, në fund të çdo semestri të vitit akademik, organizon plotësimin e pyetësorit me studentët, duke përfshirë ata në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe mësimdhënies, cilësinë e programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik. NjSBC, bazuar në rezultatet e plotësimit të pyetësorëve, përgatit raportin përkatës, që ia përcjell njësive kryesore dhe njësive bazë, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Nga konsultimi me faqen e KUB, konstatohet se NjSBC ka rubrikën e saj në faqen zyrtare të institucionit, ku pasqyrohet veprimtaria e saj, dhe bëhen publike, raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi nga IAL KUB.</i></p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X


Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 824, datë 24.12.2021, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Statutin e KUB, në këtë institucion është ngritur dhe funksionon, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit GVJ, konstatoi se; organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e NjsBC, përcaktohen në statutin e KUB (neni 81&82), Rregulloren e KUB, (neni 112&113) si dhe në Rregulloren për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NjsBC, përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga senati akademik. Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua se kjo zyrë në veprimtarinë e saj ka si qëllim, vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, cilësisë së mësimdhënies, rezultateve të punës kërkimore dhe shkencore si dhe performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik. NjsBC, çdo vit për veprimtarinë e saj përgatit raportin vjetor, që ia përcjell njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe rektorit të institucionit. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 81-82; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësive kryesore/bazë, neni 112-113; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjsBC; 4. A6.73, Raport i NjsBC për vitin akademik 2022-2023; 5. https://kub.edu.al/njsbc/ 6. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit në DVV të ngarkuar në sistemin e ASCAL, konfirmohet se pranë IAL-KUB është ngritur dhe funksionon, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC), në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 824, datë 24.12.2021, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”. NjsBC si strukturë e KUB, është krijuar në vitin 2014 me vendimi të senatit akademik dhe funksionon si njësi e përhershme. Ajo, përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga senati akademik, ku përfshihet edhe një student. Rregullat</p>

	<p>për përfshirjen e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm, parashikohen në statutin e IAL_KUB dhe rregulloren e NjSBC-së. GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 81-82; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 112-113; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 4. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; https://kub.edu.al/njsbc/; 5. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentet e ngarkuara në portalin e ASCAL, GVJ konstaton se procedurat e aplikuara për licensim dhe akreditim janë në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, si edhe instrumentet e nevojshme për garantimin dhe sigurimin e cilësisë. Në rregulloren për funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përcaktohen detyrat për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, cilësisë së mësimdhënies, rezultateve të punës kërkimore dhe shkencore si dhe performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik, përmes organizimit dhe plotësimin të pyetsorëve si dhe instrumentave të tjerë të vlerësimit me studentë dhe stafin akademik. Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të NjSBC, u konfirmua se kjo njësi përfshihet dhe në përgatitjen e dokumentacionit përkatës për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, lidhur me sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor.</p> <p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit të KUB, dhe analizës së RVB në drejtim të vlerësimit të jashtëm, dy institucione; Qendra Kërkimore “Tirana Business Research Center” dhe Instituti për Cilësi në Arsim (IQE), kanë organizuar, plotësimin e një pyetësori me studentë dhe personelin akademik të KUB, lidhur me vlerësimin e cilësisë së shërbimeve nga studentët dhe vlerësimin e performancës të stafit akademik. Rezultatet e këtyre anketimeve dhe pyetsorëve janë bërë publike ne faqen e KUB. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 81-82; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 112-113; 3. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 4. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 5. Dok. A6.69, Raport i Institutit për Cilësi në Arsim, Maj 2021; 6. https://kub.edu.al/aktet-ligjore/; 7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.

<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, GVJ konstaton se, procedurat e ndjekjes dhe monitorimit periodik të cilësisë parashikohen në rregulloren përkatëse të NjSBC dhe dokumentacionin e hartuar për këtë qëllim. Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të NjSBC, u konfirmua se në fund të çdo semestri kjo njësi, organizon plotësimin e pyetësorit me studentët e çdo kursi, cikli dhe program studimi, lidhur me vlerësimin e procesit të mësimdhënies, cilësinë e programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik. Bazuar në rezultatet e plotësimin të pyetësorëve dhe instrumentëve të tjerë të vlerësimin, NjSBC përgatit raportin vjetor, lidhur me vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe një kopje të raportit i përcillet rektoratit të IAL_KUB.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, referuar qëllimit të veprimtarisë të saj, evidenton dhe promovon praktikën më të mira në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për çdo programi studimi, në nivel departamenti dhe fakulteti. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ konfirmon se ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/njsbc/; 7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit GVJ, konstatoi se; organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e NjSBC, përcaktohen në statutin e KUB, Rregulloren e KUB, si dhe në Rregulloren për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>NjSBC, përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga senati akademik ku përfshihet edhe një student. Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua se kjo zyrë në veprimtarinë e saj ka si qëllim, vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, cilësisë së mësimdhënies, rezultateve të punës kërkimore dhe shkencore si dhe performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të NjSBC, u konfirmua se në fund të çdo semestri kjo njësi, organizon plotësimin e pyetësorit me studentët e çdo kursi, cikli dhe program studimi, lidhur me vlerësimin e procesit të mësimdhënies, cilësinë e programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik. Bazuar në rezultatet e plotësimin të pyetësorëve dhe instrumentëve të tjerë të vlerësimin, NjSBC përgatit raportin vjetor, lidhur me vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe një kopje të raportit i përcillet rektoratit të IAL_KUB. Gjithashtu kjo njësi përfshihet dhe në</p>

	<p>përgatitjen e dokumentacionit përkatës për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, lidhur me sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor.</p> <p><i>Në përputhje me kriteret e mësimpërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacioni përkatës, specifikisht rregullores së NjsBC (neni 4), GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri, është NjsBC. Kjo strukturë është ngritur me qëllim vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit në mënyrë periodike në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. NjsBC ka si detyrë, në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, organizimin dhe plotësimin e pyetësorëve në fund të çdo semestri, ku studentët kanë mundësinë të vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies, dhe performancën e stafit akademik. Gjatë vizitës së GVJ në institucion, u konfirmua se kjo njësi (NjsBC) në bashkëpunim dhe me ZSKK përdor dhe instrumente të tjera vlerësimi përmes sondazheve, intervistave me studentët e diplomuar, personelin akademik, ndihmës akademik, dhe administrativ për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>NjsBC bazuar në të dhënat e mledhura përmes plotësimit të pyetësorëve dhe instrumentëve të tjerë të vlerësimit, përgatit raportin vjetor, lidhur me vlerësimin e brendshëm të cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, programeve të studimit, dhe performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik. Një kopje të këtij raporti, me rekomandimet përkatëse ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe strukturave drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit. Nga të dhënat e mësimpërme, GVJ konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Rregullore e Programit të Studimit MSh_KF&KA; 3. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjsBC; 4. Dok. A5.68, Sondazhi i NjsBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjsBC për vitin akademik 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/njsbc/;

<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.</p> <p>Në përputhje me rregulloren e funksionimit, NjSBC organizon 2 herë në vit në fund të çdo semestri procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit, cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Në takimin e realizuar nga GVJ me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua se kjo zyrë, bazuar në rezultatet e pyetsorëve, intervistave dhe instrumentave të tjerë të vlerësimit, evidenton dhe promovon praktikën më të mira në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në takimet/mbledhjet e realizuara me drejtuesit e departamenteve, fakulteteve dhe rektoratit. GVJ gjykon se ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Rregullore e Programit të Studimit MSh_KF&KA; 3. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 4. Dok. A5.68, Sondazhi i NjSBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023.
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në portalin e ASCAL si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se, për realizimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit; NjSBC organizon plotësimin e pyetsorëve me studentët në fund të çdo semestri (<i>Pyetsori, Janar 2023</i>), ku ata kanë mundësinë të shprehin mendimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies, për mënyrën e prezantimit (leksioneve dhe seminareve), format dhe mjetet didaktike që përdoren, literaturën, metodologjinë e mësimdhënies, aspektin profesional dhe akademik, etikën e komunikimit, etj.</p> <p>Pyetsorët plotësohen me studentët e çdo kursi, cikli dhe program studimi, lidhur me vlerësimin e procesit të mësimdhënies, cilësinë e programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik. Ky pyetësor, plotësohet në mënyrë periodike dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri. Nga të dhënat e mëripërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Rregullore e Programit të Studimit MSh_KF&KA; 3. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 4. Dok. A5.68; A6.70, Pyetësori dhe Sondazhi i NjSBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; https://kub.edu.al/njsbc/; 6. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.


<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si dhe gjatë takimeve të realizuara nga GVJ me përfaqësues të Zyrës Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), u konfirmua se KUB dhe njësia bazë mban kontakte dhe shkëmben mendime në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Një tjetër mundësi komunikimi janë dhe takimet Alumni të realizuara nga kjo zyrë në bashkëpunim me Këshillin Studentor, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis studentëve aktual dhe atyre të diplomuar dhe përmes njoftimeve në faqen e KUB. (https://kub.edu.al/alumni/).</p> <p>Kjo zyrë i realizon kontaktet me studentët e diplomuar përmes emailit, tel, rrjeteve sociale lidhur me gjurmueshmërinë e studentëve të diplomuar mbi punësimin dhe karrierën e tyre profesionale.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin e ngarkuar në ASCAL, sikurse edhe nga takimet e GVJ me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se NjSBC në bashkëpunim me ZSKK, realizon vlerësimin e vazhdueshëm dhe periodik, përmes plotësimit të pyetësorëve, sondazheve dhe anketimeve, me studentët e diplomuar, sa i përket vlerësimit të dijeve dhe kompetencave të përftuara nga programi i studimit.</p> <p>Lidhur me vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të programit të studimit nga punëdhënësit dhe institucionet e tjera që bashkëpunon institucioni, nga dokumentacioni i ngarkuar në ASCAL, nuk konstatohen sondazhe të kësaj natyre. Gjithashtu, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, cilësisë së programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik, KUB së bashku me NjSBC ka realizuar dhe vlerësimin e jashtëm nga dy institucione; Instituti për Cilësi në Arsim (IQE) dhe Qendra Kërkimore “Tirana Business Research Center”, të cilat kanë organizuar, plotësimin e një pyetësori me studentet dhe personelin akademik të KUB. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Dok. 3, Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. 23, Dok.A5.60, Analiza mbi gjurmimin e studentëve dhe treguesit e punësimit nga ZSKK; 5. Dok. A5.68; A6.70, Pyetësori dhe Sondazhi i NjSBC; 6. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 7. A6.69, Raport i Institutit për Cilësi në Arsim, Maj 2021; 8. https://kub.edu.al/alumni/. 9. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Konkluzione</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit nga GVJ dhe vizitës në institucion, NjSBC ka si detyrë, në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, organizimin dhe plotësimin e pyetësorëve në fund të çdo semestri, ku studentët kanë mundësinë të vlerësojnë cilësinë e</p>

	<p>mësimdhënies, dhe performancën e stafit akademik. Kjo njësi në bashkëpunim dhe me ZSKK përdor dhe instrumente të tjera vlerësimi përmes sondazheve, intervistave me studentët e diplomuar, personelin akademik, ndihmës akademik, dhe administrativ për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bazuar në rezultatet e pyetsorëve, intervistave dhe instrumentave të tjerë të vlerësimit, evidenton dhe promovon praktikat më të mira në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në nivel departamenti dhe fakulteti. Gjatë takimeve të realizuara me përfaqësues të Zyrës Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), u konfirmua se KUB mban kontakte dhe shkëmben mendime në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar. ZSKK, në bashkëpunim me Këshillin Studentor, organizon dhe takimet Alumni, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis studentëve aktual dhe atyre të diplomuar. Referuar të dhënave të RVB dhe dokumentacionit shoqërues, KUB së bashku me NjSBC për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, cilësisë së programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik, ka realizuar dhe vlerësimin e jashtëm nga dy institucione; Instituti për Cilësi në Arsim (IQE) dhe Qendra Kërkimore “Tirana Business Research Center”, përmes plotësimit të pyetësorëve me studentet dhe personelin akademik të KUB. <i>GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 824, datë 24.12.2021, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Statutin e KUB, si edhe duke iu referuar <i>Dok. A6.72</i>. Rregullores për funksionimin e NjSBC, konstatohet se është ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe janë parashikuar rregullat dhe procedurat për funksionimin e saj.</p> <p>Referuar dokumentacionit mbi aktivitetet e vazhdueshme të NjSBC-së konstatohen dokumentet si (pyetsorë, sondazhe, raportet periodike) mbi vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, cilësinë e programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik. Rregullat për përfshirjen e studentëve, stafit akademik dhe ekspertëve të jashtëm parashikohen në statut dhe rregulloren e NjSBC-së.</p> <p>Nga vizita në IAL-KUB dhe takimi i GVJ me përfaqësues të NjSBC dhe të institucionit, u konfirmua se, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies,</p>

	<p>cilësisë së programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik, institucioni i KUB, ka realizuar dhe vlerësimin e jashtëm nga dy institucione; Qendra Kërkimore Instituti për Cilësi në Arsim (IQE) dhe “Tirana Business Research Center” të cilat kanë organizuar, plotësimin e një pyetësori me studentet dhe personelin akademik të KUB. Në përfundim janë përgatitur raportet, të cilat janë bërë publike në faqen zyrtare të KUB. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 3. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 4. Dok. A5.68; A6.70, Pyetësori dhe Sondazhi i NjSBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 6. Dok. A6.69, Raport i Institutit për Cilësi në Arsim, Maj 2021; 7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 824, datë 24.12.2021, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, referuar shqyrtimit të dokumentacionit nga GVJ, konfirmohet se pranë IAL-KUB është ngritur dhe funksionon, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Kjo njësi përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga senati akademik, ku përfshihet edhe një student. Bazuar në statutin e KUB (nenet 81-82), rregullores së IAL (nenet, 112-113), si dhe rregullores së funksionimit të NjSBC (nenet 2-4), përcaktohen qartë, organizimi, funksionimi, detyrat edhe përgjegjësitë e kësaj njësie. Referuar të dhënave të RVB si dhe dokumentacionit shoqërues, NjSBC, në mënyrë të vazhdueshme, përdor instrumenta vlerësimi, lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorimin në mënyrë periodike të cilësisë së programeve të studimit, cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, si dhe performancën e stafit akademik si dhe hartimin e raporteve vjetore. GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL, neni 81-82; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë, neni 112-113; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC, neni 2-4; Dok. A6.73, 5. Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/njsbc/; 7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.

<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, statutin e KUB, rregullores së IAL, njësitë bazë dhe njësitë kryesore bashkëpunojnë me NjsBC me qëllim vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi aktivitetet e vazhdueshme të NjsBC-së (pyetsorëve, sondazheve, raportet periodike), konstatohet përfshirja e studentëve dhe stafit akademik për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, si dhe cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>NjsBC, bashkëpunon me njësitë bazë dhe njësitë kryesore, studentët dhe personelin administrativ, me qëllim që të sigurohet cilësia lidhur me programet e studimit, mësimdhënien, kërkimin shkencor, etj si dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme për përmirësimin e tyre. Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të Njësisë Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua se bazuar në rezultatet e pyetsorëve, intervistave dhe instrumentave të tjerë të vlerësimit, kjo zyrë evidenton dhe promovon praktikat më të mira në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në nivel departamenti dhe fakulteti. GVJ gjykon se ky kriter përmbushet.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjsBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjsBC për vitin akademik 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/njsbc; 7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimet e GVJ me studentët, pedagogët, sikurse edhe me përfaqësues të NjsBC dhe drejtues të institucionit, nuk u konstatuan ankesa apo problematika në këtë drejtim. Njëkohësisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit, nuk konstatohen elementë që të krijojnë dyshime për trajtime diskriminuese apo pabarazi sa i përket përfshirjes së studentëve dhe stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në proceset periodike vlerësuese. NjsBC, synon dhe mbikëqyr arritjet e standardeve në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse të IAL, duke patur në fokus studentin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ konfirmon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjsBC.
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjsBC.


<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin 80/2015, VKM nr. 824, datë 24.12.2021, Statutin e IAL, referuar dokumentacionit dhe analizës së RVB, si dhe në takimin me përfaqësues të institucionit u konfirmua se zyrat dhe strukturat përkatëse të KUB në bashkëpunim NjSBC, në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, kanë angazhuar dhe institucione të pavaruara si; Instituti për Cilësi në Arsim (IQE) dhe (Qendra Kërkimore “Tirana Business Research Center” për të siguruar ekspertizë profesionale lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, mësimdhënies, performancës së stafit akademik, etj. Gjithashtu, dhe gjatë takimit me drejtues të institucionit, u konfirmua se pasqyrat financiare vjetore të KUB, auditohen nga një kompani ndërkombëtare auditimi “Grant Thornton”. Raportet e ketyre institucioneve, janë publikuar në faqen zyrtare të KUB.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Rregullore e Programit të Studimit <i>MSh_KF&KA</i>; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 5. Dok. A6.69, Raport i Institutit për Cilësi në Arsim, Maj 2021; 6. Dok. A6.84, Raporti Grant Thornton; 7. https://kub.edu.al/njsbc; 8. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Konkluzione</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit nga GVJ, konfirmohet se pranë IAL-KUB është ngritur dhe funksionon, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Kjo njësi përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga senati akademik, ku përfshihet edhe një student. Bazuar në statutin e KUB, rregullores së IAL, si dhe rregullores së funksionimit të NjSBC, përcaktohen qartë, organizimi, funksionimi, detyrat edhe përgjegjësitë e kësaj njësie.</p> <p>Referuar të dhënave të RVB si dhe dokumentacionit shoqërues, NjSBC, në mënyrë të vazhdueshme, përdor instrumenta vlerësimi (pyetorë, sondazhe, raportet periodike), lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorimin në mënyrë periodike të cilësisë së programeve të studimit, cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, si dhe performancën e stafit akademik si dhe hartimin e raporteve vjetore. NjSBC, synon dhe mbikëqyr arritjet e standardeve në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse të IAL, duke patur në fokus studentin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p>Nga vizita në IAL-KUB dhe takimi i GVJ me përfaqësues të NjSBC dhe të institucionit, u konfirmua se, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, cilësisë së programeve të studimit dhe performancën e stafit akademik, institucioni i KUB, ka realizuar dhe vlerësimin e jashtëm nga dy institucione; Qendra Kërkimore Instituti për Cilësi në Arsim (IQE) dhe “Tirana Business Research Center” të cilat kanë organizuar, plotësimin e</p>

	një pyetësori me studentët dhe personelin akademik të KUB. Raportet e NjsBC dhe të institucioneve të pavarura bëhen publike në faqen zyrtare të KUB. Në përputhje me kriteret e mësimperme, GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Referuar shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, konstatohet se NjsBC, bazuar në statutin e IAL, rregulloren e funksionimit të saj, në fund të çdo semestri, organizon plotësimin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, dhe performancës së stafit akademik. NjsBC bazuar në të dhënat e mbledhura përmes plotësimit të pyetësorëve dhe instrumentëve të tjerë të vlerësimit, përparat raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, ku një kopje të këtij raporti me rekomandimet përkatëse, ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe strukturave drejtuese dhe vendimarrëse. Nga konsultimi me faqen e KUB, konstatohet se NjsBC ka rubrikën e saj në faqen zyrtare të institucionit, ku pasqyrohet veprimtaria e saj, dhe bëhen publike raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Nga të dhënat e mësimperme, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht. <i>Referenca:</i> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjsBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjsBC për vitin akademik 2022-2023; 6. https://kub.edu.al/njsbc/; 7. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në përputhje me Ligjin 80/2015, VKM nr. 824, datë 24.12.2021, referuar shqyrtimit të dokumentacionit nga GVJ, konfirmohet se pranë IAL-KUB është ngritur dhe funksionon, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC). Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e KUB, GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri, është NjsBC. Kjo strukturë bazuar në rregulloren e funksionimit të saj, ka për qëllim dhe detyrë, vlerësimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit,

	<p>cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, si dhe performancës së stafit akademik. NjSBC, çdo vit përgatit raportin vjetor për veprimtarinë e saj, lidhur me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ku një kopje të këtij raporti, ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe strukturave drejtuese dhe vendimarrëse me rekomandimet përkatëse.</p> <p>Nga takimet e realizuar me përfaqësues të institucionit, u konfirmua se KUB çdo vit përgatit raportin vjetor (<i>Dok. 23, Raporti vjetor 2021-2022 i KUB</i>) lidhur me veprimtarinë akademike, kërkimin shkencor, programet e studimit, strukturat akademike, studentët, planin buxhetor, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse si dhe parashikimet dhe objektivat për vitin e ardhshëm.</p> <p>Referuar të dhënave të raportit të vlerësimit të brendshëm, si dhe konsultimit me faqen zyrtare të institucionit, konstatohet se KUB, bën publike në faqen zyrtare, dokumentet/aktet ligjore (statuti, rregullorja e IAL, plani strategjik, vendimet për akreditimin, rezultatet për vlerësimin e programeve të studimit etj), si dhe dokumenta të rëndësishëm (raportet vjetore të institucionit, pasqyrat financiare, relacionet financiare, raportet të NjSBC dhe të institucioneve të pavarura për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, programeve të studimit, etj.), duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Nga të dhënat e mësipërme, GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 6. Dok. 23, Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; 7. Dok.A1.6, Informacion dërguar ASCAL, për përmbushjen e rekomandimeve nga Bordi i Akreditimit; 8. https://kub.edu.al/aktet-ligjore/; 9. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me përfaqësues të institucionit, për rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë nga NjSBC dhe raporteve të vlerësimit të institucioneve të pavarura (ASCAL, IQE, Grant Thornton, etj.) shoqërohen me një plan masash nga strukturat drejtuese të KUB, me qëllim plotësimin dhe përmirësimin e mangësive të evidentuara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>Dok. A1.6</i>), konstatohet se nga KUB është përgatitur dhe dërguar ASCAL-it, një informacion dhe plani i masave, për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit për programin e studimit Master i Shkencave_Kontabilitet Financë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL;

	<ol style="list-style-type: none"> 2. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 3. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit;</i> 4. <i>Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC;</i> 5. <i>Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023;</i> 6. <i>Dok. 23, Raporti vjetor 2021-2022 i KUB;</i> 7. <i>Dok.A1.6, Informacion dërguar ASCAL, për përmbushjen e rekomandimeve nga Bordi i Akreditimit;</i> 8. https://kub.edu.al/aktet-ligjore/; 9. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin 80/2015, VKM nr. 824, datë 24.12.2021, referuar shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri, është NjSBC. Bazuar në statutin e IAL, rregulloren e KUB si dhe rregulloren e funksionimit të saj, kjo njësi ka për qëllim dhe detyrë, vlerësimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit, cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, si dhe performancës së stafit akademik. NjSBC, çdo vit përgatit raportin vjetor, lidhur me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ku një kopje të këtij raporti me rekomandimet përkatëse, ia përcjell njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe strukturave drejtuese të KUB.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dok. 4, Statuti i IAL;</i> 2. <i>Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë;</i> 3. <i>Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; Rregullore e Programit të Studimit_MSh_KF&KA;</i> 4. <i>Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC;</i> 5. <i>Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023;</i> 6. https://kub.edu.al/njsbc/; 7. https://kub.edu.al/aktet-ligjore/; 8. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/.
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar të dhënave të raportit të vlerësimit të brendshëm, si dhe takimeve të GVJ me studentët dhe personelin akademik, rezulton se njësia kryesore/bazë, NjSBC, ZSKK si dhe strukturat përkatëse të KUB, organizojnë në mënyrë periodike veprimtari të tilla si, (takime informuese, këshillime, leksione të hapura, anketime, sondazhe, etj.), me studentët, stafin akademik dhe administrativ me qëllim ndërgjegjësimin e tyre, për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu përfaqësues të institucionit, marrin pjesë në takimet periodike të organizuar nga ASCAL dhe institucione të tjera të MAS me qëllim, përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, të ofruara nga KUB.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dok. 4, Statuti i IAL; 2. Dok. 1. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; 3. Dok.2, Dosja e Programit të Studimit; 4. Dok. A6.72, Rregullore për funksionimin e NjSBC; 5. Dok. A6.73, Raport i NjSBC për vitin akademik 2022-2023; 6. Dok.A5.60, Analiza mbi gjurmimin e studentëve dhe treguesit e punësimit nga ZSKK; 7. https://kub.edu.al/njsbc/; 8. https://kub.edu.al/studentet-2/#qeveria_studentore; https://kub.edu.al/alumni/; 9. https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/. 		
Konkluzione	GVJ gjykon për përmbushjen plotësisht të këtij standardi nga IAL KUB.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Kontabilitet Financë” me profil: “Kontabilitet Auditim” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Staf i akademik i angazhuar në këtë program studimi, tepër cilësor, të kualifikuar, me eksperiencë akademike, profesionistë dhe ekspertë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit dhe nënfusha të lidhura me to.
2. Plani mësimor i programit të studimit është i kompletuar me lëndët e rëndësishme dhe prioritare të fushës duke i pajisur me një formim cilësor studentët në këtë program që u mundëson atyre punësim në tregun e punës si dhe ekuivalentim dhe njohje të studimeve.
3. Një larmi marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe biznese private që lehtësojnë dhe mundësojnë kryerjen e praktikave profesionale të lidhura me programin e studimit.
4. Pjesëmarrja në projektet kërkimore dhe shkencore kombëtare si edhe projekte ndërkombëtare për ngritje kapacitetesh, ndihmojnë institucionin në ofrimin e shërbimeve arsimore të pasura dhe cilësore për studentët.
5. Kohezioni që Programi i Studimit MSHKF ka me tregun dhe zhvillimet e tregut dhe profesionit. Ka prioritet fusha e kontabilitetit pasi dhe emërtimi i programit është kontabilitet financë. Korrelacioni mes tregut të punës dhe programit të studimit. Produkti final janë studentë të punësuar në masën 93% në profesion.
6. Kombinim mjaft i mirë midis teorisë dhe praktikës. Personeli akademik me kontratë ndajnë me studentët eksperiencën nga praktika e tyre profesionale në fushat përkatëse.
7. Studentë nga universitete të tjera që vijnë për të ndjekur këtë program studimi në KUB dëshmon për konkurrueshmëri dhe qëndrueshmëri të programit. Diversifikimi i studentëve që vjen në pasurim nga viti në vit sepse shërbën si reflektim i përpjekjeve të institucionit për punë më serioze dhe rritjen e imazhit në treg.
8. KUB, disponon mjediset e nevojshme fizike dhe laboratorike për të realizuar sa më mirë procesin e mësimdhënies dhe praktikave mësimore për studentët e këtij programi studimi.
9. Biblioteka e KUB dhe aksesit në libraritë online, plotëson kërkesat e stafit akademik dhe studentëve me literaturën bazë dhe ndihmëse për nevojat e procesit mësimor si dhe kërkimin shkencor.
10. Mbështetja financiare nga ana e institucionit për stafin akademik, sa i përket pjesëmarrjes në konferenca dhe botime të artikujve në revista shkencore të indeksuara në scopus dhe faktor impakt.

Pika të dobta/Sfida:

1. Përmirësimi në vazhdimësi i cilësisë së programit të studimit, mbështetur në mendimet dhe sugjerimet e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të institucioneve dhe organizatave partnere.
2. Niveli jo i mjaftueshëm/kënaqshëm i angazhimit dhe pjesëmarrjes së studentëve të këtij programi studimi në projekte kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Rekomandime:

1. Nga IAL-KUB, të merren në konsideratë, mendimet dhe sugjerimet e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm, me qëllim përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së programit të studimit.
2. Nga ana e KUB (njësisë kryesore/bazë), të nxitet dhe mbështetet angazhimi i studentëve të këtij programi studimi në projekte shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare për të diversifikuar përgatitjen e tyre profesionale por edhe shkencore.
3. Nga ana e strukturave përkatëse të KUB, të tregohet kujdes në ngarkimin e dokumentacionit përkatës në sistemin e ASCAL-it, lidhur me akreditimin e këtij programi studimi.



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in Accounting and Finance provided by the Higher Education Institution "Kolegji Universitar i Biznesit"

Strengths and affirmations

1. The academic staff engaged in this study program, are professionals and experts in the field of accounting and auditing; they are highly qualified, with considerable research and academic experience.
2. The curriculum of the study program is completed with the important and relevant courses of the respective fields providing qualitative education to the students and enabling them to be successfully employed in the labor market or continue further studies.
3. There are many cooperation agreements with public institutions and private businesses that facilitate the professional aspects of the study program.
4. Participation in national research and scientific projects, as well as international projects for capacity building, help the institution in providing rich and qualitative educational services for students.
5. There is consistency between the Study Program and the developments of the market, industry, and the accounting and auditing profession. Priority is given to the field of accounting hence the name of the program is emphasizing accounting. The final product is students employed to the extent of 93% in the profession.
6. the study program offers a good combination between theory and practice. The invited guest lecturers share with the students the experience from their professional practice in the relevant fields.
7. Many students that have completed their bachelor's degrees in other universities, who come to follow this study program are an indicator of the competitiveness and sustainability of the program. The diversification of students serves as a reflection of the institution's efforts for more serious work and increasing its image in the market.
8. The Institution demonstrates that it has the required logistics to carry out the teaching process and teaching practices for the students of this study program as best as possible.
9. The library and access to online libraries meet the requirements of academic staff and students with core and suggested literature for the needs of the learning process as well as for scientific research.


10. Financial support from the institution for the academic staff, in terms of participation in conferences and publication of articles in scientific journals indexed in Scopus and with impact factor.

Weaknesses

1. The quality and content of the study program, are not always updated according to the opinions and suggestions of partners and experts from other institutions and organizations.
2. Insufficient/satisfactory level of engagement and participation of students of this study program in research and scientific projects inside and outside the country.

Recommendation

1. The institution should take into consideration the opinions and suggestions of collaborators and external experts, in order to continuously improve the quality of the study program.
2. The faculty and the department in charge of offering this study program should make more efforts to encourage and support the engagement of students of this study program in national and international scientific projects to diversify their professional and scientific preparation.
3. The institution should be more attentive in uploading the relevant documentation in the ASCAL system, regarding the accreditation of this study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

